

KONSULTIMET RAJONALE
ME SHOQËRITË CIVILE LIDHUR ME INICIATIVËN PËR KOMISIONET REGJIONALE PËR
PËRCAKTIMIN DHE PARAQITJEN E FAKTEVE MBI KRIMET E LUFTËS DHE SHKELJET
TJERA TË RËNDA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË ISH JUGOSLLAVI - KOMRA
TË MBAJTURA MË 3 KORRIK 2010
BEST WESTERN HOTEL TURIST SHKUP

JASMINA NAJDOVSKA: Para së gjithash do të doja t'i përshëndes të gjithë pjesëmarrësit dhe t'i falënderoj organizatorët që më kanë nderuar duke më caktuar mua që t'i hap këto konsultime. Për një numër të madh të pjesëmarrësve që u përgjigj, në sajë të një debat i cili ishte organizuar nga organizata ime ku ende punoj - Fondacioni Instituti për Shoqëri të Hapur Maqedoni - në janar 2010, me temën: "Historia dhe Anekdodat e Apokrifit – Demitizimi i vitit 2001 ". Nuk e di nëse ju kujtohet në atë debat mysafiri jonë nga Zagrebi, i cili sot është një nga panelistët që do të na drejtohet me fjalimin e tij, Eugen Jakovçiq, theksoi se organizata të cilën ai e përfaqëson, „Dokumenta“ nga Zagrebi, është pjesë e iniciativës për formimin e komisionit rajonal për vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me krimet e luftës dhe shkeljet tjera të të drejtave të njeriut, deri më tani është angazhuar kryesisht në territorin e Serbisë, Kosovës, Kroacisë, Malit të Zi, megjithatë ai përmendi se një nga qëllimet është përfshirja në këtë proces edhe e territorit të Maqedonisë. Sot është paraqitja e tyre e parë, megjithatë unë nuk do të flas shumë për iniciativën, këtë do t'ua lë kolegeve të mi që t'i paraqesin qëllimet dhe detyrat që kanë ata, me çka merren, kur dhe pse është krijuar KOMRA. Unë mund të them se po e përcjell një kohë të gjatë punën e tyre dhe e di se qëllimi më i rëndësishëm i iniciativës janë viktimat. Tek ne, në territorin e Maqedonisë gjatë vitin 2001 ndodhën ngjarje që lanë pasoja, e të cilat vazhdojnë të ndihen edhe sot e kësaj dite, prandaj mendoj se ky komision rajonal ka në çka ta bazojë punën e vet. Megjithatë, më shumë në lidhje me atë se si punon dhe çka punon komisioni do të flasim kolegët e mi. Së pari kolegja Nora Ahmetaj, anëtare e Këshillit koordinues për KOMRA-n. Nora, urdhëroni!

NORA AHMETAJ: Ju faleminderit. A mund t'i vendosni dëgjueset, sepse unë do të flas në gjuhën amtare. A e kam përkthimin? Mund të filloj? OK. Faleminderit! Unë jam Nora Ahmetaj, jam anëtare e Këshillit koordinues rajonal të Koalicionit për themelimin e KOMRA-s, jam gjithashtu udhëheqëse e Qendrës për hulumtim, dokumentim dhe publikim në Prishtinë, aktive në konsultimet rajonale dhe konsultimet nacionale në Kosovë për themelimin e këtij komisioni në mënyrë shumë intensive, qysh nga viti 2008. Meqenëse sot, gjatë gjithë ditës do të kemi panelistë të cilët në mënyrë të detajuar do të ju shpjegojnë dhe do të diskutojmë se çka është kjo iniciativë, nga ka ardhur ideja, pse dhe do të bëjmë krahasime me komisionet tjera nacionale në botë dhe do të diskutojmë edhe me ju dhe do të marrim sugjerime nga ju.

Unë mendoj se në bazë të përvojës time, dhe të konsultimeve që i kemi mbajtur sidomos në Kosovë e në disa vende tjera, mendova se është mirë që të ju shpjegoj konceptin e të drejtës transitore me zbërthimin e këtij diskursi se çka është e drejta transitore meqë nganjëherë po krijohet konfuzitet dhe të shpjegoj se si komisionet e së vërtetës vërtet janë komponentë pothuaj se kryesore e të drejtës transitore në mënyrë që gjatë ditës kolegët e mi dhe ne bashkërisht t'i shtjellojmë këto tema dhe të marrim edhe sugjerime e vërejtje edhe nga ju.

Dy dekadat e fundit, ne, shtetet të cilat kanë dalur nga Jugosllavia, janë ballafaquar me shumë luftëra dhe luftëra shumë brutale. 18 vjet në Kroaci, qe 15 vjet në Bosnje, qe 10 vjet në Kosovë duke marrë parasysh edhe konfliktin e fundit në Maqedoni dhe çka ka ndodhur: marrëdhëniet në rajon janë ende

të tendosura. Pse janë të tendosura? Për arsye se s'ka pasur qasje të mirëfilltë nga shtetet në rajon, nga secili shtet respektiv për ballafaqimin me të kaluarën. Themi se çka nënkupton kjo e drejta transitore dhe pse shtetet të cilat gjenden në post-konflikt ose kalojnë, dalin prej luftërave ose konflikteve dhe pse duan me u marrë dhe me u ballafaqu me të kaluarën. Po e marrë një term që është shpeshherë në drejtën transitore në teori përdoret. Themi që pas secilës luftë ndodhë një cunami politik në atë vend ku ka ndodhur konflikti ose lufta. Ai cunam politik, do të thotë shkatërron gjithçka, shkatërron shtetin, qeverisjen, shkatërron shoqërinë civile, shkatërron familjen dhe individin gjithashtu, del me trauma dhe me pasoja. Atëherë pyetja është se si të rimëkëmbet ajo shoqëri, si të krijohet një qeveri demokratike, si të punohet me individin. Mos të harrojmë, në mesin e shoqërisë civile të cilët dalin prej këtyre luftërave ose konflikteve, janë individë, pjesë më të marginalizuara dhe segmente të shoqërisë civile të cilët janë më të atakuar nga konflikti dhe këta janë: viktimat e luftës, qoftë direkt apo indirekt, janë familjarët e viktimave, janë të zhdukurit dhe familjarët e të zhdukurve ose asociacioni që merret me këtë problematikë, janë veteranët e luftës. Mos të harrojmë se këta njerëz po qe se nevojat e tyre nuk adresohen atëherë në ato shoqëri të cilat pretendojnë të demokratizohen por nuk merren konkretisht me nevojat e këtyre segmenteve të marginalizuara, pothuajse e kemi një "bombë" të kurdisur e cila herëdoherë do të eksplodojë dhe do të kërkojë nga qeveritë respektive që dikush të merret me problemet e tyre. Dhe duke parë se shtetet patjetër duhet t'i transformojnë institucionet, të ngrisin vetëdijen e shoqërisë civile e cila do të kërkojë llogaridhënie nga qeveritë, të punohet më shumë me individin, e drejta transitore nuk merret me asgjë tjetër përveç se i ka gjashtë komponenta dhe unë shkurtimisht do t'i cek se cilat janë ato komponenta në mënyrë që më pastaj ne do të ndalemi te komponenta kryesore e cila neve na preokupon dhe komponenta të cilat janë ngusht njëra me tjetrën.

Hulumtimi i kryerësve të krimeve të luftës, është problematikë e parë me të cilën duhet të merren shtetet pas konfliktit. Me këtë nënkuptohet se gjykatat nacionale duhet të merren me dorëzimin apo me hulumtimin e kryerësve të veprave penale. Mirëpo, ekzistojnë edhe organizata ndërkombëtare, sikurse rasti ynë që është Tribunali i Hagës, i cili do të merret me të ashtuquajturit "big fish", do me thënë ata nuk mundën me u marrë edhe me kryerësit të cilët kanë kryer vepra më të ulëta, të cilët pra kanë kryer krime por jo krime kundër njerëzimit. E kemi rastin me Tribunalin e Hagës, i kemi kushtëzimet dhe presionet e mbarë bashkësisë ndërkombëtare e cila ka ushtruar presion ndaj shteteve në rajon për dorëzimin e kriminelëve të luftës, por tjetër mbetet sundimi i ligjit dhe ballafaqimi me të kaluarën dhe atëherë kur gjykatat nacionale ose kombëtare përforcohen dhe merren vet, do të thotë e bëjnë ndjekjen e kriminelëve të luftës nga ana e tyre dhe në duart e tyre.

Komponenta e dytë, janë komisionet të cilat do të merren me të vërtetën. Këto komisione nuk e luajnë rolin e gjykatave, nuk janë arbitër. Këto komisione merren kryesisht me viktimën: hulumtimin e së vërtetës, ndriçimin e së vërtetës si dhe zbardhjen e të vërtetës ose informimin e publikut me atë të vërtetë, por aty ku publiku ose shoqëritë respektive e mësojnë një të vërtetë tjetër, jo atë të vërtetë e cila i servohet nga qeveria aktuale ose nga shoqëritë civile. Komisionet e të vërtetës, ne do t'i diskutojmë gjatë ditës dhe mund të kemi edhe formate të ndryshme, mund të kemi edhe kohëzgjatje të ndryshme, mund të kenë kryesisht edhe përvoja nëpër botë, sepse ka pas komisione nacionale, por meqë prej një shteti të Jugosllavisë kanë dalur 7 shtete tjera, ky komision nuk mund të jetë komision nacional dhe nuk po ndalem shumë në këtë temë nga se do ta diskutojmë më vonë, për arsye se ka pasur implikime të shteteve në rajon, njëra me tjetrën, kështu që është e domosdoshme që komisioni të jetë regional, i pari i këtij lloji në botë.

Si komponentë tjetër janë reparacionet. Çka nënkuptohet me reparacione? Reparacionet janë iniciativa shtetërore, të cilat merren me kompensimin e dëmeve të luftës dhe me kompensimin ose ngritjen e dinjitetit të viktimave. Për shembull, pala që ka abuzuar, ka kryer dhunë, në njëfarë mënyre, kur e pranon se ka kryer dhunë obligohet që t'ia jap dëmshpërblimin viktimës. Reparacion

quhet edhe kërkimi i faljeve. Kërkim-falje do të thotë qoftë të jetë në mënyrë simbolike, e ka efektin shumë të madh, mirëpo kërkim falje mund të bëjnë edhe liderët të cilët në njëfarë mënyre marrin përgjegjësinë në emrin e tyre ose në emrin e regjimit apo identitetit të cilit ata i takojnë është kryer krim dhe në këtë mënyrë, në njëfarë mënyre, e pranojnë ose i japin sinjal viktimës se ata po e pranojnë dhembjen, po e ndajnë dhembjen me atë çfarë ka përjetuar viktimat.

Komponenta e katërt merret me gjininë, që do të thotë me gratë janë pjesë më vitale e shoqërisë që në luftërat e fundit, jo vetëm në Ballkan por kemi rastin edhe në Ruandë dhe shumë raste tjera në botë ku gratë abuzohen me dhunime apo abuzohen me robërim dhe ky dhunimi është krim kundër njerëzimit. Shoqëritë të cilat dalin prej konfliktit nuk merren me këtë problematikë dhe grave nuk iu dëgjohet zëri i tyre se ndaj tyre është ushtruar dhunë, normalisht se është problem i cili është i domosdoshëm me u prekë dhe hyn në të drejtën transitore.

Komponenta e pestë, shumë e rëndësishme, komponentë me të cilën unë po mendoj se ne të gjithë jemi të familjarizuar sepse ne po kalojmë... besoj edhe ju në Maqedoni, por edhe ne në Kosovë, në Serbi dhe në Bosnje e në Kroaci, është reformimi i institucioneve të sigurisë. Çka nënkupton kjo? Po e zëmë, në vendet ku, për shembull kryhet dhunë ose kryhen krime, qoftë kundër njerëzimit qoftë të çfarëdo natyre tjetër ato institucione të cilat kanë qenë përgjegjëse, e sidomos këtu nënkuptohet qoftë ministria e mbrojtjes qoftë institucionet e policisë ose shërbimet policore, qoftë formacionet e ndryshme ushtarake, ato institucione duhet të reformohen, nga se popullata e cila jeton në një presion të madh dhe e humb besimin ndaj këtyre institucioneve të cilat paraprakisht kanë kryer dhunë, ajo duhet ta shohë dhe të bindet se ato institucione janë transformuar, janë reformuar në atë mënyrë që prej një abuzuesi kalojnë në formën e shërbyesit civil ndaj qytetarëve dhe kjo merr shumë kohë, reformimi i institucioneve mendoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm, nuk i merr dy, tri, pesë vjet por mund të merr edhe dekada.

Dhe komponenta e gjashtë, është komponenta e memorialëve, ngritja e memorialëve si shenjë që e ka qëllimin se në të ardhmen gjeneratat e reja ta njohin një histori të bazuar në fakte, në fakte të cilat do të ngriten dhe konservohen qoftë përmes muzeve të ndryshme qoftë përmes memorialëve, qoftë përmes dëgjimeve publike ku fëmijët ose të rinjtë e shohin dhe dëgjojnë një të vërtetë tjetër direkt prej viktimës dhe jo atë të vërtetë e cila i servohet dhe këto e kanë qëllimin tjetër sepse jipet mesazhi që dhuna nuk duhet të përsëritet më, dhuna e cila ka ndodhur, ishte dashur të mos ndodhë, që të mos përsëritet. Memorialet mirë do të ishte që shtetet respektive, secili shtet të mirret ose të caktojë me ligje ndërtimin e tyre ose ta ndajë një ditë përkujtimi për të gjitha viktimat që kanë ra dhe të gjitha këto të specifikohen me ligje.

Këto janë gjashtë komponenta të së drejtës transitore, pa të cilat asnjë shtet demokratik ose së paku shtetet demokratike që janë të njohura në botë nuk kanë ardhur në këtë stad ku janë sikur mos të kishin kaluar nëpër këto faza.

E tash, pse formimi i komisionit ka ndodhur dhe pse ideja ka ndodhur që qasja të jetë prej poshtë – lartë, është për arsye se ideja ka qenë që të mobilizohet shoqëria civile, të mobilizohen shoqëritë civile të gjitha në rajon në mënyrë që të bëjnë presion te qeveritë të cilat edhe ashtu janë të dobëta dhe te institucionet e tyre që të ballafaqohen me të kaluarën. Ne i kemi pasur dy tentativa për komisione nacionale në të kaluarën, njëri ka qenë në Bosnje dhe tjetri në Serbi, në kohën e pushtetit të Koshtunicës dhe sa unë e di nuk kanë qenë asnjëra të suksesshme për arsye se, sidomos komisioni që është themeluar në Serbi ka pasur tendencë që më shumë të merret me krimet që të tjerët i kanë kryer ndaj popullatës serbe e jo të jetë ajo reciproke.

Nuk do të vazhdoj më tepër të flas për komisionet se besoj se kolegët e mi tash do të flasin vetëm për komisionet e unë mendova ta jap një pasqyrë të përgjithshme se çka është e drejta transitore dhe pse është e domosdoshme, nuk është diçka që duhet ne ta zgjedhim, a të mirremi dhe a të jemi pjesë e së

drejtës transitore – është proces nëpër të cilin ne kalojmë dhe është i domosdoshëm, i patjetërsueshëm. Faleminderit për vëmendjen, besoj se do të kemi shumë pyetje prej jush.

VETON MUJAJ: Mbajeni ende ato dëgjuesit në vesh ato dëgjueset për shkak se edhe unë do të flas në gjuhën shqipe. Vi nga Peja, jam drejtor i Organizatës “Syri i vizionit”, një organizatë e cila është bashkëngjitur Iniciativës për KOMRA që nga viti 2008 dhe njëkohësisht që nga ky vit jam edhe anëtar i Këshillit koordinues për KOMRA-n.

Vetë titulli i asaj çka do të flas unë e që në të vërtetë nuk është se do të flas vetëm unë, por në këtë rast unë do të jem një lloj moderatori i kësaj pjese dhe besoj se duke qenë se janë konsultime me shoqërinë civile dhe këto janë konsultime regjionale, pra kemi anëtarë të shoqërisë civile nga të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë atëherë sigurisht gjatë kësaj periudhe, meqë unë do ta moderoj këtë pjesë, do të kemi edhe shumë njohje tjera të punëve të organizatave dhe shoqërisë civile edhe nga vendet tjera. Unë paraprakisht do të kisha dashur ta jap një lloj përvoje time në këtë proces në mënyrë që me hap një lloj debati së bashku me ju mbi atë se si shoqëria civile punon në vende tjera dhe kështu të themi nuk është zgjedhur rastësisht Maqedonia që të jemi sot këtu për shkak se Maqedonia pak më vonë i është kyçur këtij procesi dhe njëkohësisht është bërë një punë e kontaktit së bashku me Eugenin, disa herë më parë, që e përmendi më herët Jasmina dhe kemi vërejtur edhe këtu një vullnet, një vullnet të mirë të organizatave joqeveritare por edhe të shoqërisë civile që të kyçen në këtë proces dhe të ndihmojnë, kështu që gradualisht të kyçen nga këto vende të cilat pak më shumë qe disa vite kanë qenë pjesë e këtij procesi dhe besoj që Maqedonia pak më shumë në shpejtësi do t’i bashkëngjitet radhëve tona ashtu sikur ka ndodhur gjatë këtyre dy viteve prej anës sonë.

Fillimisht ne si organizatë, desha me cek, nuk jemi tepër profesionalë të drejtuar në këtë proces, sa janë organizatat tjera që në njëfarë forme e kanë edhe mision, mirëpo vetë veprimet që po ndodhin sidomos pas vitit 2001 kanë bërë që në njëfarë forme të shihet te të rinjët që të kenë një lloj përgjegjësie te të gjithë qytetarët e në këtë rast edhe te shoqëria civile. Duke parë këtë, do të thotë edhe organizata jonë, ka vërejtur që jo shumë elemente të mira ndodhin në të mirën e viktimave të luftës në rajonet ku është zhvilluar lufta ose konflikti dhe kjo ka bërë që të shihet në njëfarë forme që ne nëse si shoqëri civile nuk jemi aktivë, atëherë prapë mund të shkojmë drejt një drejtimi të pa përcaktuar ose të pa ditur se çka është duke u bërë.

Realisht ne kemi parë do të thotë vështirësi, ekzistojnë organizata të cilat nëpër shumë shtete janë të organizuara brenda asociacioneve qoftë të shoqatave të viktimave, qoftë të veteranëve, qoftë të formave të ndryshme mirëpo shpesh nën ndikimin e politikës këto organizata nuk kanë shumë mundësi të merren drejtpërdrejt me tejkalimin e atyre problematikave çfarë vërtet i ka pasur shoqëria, kështu që duhet një tërësi pak më e madhe e shoqërisë në këtë rast duke filluar prej organizatave rinore e deri te të gjitha organizatat tjera që veprojnë po edhe vetë shoqëria civile, që të jetë më aktive në mënyrë që kjo të zgjerohet.

Në bazë të kësaj, do të thotë, ne dimë që në kuadër të këtij procesi që ka shkua gjatë krejt kohës prej vitit 2006 që ka filluar dhe vitit 2007 në shumë hapësira janë mbajtur konsultime. Konsultimet nuk janë mbajtur vetëm me shoqëritë civile por konsultimet janë mbajtur edhe me të gjithë, të zëmë, me artistë, me intelektualë, me shumë struktura tjera. Mirëpo, fizionomia e mbajtjes së tyre është se kemi tri lloje do të thotë të këtyre konsultimeve, janë ato konsultimet lokale të cilat mbahen nëpër qytete të caktuara, në çdo vend të ish-Jugosllavisë, pastaj kemi konsultimet nacionale dhe konsultimet regjionale që përfshijnë të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë. Kjo bën një njëfarë forme që gradualisht njerëzit dhe organizatat e interesuara që të ndihmojnë në këtë proces qoftë prej vendit më të largët të një shteti të ish-Jugosllavisë të gjejnë mënyrë dhe të kyçen për të ndihmuar në këtë proces. Në njëfarë forme, e mora shembullin prej vetes. Unë prej Pejës nuk kam pas shumë qasje në Prishtinë, por kemi filluar me ato organizimet në qytetin e Pejës, pastaj njerëzit – shoqërisë civile iu

kanë bashkëngjitur nga ai rajon në nivel Kosove dhe ka filluar ai kontribut edhe në nivel nacional dhe pjesa e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile nga niveli nacional në nivel të Kosovës kanë filluar të japin kontributin e vet në nivelin regjional të vendeve të ish-Jugosllavisë ku përfshihen. Dhe një prej këtyre takimeve është ky edhe i sotmi, ku një pjesë e njerëzve të shoqërisë civile janë nga Kosova, nga Kroacia, nga Bosnja dhe nga të gjitha pjesët dhe sigurisht se këto organizata ose individë që kanë qenë pjesë e këtij procesi kemi përvoja të ndryshme të këtyre organizatave për çka kisha pasur shumë dëshirë në këtë rast që të hapim debatin dhe fillimisht të fillojmë me disa përvoja të organizatave nëpër vende të ndryshme dhe gradualisht të shohim se ku jemi deri në këtë masë. Dihet se roli i shoqërisë civile është iniciativa vet, e nisur prej shoqërisë civile dhe besojmë se si shoqëri civile, për shkak se tash rreth neve kemi shumë organizata, më shumë se 500 organizata joqeveritare të regjistruara dhe plus individë dhe njerëz të tjerë të cilët janë përkrahës direkt të kësaj iniciative dhe të shohim se ne si shoqëri civile a po mund të dërgojmë deri në nivelin ku kemi menduar këtë iniciativë, domethënë deri në nivelin ku shtetet do ta pranojnë këtë si komision regjional.

Kaq në këtë pjesën e parë. Unë kisha pasur dëshirë që debati të jetë i hapur dhe të fillojmë të marrim disa përvoja fillimisht dhe nëse ka nevojë pastaj së bashku të bisedojmë për ndonjë pyetje për ndonjë detaj tjetër në raport me atë se çka dëshirojmë.

Është e nevojshme që secili anëtar i cili e merr fjalën, të prezantohet me emër, mbiemër, prej nga vjen në mënyrë të dihet prej cilës organizatë vjen, sepse kjo është një formë që gjithçka incizohet dhe mbahet gjithçka si arkiv dhe është pjesë e arkivuar e cila do të mbetet si dëshmi për të ardhmen. Prandaj, e hap debatin. Një mikrofon, nëse është e mundshme me ua dhënë diskutuesve.

NELA PAMUKOVIQ: Nela Pamukoviq, Qendra për gratë viktime të luftës dhe Rrjeti i grave të Kroacisë, nga Zagrebi.

IDRO SEFERI: Jam Idro Seferi, gazetar prej Kosovës, Koha ditore dhe Top-chenel.

MARKO VELIÇKOVIQ: Marko Veliçkoviq, Qendra për zhvillimin e burimeve njerëzore nga Nishi.

LILJANA SPASIQ: Liljana Spasiq, vij nga Vojvodina dhe jam anëtare e Organizatës Aksioni qytetar- Pançevë.

IVAN NOVOSEL: Ivan Novosel, nga Organizata Legala nga Zagrebi.

JELENA SVIRÇIQ: Jelena Svirçiq, Portali i shoqërisë civile Halter.

NOVAK VUÇO: Novak Vuço, Komiteti i juristëve për të drejta të njeriut, Beograd.

GORDAN BOSANAC: Gordan Bosanac, Qendra për studime të paqes, Zagreb.

KUSHTRIM KOLIQI: Kushtrim Koliqi, nga Integra, Prishtinë.

D...MILAN: Shoqata e veteranëve të ushtrisë, Kavadarç.

VANJA LAZAREVSKI: Vanja Lazarevski, Qendra për politika euro-atlantike, Mal i Zi.

ALEKSANDRA GLIGOROVIC: Aleksandar Gligoroviq, Asociacioni për prosperitet demokratik „Zid“ nga Podgorica – Mali i Zi.

BOJAN GAVRILOVIQ: Bojan Gavriloviq nga Qendra beogradase për të drejtat e njeriut, Beograd.

ACO JOVANOVSKI: Aco Jovanovski, shofer i autobusit që është djegur në masakrën e Karpalakut, Shoqata Karpalak, Prilep.

ILIJA NIKOLOVSKI: Ilija Nikolovski nga Shoqata e veteranëve për mbrojtjen dhe sigurinë e Republikës së Maqedonisë.

OLIVER BASHANOVIQ: Oliver Baçanoviq, profesor në Fakultetin për siguri - Shkup.

FRUSINA REMENSKI: Frusina Remenski, docente në Fakultetin për siguri, Shkup.

ACO STOJANOVSKI: Aco Stojanovski, Kryetar i Unionit të mbrojtësve të Maqedonisë, Shkup.

NADICA MIRÇOVSKA: Nadica Mirçovska, ish kryetare e shoqatës Heronjtë e Maqedonisë.

IGOR PETREVSKI: Igor Petrevski, kryetar i Shoqatës Karpalak, Prilep.

(mungon xhirimi i plotë i prezantimit të pjesëmarrësve të konsultimit)

VETON MUJAJ: Nuk ka më? OK. Faleminderit! Tash po vazhdojmë me atë pjesën e debatit dhe jo vetëm debatit por edhe të shprehjes së atyre përvojave dhe si shoqëria e sheh edhe prej këndeve të ndryshme të vendeve të ish-Jugosllavisë dhe kishim ftuar që prapë ata që kanë dëshirë të flasin, por vetëm me një kujdes që prapë, kur e marrin fjalën të prezantohen.

Da li je okej? A është në rregull? Besoj se nuk do të vonohemi shumë dhe do të bëjmë pauzë, por e kemi këtë pjesën e atyre që duan të flasin në njëfarë forme dhe edhe një herë, po them kishte me qenë mirë që prapë kur te merr fjalën dikush, të prezantohet prapë për shkak të incizimit që bëhet, prandaj edhe e hap debatin. Kush ka dëshirë ta marrë fjalën, për ndonjë vërejtje, përvojë, ndonjë pyetje, për çkado që vëreni se kishte me dhënë një lloj kuptueshmërie kësaj pjesës së parë, do të thotë praktike, para se të fillojmë ta shpjegojmë tamam punën se si, pse KOMRA dhe aspektet tjera të vazhdueshme, mirëpo ne si shoqëri civile cila është ajo qasja jonë ndaj kësaj iniciative. Urdhëroni! Prezentohuni edhe një herë, të lutem!

ARMEND MAZREKU: Armend Mazreku, prej lëvizjes Fol, Kosovë.

Fillimisht i falënderoj të gjithë ata të cilët e kanë ndërmarrë një nismë të tillë. Besoj se atë që institucionet ndoshta nuk do të mund ta realizonin meqë shikojnë me pak me syza skematike ndoshta dhe nacionaliste, domethënë e pamundëson në njëfarë mënyre pasqyrimin e vërtetë të pasojave dhe krimeve të bëra gjatë periudhës së luftës, kështu që shoqëria civile ndoshta do të duhej të dilte jashtë këtyre skemave dhe në njëfarë mënyre të pasqyrohej dhe vizatohej në mënyrë të paanshme e vërteta mbi atë çfarë ka ndodhur në tokën e ish-Jugosllavisë, ne kishim me thënë.

Pyetja ime do të ishte, a mendoni që ndoshta efekti pozitiv i këtij hulumtimi mbi pasojat e luftës më shumë do të kishin ndikim në normalizimin e marrëdhënieve tash e tutje se sa në njëfarë mënyre për atë efektin e pasqyrimin mbi pasojat. Pra, a mendoni që realisht më shumë do t'i relaksojë marrëdhëniet kur dihet që në njëfarë mënyre janë ende marrëdhëniet e përkeqësuar. Kaq pata!

VETON MUJAJ: Po marrim disa pyetje, komente dhe shprehje të praktikave e pastaj ato pyetjet që mblidhen për to do të përgjigjemi. OK. Për deri sa nuk ka pyetje tjetër, atëherë për pyetjen, Nora do të përgjigjet.

NORA AHMETAJ: Armend, kjo është një përgjigje imja por edhe të tjerët dhe panelistët që janë këtu me eksperiencë dhe kanë marrë pjesë në konsultime mund të shtojnë diçka. Pse është komisioni dhe pse ne mendojmë që është i domosdoshëm? Vetëm të marr një të dhënë prej data-bazës ose prej hulumtimeve të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar i cili jep numrin që shtetet e ish-Jugosllavisë kanë dalë vetëm me një të dhënë për të zhdukurit - më 34.325 persona të zhdukur. Me punën e palodhshme të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe të organizatave joqeveritare të gjithë rajonit por edhe organizatave tjera ndërkombëtare, presioneve të mëdha prej bashkësisë ndërkombëtare ndaj shteteve është arritur që një pjesë e madhe diku 60% e personave të zhdukur të gjenden ose eshtërat e tyre dhe 20 vjet, të them, pas të gjitha luftërave që kanë ndodhur në ish-Jugosllavi në të gjitha republikat, që tash janë shtete, duke e përfshirë edhe Kosovën 17.000 persona janë të pagjetur.

Unë po e përmend rastin e Kosovës dhe unë besoj se Bosnja e Kroacia dhe Serbia i kanë të njëjtat probleme. Çka të bëjmë për ata 17.000 persona të pagjetur?

Prej vitit 1999 deri në vitin 2010 derisa ka qenë UNMIK-u prezent në Kosovë janë formuar disa komisione qeveritare për kërkimin e personave të pagjetur, tash bëhet presion edhe përmes EULEX-it dhe ende gjenden varreza masive me persona të zhdukur qoftë në Serbi apo në vende tjera. Problemi më i madh është ende në Bosnje ngase numri i të zhdukurve është më i madh, si dhe në Kroaci.

Ne mendojmë pasi që shtetet nuk kanë treguar ndonjë sinjal pozitiv për bashkëpunim, dhe sidomos me ata që kemi marrëdhënie të ngjira dhe pothuaj se nuk kemi marrëdhënie në mes të Kosovës e Serbisë. Ne si shoqëri civile mendojmë dhe po marr rastin vetëm për personat e zhdukur, por ka edhe shkelje të drejtave tjera të njeriut. Ne shohim se formimi i komisionit jo vetëm që ka me i zbut marrëdhëniet, por me verifikimin e fakteve do të tregojë edhe një të vërtetë tjetër, mirëpo do të bëhet presion nga se shtetet apo qeveritë do të pajtohen dhe shpresojmë se do të japin informata, do të bashkëpunojnë me komisionin dhe të implementojnë KOMRAandimet që dalin nga ky komision, për rastin konkret, për personat e pagjetur.

Edhe një herë po e ceku, ka edhe shumë shkelje të drejtave të njeriut, mirëpo personat e pagjetur janë si plagë e hapur.

Në anën tjetër, më duhet ta ceku, komponenta e dytë e Bashkimit Evropian është bashkëpunimi strategjik rajonal dhe pa bashkëpunimin, sepse nuk nënkupton vetëm bashkëpunimi rajonal dhe nuk nënkupton vetëm bashkëpunim në fushën e ekonomisë, por ballafaqimin edhe me të kaluarën, ndërrimi ose dhënia e marrja e informatave të gjykatave, bashkëpunimi i gjykatave në rajon dhe liria e lëvizjes, pastaj edhe disa tema tjera, kështu që ne shohim si opsion të fundit, po qe se ky komision formohet dhe po qe se shtetet normalisht e formojnë janë edhe të obliguara të japin informata edhe lidhur me zbatimin e KOMRAandimeve të këtij komisioni. Ne mendojmë dhe së paku jemi shumë të orientuar pozitivisht që do të ketë sukses dhe ndoshta do t'i zbutë marrëdhëniet në rajon të disa shteteve, por edhe konkretisht të Serbisë dhe Kosovës.

Ky është mendim i imi. Nuk di ndoshta tjerët kanë të shtojnë diçka tjetër?

VETON MUJAJ: OK. Po vazhdojmë. A ka kush tjetër? Po, urdhëroni!

RRAHIM LIMANI: Mirë dita për të gjithë të pranishmit! Unë pra jam Rrahim Limani, jam nga Shkupi. Prezentohem si përfaqësues i Shoqatës së veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

Iniciativa dhe forumi i cili është mbledhur sot, mendoj se është qëllimshëm, mos të them edhe fisnik, por duke kaluar menjëherë në temë do të kisha thënë ose do t'i kisha shprehur disa mendime të mia lidhur me atë se çka më tutje.

Paraprakisht mendoj se më vjen keq që ne në këtë kohë, në fillim të shekullit XXI të merremi me pasoja të luftërave, të cilat ndodhën në ish-Jugosllavi. E them këtë pasi që mendojmë se e gjithë ajo që ndodhi në ish-Jugosllavi ka pas mundësi që të tejkalohet për ato probleme të cilat u paraqitën asokohe pa ardhur deri te konflikti, por fatkeqësisht strukturat udhëheqëse të atij shteti dhe strukturat e caktuara të shteteve të cilat dolën nga ajo përbërje federative, nuk kishin vizion të qartë se si dhe çfarë duhet bërë dhe si duhet zgjidhur problemet në momentin e caktuar. Dhe, fatkeqësisht ndodhi ajo që ndodhi dhe ne sot duhet të merremi edhe me pasojat dhe të shohim se si duhet shëruar ato plagë të cilat me të vërtetë janë të mëdha dhe është shumë vështirë për një kohë, unë mendoj, të shkurtër së paku edhe 10-15 vjeçare që ato gjëra edhe të harrohen, meqë jemi dëshmitarë të asaj se fatkeqësisht edhe më tutje ka struktura të caktuara që i udhëheqin shtetet aktuale të dala nga ish-Jugosllavia, të cilat edhe më tutje, edhe më tutje si duket nuk kanë vizion të qartë se çka duhet bërë dhe si duhet të jenë raportet në mes shteteve dhe raportet ndëretnike brenda vetë atyre shteteve.

Unë do të isha përqendruar edhe në një temë tjetër. Mendoj se një ndër çështjet kryesore me të cilat duhet të merret ky komision regjional do të ishte një satisfaksion për anëtarët e familjeve të të zhdukurve. Ne edhe në Maqedoni edhe më tutje ballafaqohemi me një sindromë të tillë ku një numër i caktuar i qytetarëve të këtij shteti evidentohen edhe më tutje si të zhdukur dhe për këtë arsye unë do të kisha thënë se në suaza të këtij komisioni regjional, nëse nuk është planifikuar, mendoj se është mirë të formohen nën-komisione kombëtare nëpër shtetet të cilat e përbëjnë këtë komision regjional. Për fillim kaq. Faleminderit!

VETON MUJAJ: Faleminderit, shumë! Dikush tjetër? Urdhëroni, Nora!

NORA AHMETAJ: Më falni, vetëm po ndërhyj në një nën-pyetje, sepse kjo pyetja juaj e dytë lidhur me komisionet nacionale mund të diskutohet gjatë paneleve tjera dhe mundemi me i dhënë hapësirë më shumë.

Ju i prekët strukturat e dala nga ish sistemet e kaluara të cilat kanë qenë të inkriminuara në krime dhe të cilat fatkeqësisht ende gjenden në institucionet e tanishme, pothuaj se në të gjitha shtetet e rajonit. Unë e ceka si komponentë të pestë të drejtën transitore – reformimi i institucioneve, transformimi prej rolit të abuzuesit në një rol të shërbyesit civil ndaj qytetarit dhe kjo pikërisht është ai transformimi kur quhet veting ose lustrimi, ose spastrimi i biografisë ose i gjithë personelit ose shërbyesve civilë të cilët e kanë një të kaluar të pastër dhe ata do të jenë në gjendje me i dhënë shërbime popullatës e të cilët gjenden në këto institucionet kyçe të sigurisë dhe kjo merr pak kohë.

Sa e di unë, vetëm Bosnja dhe ndoshta kolegët mund të më përmirësojnë, vetëm Bosnja e ka filluar këtë proces para disa viteve me gjykatës e prokurorë, mirëpo pikërisht ky transformimi i institucioneve merr shumë më shumë kohë, sepse neve na duket që veç ka shkuar shumë kohë, mirëpo së paku përvojat e vendeve tjera në rajon tregon që do punë shumë më të zellshme dhe durim.

VETON MUJAJ: Dikush tjetër? Dikush, prej organizatave dhe që kanë qenë pjesë e konsultimeve të shoqërisë civile, qasja. Urdhëroni!

NADICA MIRCOSKA: Kam nderin e veçantë që në emrin tim t'i përsërisht pjesëmarrësit dhe mysafirët e këtij debati rajonal për modelin e KOMRA-s dhe të shpreh kënaqësinë time që jam pjesëmarrës në këtë forum që ka për qëllim t'i kontribuojë në mënyrë aktive ruajtjes së paqes në të ardhmen dhe që të mos vijë më deri te konfliktet e armatosura, viktimë e së cilës gjithmonë është popullsia civile, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, religjioze apo racore.

Ky Forum rajonal duhet të shndërrohet në një Këshillë ku do të mblidheshin të gjitha kombet dhe kombësitë që jetojnë në hapësirat e ish RSFJ-së, për një arsye të vetme: sepse një numër i madh i këtyre njerëzve ishin viktimat të konflikteve të armatosura, ndërsa traumat, humbjet njerëzore dhe materiale që la pas edhe sot e kësaj dite nuk mund të shërohen dhe kompensohen në tërësi.

Më saktësisht, gjatë konflikteve të armatosura që shoqëruan dezintegrimin e RSFJ-së një numër i madh i njerëzve janë detyruar, pa dëshirën dhe fajin e tyre, të bëhen pjesë e konflikteve, pasojat e të cilave nuk mund t'i parashikojmë e lëre më që t'i kompensojmë në tërësi.

Vuajtjet dhe golgotat e shumë qytetarëve të pafajshëm do të lënë gjurmë të pashlyeshme në shpirtrat, vetëdijen dhe psikikën e tyre sepse te ata është lëkundur seriozisht besimi në humanitet për shkak të përjetimit të ngjarjeve të llahtarshme gjatë kohës së konflikteve të armatosura në ish RSFJ.

Ngjarjet që përjetuam në të kaluar duhet të shërbejnë si paralajmërim serioz për të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh se ku jetojnë, cilës kombësi, besim apo parti i takojnë. Për këtë arsye pjesëmarrësit në këtë forum duhet të angazhohen maksimalisht në mënyrë që postulatet në të cilat bazohet modeli i KOMRA-s të bëhen pjesë e punës dhe jetës sonë të përditshme, meqenëse vetëm në këtë mënyrë mund të shpresojmë se konfliktet e armatosura nuk do të jenë e ardhmja jonë.

Për ta realizuar këtë qëllim duhet të bisedojmë hapur dhe t'i paraqesim të gjitha vuajtjet dhe golgotat nëpër të cilat kanë kaluar kombet dhe kombësitë tona, që t'ua përkujtojmë njerëzve rëndësinë që ka jeta në paqe dhe barazi, me dëshirën që kjo mos të përsëritet.

Unë ju ftoj në emër të të gjithë njerëzve human që e duan jetën, barazinë, drejtësinë, që duan të përhapin energji pozitive dhe të ndërtojnë raporte tolerante, duke respektuar gjithçka që është e gjallë, të angazhohemi maksimalisht që konkluzionet tona të kuptohen si vërejtje serioze për të gjithë ata që ia japin vetes të drejtën që t'i zgjidhin mosmarrëveshjet mes kombeve dhe bashkësive etnike përmes dhunës së armatosur.

Për këtë arsye unë propozoj që ne të gjithë ta angazhohemi në vendbanimet tona, në vendet prej ku vijmë, në hapësirat e ish Jugosllavisë, që asnjëherë të mos harrohen krimet që kanë ndodhur, kurse

në anën tjetër, t'ua bëjmë të qartë të gjithëve se do të jemi të pa luhatur në përpjekjet tona për t'i identifikuar të gjithë ata që nxisin nacionalizmin, urrejtjen racore dhe religjioze dhe do të kërkojmë që ata të sanksionohen, meqenëse po ata ishin edhe përgjegjës kryesorë për të gjithë krimet që i kanë përjetuar njerëzit në këto hapësira.

Ne nuk guxojmë të lejojmë asnjë krim që të kalojë i pandëshkuar, pa marrë parasysh se kush e ka bërë atë. Me këtë rast duhet drejtuar gishtin nga të gjithë funksionarët që me qëndrimet e veta janë bërë bashkëpjesëmarrës në krim apo kanë kryer indirekt veprat të tmerrshme gjatë konflikteve të armatosura, nga vet fakti se posti i tyre dhe funksioni publik që ushtrojnë ka ndikim vendimtar në zhvillimin e ngjarjeve të tilla.

Krimet që janë kryer në territoret e ish Jugosllavisë nuk guxojnë të harrohen apo të amnistohen, pasi që në këtë mënyrë do t'i inkurajonim aventuristët e rinj që në të ardhmen do të provonin që të luajnë me zjarr.

Aktivitetet e KOMRA-s dhe organizatave të ngjashme joqeveritare duhet t'i vetëdijsojnë qytetarët se vetëm me angazhimin dhe përkushtimin e tyre për zbatimin e parimeve themelore të KOMRA-s mund të sigurojnë që më të afërmit dhe më të dashurit e tyre do të jetojnë në një mjedis human dhe civilizues ku jeta, paqja dhe liria do të garantohen për të gjithë. Ju faleminderit!

VETON MUJAJ: Faleminderit, shumë! Desha me ndërhy, meqë s'kemi të lajmëruar. Meqë po i afrohem kohës së pauzës dhe pjesës së dytë, do të thotë pas pauzës do të flasim konkretisht edhe një herë – pse KOMRA e pastaj edhe rrjedha e procesit konsultativ deri më tani dhe në njëfarë forme do ta kemi një lloj shpjegimi në agjendën në vazhdimësi se çka është bërë deri tash në këtë proces dhe për të gjitha këto tema unë besoj se ka me pas hapësirë të mjaftueshme gjatë ditës së sotme dhe së paku të kemi shprehje nga secili se çka mund të japë kontribut në këtë drejtim. Nëse dikush tjetër nuk është i interesuar... Urdhëroni!

LAZAR STOJANOVIQ: Lazar Stojanović nga Beogradi. Mua me nxiti të marrë fjalën diskutimi i fundit, i cilin mendoj se ishte i shkëlqyeshëm dhe unë e përkrah atë në tërësi, por desha të them se ne nuk duhet të merremi me ndarjen e iniciativave në nacionale dhe rajonale, ndoshta do të ishte më mirë të merremi me atë se çka është KOMRA, a mund të shërbej ajo për parandalimin e konflikteve dhe kryerjes së krimeve në të ardhmen, a na mëson për krimet e kryera që në njëfarë mënyrë të mbrohem nga përsëritja e tyre në të ardhmen.

Ne i përjetuam luftërat mes grupeve etnike dhe grupeve religjioze, jemi shtyrë në këto luftëra, është punuar shumë që këto luftëra të ndodhin dhe si rezultat i tyre ndodhën krimet. Nëse i qasemi asaj që ka ndodhur duke i analizuar luftërat, nuk do të bëjmë gjë tjetër veçse do ta vazhdojmë luftën me mjete tjera. Në raste të tilla, në vend se të qëllojmë mbi njëri-tjetrin e pastaj t'i numërojmë viktimat tona, apo t'i numërojmë viktimat e të tjerëve, ne konstatojmë se kjo ka ndodhur edhe pse nuk do të duhej të ndodhte, apo dikush ka bërë diçka kriminale që i ka dëmtuar interesat tona.

Pra siç thash, mendoj se kjo paraqet vazhdimin e luftërave me mjete tjera. Pas rënies së murit të Berlinit në botë kanë ndodhur ndryshime të mëdha konceptuale, ndryshime të tilla ku njerëzit nuk e shohin njëri-tjetrin nga pozita e përkatësisë etnike, nga prizmi i interesave shtetërore, apo nga përcaktimet religjioze ose ideologjike, nuk e shohin njëri tjetrin si armiq, prandaj krimet i shohin si ngjarje që kanë ndodhur dhe në të cilat ka viktima dhe kryes.

Prandaj, nëse këtyre ngjarjeve u qasemi sipas parimit se nuk është me rëndësi se çka ka bërë ky apo ai grup, ky apo ai shtet, kjo apo ajo forcë ushtarake, por nisem nga ajo se kemi viktima dhe kryes të krimeve, atëherë ne kemi një qëndrim të qartë për atë se çka ka prodhuar lufta, cila do luftë dhe për cilindo njeri.

Jam i mendimit se nëse i shohim gjërat nga ky këndvështrim, do të jemi në gjendje që këto situata t'i kuptojmë dhe t'i zgjidhim më mirë dhe për këtë arsye mendoj se jemi në rrugë të, si ta them, afirmimit të disa të drejtave të reja dhe këndvështrimeve të reja për shqyrtimin e të drejtave klasike

të njeriut, prandaj edhe dua të theksoj se nga Ballkani nuk vjen asnjëherë diçka moderne. Kjo iniciativë jo vetëm që është moralisht e rëndësishme por paraqet edhe një mundësi serioze faktike, historike dhe juridike që t'ju ndihmojë viktimave, por edhe të rinjve që të mësojnë diçka, të mësojnë diçka moderne, e cila nëse tregohet e suksesshme mund të shërbejë si inspirim për shumë vatra tjera të krizës në botë të ngjashme me këtë tonën.

Më vonë do të flasim...supozoj se dikush do të flasë sot për komisionet tjera për vërtetimin e të vërtetës në botë. KOMRA, ashtu siç e paramendojmë ne. Ky komision është i ndryshëm nga ato që kemi pasur deri tani në botë dhe është komisioni i parë me karakter rajonal i cili nuk ka të bëjë vetëm me një shtet, siç ishin komisionet e mëhershme për Kilin, Ruandën, Afrikën Jugore dhe gjetiu.

Ja pra, më nxiti diskutimi paraprak për të cilin mendoj se është i shkëlqyeshëm, ju faleminderit.

VETON MUJAJ: Do me thënë për këtë pjesën time...Atëherë, le të urdhërojë, e ka fjalën Eugeni.

EUGEN JAKOVČIQ: Eugen Jakovčiq nga „Dokumenta“ - Zagreb. Më vonë do të them diçka për ecurinë e procesit konsultues, pjesë e të cilit është edhe ngjarja e sotme këtu, por dua të theksoj se sa të rëndësishme janë këto procese dhe sa të rëndësishme janë konsultimet për plotësimin e qëllimit tonë të ardhshëm, pra për krijimin e komisionit rajonal, por edhe për atë që ra në sy gjatë pjesës së parë të debatit, fjala është për nevojat lokale, në rastin konkret për nevojat që ka Maqedonia. Prandaj, unë do t'ju lusja, sidomos gjatë pjesës së dytë kur kolegu Lazar dhe kolegja Saviq nga Bosnjë e Hercegovina të përqendrohen më shumë në temën pse na nevojitet KOMRA.

Po ju kërkoj që tani të përgatiteni për këtë pjesë të debatit dhe të na ndihmoni që të gjejmë përgjigjen në pyetjen: Pse i duhet KOMRA Maqedonisë dhe a ka nevojë Maqedonia për KOMRA-n?

Ju e dini se intensiteti i konfliktit, respektivisht numri i viktimave në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Kosovë ndryshojnë shumë me atë që ka ndodhur në Slloveni dhe Maqedoni. Prandaj, sot me plotë të drejtë shtrohet pyetje (përgjigjen e së cilës unë dua ta dëgjoj nga ju, për faktin se këtu kemi edhe shoqatat e viktimave) se sa është me rëndësi për Maqedoninë, meqenëse ky është edhe qëllimi ynë i përbashkët, që të themelojmë një organ, siç tha Lazari, organ rajonal, ku edhe do të duhej të qëndrojë fuqia e këtij organi, në karakterin e tij rajonal, në mënyrë që ta ndriçojmë, të përballemi dhe të vetëdijesohemi për të kaluarën historike.

Unë kam dëshirë që sot të marrë përgjigje në pyetjet: si mund të ndryshohet gjendja e tanishme në Maqedoni? A ekziston mundësia e demitizimit të konfliktit, duke pasur parasysh disa probleme që i kam vënë re si pjesëmarrës i konferencës së madhe të organizuar në muajin shkurt, kur edhe u fol pikërisht për demitizimin e vitit 2001 në Maqedoni, viti kur edhe ndodhën ato konflikte. Desha të theksoj se më vjen mirë që jam në Shkup, kjo është hera e parë që jam në Maqedoni, që jemi të gjithë këtu së bashku dhe unë ju lus... në vazhdim do të merrni më shumë informacion që mendoj se do ta bëjë debatin më të frytshëm dhe ajo që kemi nevojë, po e përsëris edhe një herë...është shumë me rëndësi ta dëgjojmë përgjigjen në pyetjen: pse i duhet KOMRA Maqedonisë dhe a mundet kjo iniciativë t'ju ndihmojë Maqedonisë dhe, natyrisht, shoqërisë maqedonase.

VETON MUJAJ: Ju faleminderit, Eugen! Realisht, kjo pjesë e parë ishte më shumë si një lloj hyrje dhe vërtet prej disa që e morën fjalën dhe që ishin prej pjesës së Maqedonisë, mu duk interesant, për shkak të asaj se nëpër konsultimet tjera, që kam marrë pjesë në vende tjera të ish-Jugosllavisë, shpesh kam dëgjuar elemente të njëjta çfarë u dëgjuan edhe nga të Maqedonisë, kështu që jep një shpresë që edhe Maqedonia është pjesë e këtij procesi, mund të jetë pjesë e këtij procesi dhe në njëfarë forme hallet në disa aspekte janë të njëjta dhe mund të zgjidhen bashkërisht.

Jasmina, e përfundova unë këtë pjesën time. Tash, sigurisht është pauza? Faleminderit!

JASMINA NAJDOVSKA: Mirë! Tash do të bëjmë një pauzë të vogël e pastaj do të vazhdojmë më tej.

Pauza

JASMINA NAJDOVSKA: A mund të fillojmë? Ju faleminderit! A ka mundësi që edhe mysafirët që janë mbrapa të ulen, mos të rrinë në këmbë. Mirë, është e drejtë e tyre. Po!

Unë shpresoj se gjatë këtij sesioni kolegët e mi do të sqarojnë gjithçka që nënkupton KOMRA dhe se në këtë sesion do të ketë diskutime shumë më aktive. Unë ju lus që pas fjalimit të pyesni për gjithçka që nuk e keni të qartë në lidhje me këtë nismë, të parashtroni pyetje në mënyrë që të mund të merrni përgjigje për të gjitha paqartësitë. Marko Veliçković dhe Lazar Stojanović do të flasin për atë se çka është KOMRA, çka punon, prej sa kohësh. Urdhëroni!

MARKO VELIÇKOVIQ: Ju faleminderit! Të fillojë me dy pyetjet që janë ngritur këtu. Së pari është shtruar pyetja që ka të bëjë me përmirësimin e marrëdhënieve dhe dikush theksoi se kjo iniciativë dhe puna e komisionit mund të ballafaqohet me probleme pikërisht për shkak se këto raporte janë të pa përmirësuara. Megjithatë, gjithë ky proces ka për qëllim pikërisht përmirësimin e marrëdhënieve. Ne jemi të vetëdijshëm se shoqëritë tona akoma janë të ngarkuara dhe të lidhura fortë me përkatësinë e tyre kombëtare dhe akoma manifestojnë qëndrime të ngulitura në identitetet tona kombëtare, që në të shumtën e herëve janë të rrejshme dhe rezultat i manipulimeve. Pra, këto luftëra kanë lënë pas vetes pyetje që kërkojnë përgjigje shumë të qarta, të sakta dhe precize. Nëse nuk ka përgjigje të tilla atëherë mbetet një hapësirë e madhe për gënjeshtër dhe manipulime. Ne, shoqëri civile, jemi sot dëshmitarë të një mitologjie të re, mitologjie e cila po ndërtohet pikërisht mbi këto të pavërteta dhe manipulime. Prandaj, shoqëria civile, ashtu siç ishte në atë kohë, e para tërhoqi vërejtjen në problemin e nacionalizmit, në mundësinë e konflikteve dhe pasojave katastrofale që kanë ato. Dhe nëse atëherë shoqëria civile nuk ka bërë sa duhet apo nuk ka mundur të bëjë sa duhet për t'i parandaluar këto krime, shoqëria civile sot i ka të gjitha mundësitë për të bërë mjaft që këto raporte për të cilat folëm të përmirësohen. Gënjeshtër, manipulimet por edhe interpretimet e ndryshme të asaj që ka ndodhur në të kaluarën janë ato që i kanë helmuar marrëdhëniet mes popujve. Dhe pyetja e dytë, ndoshta e kam prekur pjesërisht edhe këtë çështje në diskutimin tim, ka të bëjë me atë se a ka mundur të shmangen ato që na ka ndodhur viteve të nëntëdhjeta dhe se a ka mundur të tejkalohet ajo.

Kjo ka ndodhur! Do të thotë se nuk është bërë sa duhet që ajo të parandalohet. Ne sot duhet ta tejkalojmë situatën në të cilën gjendemi, situatën ku janë të çrregulluara raportet ndërshtetërore dhe ndër-njerëzore. Dje kam biseduar me një mik që nuk është pjesë e sektorit të shoqërisë civile, është një qytetar nga Serbia i cili ka qenë në Sarajevë dhe i ka pëlqyer shumë atje, por kur shkoi në Merkalë dhe pa përmendoren reagoi duke thënë se ajo përmendore është sulm kundër tij. Pra, ajo përmendore nuk e kishte efektin që duhet ta ketë, të nxisë dhembshuri për viktimat që humbën jetën aty. Konfliktet kanë bërë që kombet të shndërrohen edhe viktimat edhe heronj, kurse fatet e njerëzve të zakonshëm janë shtyrë në plan të dytë. Viktimat e vërteta nuk janë në plan të parë.

Unë tash do t'i kthehem pjesës së vërtetë, çka është komisioni rajonal dhe në ç'mënyrë duhet t'i zgjidhë problemet, përmes cilave mekanizma. Këto konsultime janë para së gjithash pjesë e një spektri më të gjerë të procesit të konsultimeve dhe, ashtu siç tha Eugeni, këto janë konsultimet e para, konsultimet e para rajonale në Maqedoni në kuadër të iniciativës për formimin e komisionit rajonal për vërtetimin e fakteve për të gjitha krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut në hapësirat e ish Jugosllavisë.

Duhet thënë se shoqëritë e ndryshme të vendeve të ndryshme, kanë përjetime të ndryshme që lidhen me konfliktet, qofshin ato luftëra, periudha të diktaturës apo aparteidit, siç ishte për shembull rasti me Republikën Jug-afrikane dhe të gjitha këto konflikte kanë lënë pas vetes viktimat dhe raporte të çrregulluara në shoqëri. Si përgjigje në nevojat e shoqërive të dala nga lufta për t'i zgjidhur këto probleme, në disa prej këtyre shteteve janë themeluar komisione të së vërtetës. Lazari tha se ky komisioni është i veçantë për faktin se ka karakter rajonal...dhe me të vërtetë të gjitha komisionet tjera ishin komisione nacionale, por të gjitha komisionet ishin të veçanta dhe janë storie në vete,

ashtu siç janë të ndryshme edhe konfliktet dhe problemet në vende të ndryshme. Vendi ynë... Vendi ynë!? Rajoni jonë ka kaluar nëpër një formë tjetër të konfliktit, pra nëpër një konflikt rajonal, prandaj sot flasim për komision rajonal.

Viktimat e këtyre konflikteve, viktimat e krimeve të luftës as sot e kësaj dite nuk i kanë realizuar të drejtat e tyre për t'u mësuar e vërteta dhe për drejtësi dhe shoqëria me qëndrimet që mban ndaj krimeve nuk mund të garantojë se këto krime nuk do të përsëriten në të ardhmen.

E drejta për të ditur të vërtetën varet nga vërtetimi i fakteve. Pranë gjykatave vendore dhe në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës po zhvillohen gjykimet ku përcaktohet përgjegjësia penale, përgjegjësia penale individuale për krimet e kryera. Megjithatë, këto procese nuk mjaftojnë për vërtetimin e fakteve për të gjitha krimet e kryera sepse numri i krimeve është aq i madh sa ua pamundëson viktimave që t'i realizojnë të drejtat e tyre përmes procedurave gjyqësore.

Prandaj, një nga detyrat e KOMRA-s si komision rajonal është që të krijojë regjistrin me emrat e të gjitha viktimave njerëzore dhe të përgatis një raport me fakte për ngjarjet që kanë ndodhur. Secila viktimitë duhet ta ketë dosjen e vet.

Puna e komisionit nuk do të jetë zëvendësim për punën e gjykatave, të cilat mbesin, po e përsëris edhe një herë, mbesin mekanizmat e vetëm juridik/ligjor për vërtetimin e përgjegjësive penale individuale për krimet e kryera, por hulumtimet që do t'i ndërmarrë komisioni do të mund t'ju ndihmojnë këtyre proceseve, sepse mund të nxjerrin në shesh ngjarje të reja, dëshmitarë të rinj dhe mund të shërbej si nxitje për viktimat që të dëshmojnë në këto procese. Sa i përket fatit të personave të zhdukur, përmes hulumtimeve të komisionit mund të zbulohen fakte të reja të cilat nuk kanë qenë të njohura deri atëherë, e të cilat mund të jenë të rëndësishme për zbulimin e fatit të tyre, mund të arrihet te informatat që kanë të bëjnë, për shembull, me zbulimin e ndonjë varreze të re masive.

Vërtetimi i fakteve është i rëndësishëm edhe për faktin se gënjeshtër që tashmë po qarkullojnë do ta humbasin besueshmërinë dhe se do të ndikojë që shoqëritë në rajon të arrijnë në një mirëkuptim të përbashkët për atë që ka ndodhur. Me këtë ngushtohet hapësira për manipulime, për zmadhimin apo zvogëlimin e numrit të viktimave për raste të caktuara të krimeve të luftës dhe krijohet një mirëkuptim i ri. Në Serbi ishte problem miratimi i deklaratës që e quan gjenocidin e kryer në Srebrenicë me emrin e vërtetë, ashtu siç e ka cilësuar edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, sepse një pjesë e madhe e opinionit publik kishte qëndrime tjera për këtë ngjarje, pra ekzistonte një kundërshtim i madh i opinionit publik dhe mungonte guximi politik që të bëhet një veprim vendimtar dhe të pranohet edhe deklarativisht ajo që është shkruar në aktgjykim.

Siç shihet edhe në këtë rast, gjykimet nuk janë të mjaftueshme, prandaj duhet gjetur një mënyrë optimale dhe adekuate që këto fakte t'ua bëjmë të ditura njerëzve.

Ka edhe një dallim mes komisionit dhe gjykatave. Komisioni i pozicionon ndryshe viktimat për dallim nga proceset gjyqësore ku ata në të shumtën e rasteve janë në rolin e dëshmitarëve dhe dëshmitë e tyre janë në funksion të vet procesit gjyqësor dhe qëllimeve të këtij procesi. Në gjykatë viktimat i drejtohen Trupit gjykues, dëshmitë dhe përjetimet e tyre ndërpriten shpeshherë nga gjykatësi apo avokati mbrojtës.

Gjatë këtij procesi konsultativ janë organizuar dëgjime publike të viktimave. Gjithë vëmendja përqendrohet në dëshminë e viktimës, në atë që tregon ai dhe këto dëshmi nuk ndikohen nga asgjë...do të thotë ekziston nevoja që viktima të tregojë atë që i ka ndodhur, që përsëri ka rëndësi të posaçme sepse gjatë gjithë kohës së këtyre ndarjeve nacionale ku kombet kanë humbur...pra...viktimat janë veshur me velon e misticizmit, mitologjisë... viktimat kanë humbur imazhin njerëzor, respektivisht njerëzit nuk i perceptojnë viktimat si njerëz real, për këtë arsye tregimet e viktimave janë të rëndësishme për ngjalljen e ndjenjës së dhembshurisë. Në momentin kur tek njerëzit do të krijohet kjo ndjenjë e dhembshurisë atëherë ne nuk do të jetojmë më në të njëjtin sistem të vlerave.

Organizatave e shoqërisë civile i kanë qëllimet e veta të deklaruara të cilat kryesisht kanë të bëjnë me demokracinë, të drejtat e njeriut dhe nëse ka një masë për vlerësimin e demokracisë, të drejtave të njeriut, atëherë kjo matet me të drejtat e viktimave dhe procesin përmes së cilit realizohen këto të drejta. Kjo do të thotë se përmes këtyre proceseve ndërtohet sistemi i ri i vlerave...nëse kjo shoqëri krijon ndjenjën e dhembshurisë për viktimat edhe shteti do të ndryshojë, nuk do të jetë ajo Serbi, Maqedoni dhe Kroaci që kanë qene, do të jenë shoqëri tjera... Shtrohet pyetja pse është dimensionin rajonal i komisionit kaq i rëndësishëm...?

Viktimat zakonisht janë të pranuar brenda kombeve të tyre. Me fjalë tjera, pjesëtarët e një populli kryesisht flasin dhe janë të gatshëm t'i dëgjojnë ato që u kanë ndodhur bashkëkombësve të tyre. Megjithatë, kjo nuk mjafton. Viktimat kanë nevojë që për përjetimet e tyre të dëgjojnë edhe ajo pala tjetër, e cila është përgjegjëse për atë që ka ndodhur. Është shumë e rëndësishme që viktimave t'u rikthehet besimi në humanitet. Viktimat e humbin besimin në humanizëm për shkak të mungesës së gatishmërisë dhe sensit të kësaj apo asaj pale, e cila shihet si kryese e veprave, që ta dëgjojë atë që u ka ndodhur atyre... e humb vetëbesimin, kurse mohimi dhe heshtja bëhen praktikë, legjitimohen dhe viktimat e humbin shpresën se do t'i realizojnë të drejtat e tyre, prandaj shpeshherë kanë probleme për t'u integruar në shoqëri. Prandaj, me këtë konstatim unë do ta përfundoj diskutimin tim, por edhe një herë po theksoj se nëse qëllimet e shoqërisë civile, organizatave joqeveritare... janë me të vërtetë ndërtimi i demokracisë dhe kulturës së të drejtave të njeriut, ky është pikërisht procesi që do ta përcaktojë ardhmërinë, demokracinë dhe gjendjen e të drejtave të njeriut në shoqëritë tona dhe në rajon.

JASMINA NAJDOVSKA: Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile nga Beogradi. Urdhëroni!"

LAZAR STOJANOVIQ: Unë jam Lazar Stojanović nga Beogradi. Jo, unë do të doja të jem Marko Veličković! Do të përpiqem të përgjigjem në pyetjet të cilat besoj se edhe ju këtu ia shtroni vetes, por meqenëse jeni njerëz me dinjitet, jeni shoqëri e civilizuar, ju nuk doni t'i bëni këto pyetje, atëherë më lejoni që unë të flas për ato.

Mendoj se pyetjet për të cilat fola janë si më poshtë: Çka na duhet kjo neve, pse tash? Erdhën ca njerëz dhe na folën për këtë farë KOMRA-n, çka na duhet kjo neve dhe për çka na duhet dhe para së gjithash a kemi ndonjë nevojë për të?

Pyetja e dytë është çka kërkoni ju dhe shoqërinë juaj civile në Shkup? Ju që po punoni në këtë çështje nga dy vjet dhe tash keni ardhur papritur, pse pikërisht tani dhe çka ju duhemi ne?

Dhe në fund, çka na duhet ky farë komisioni KOMRA, ne kemi nevojë të jetojmë më mirë, të ushqehemi pak më mirë, që rrogat të jenë më të mira, që nëse është e mundur të integrohemi në Evropë, kurse tani papritmas na del KOMRA, të cilin askush në Evropë nuk na i ve si kusht, kjo do të thotë se ne mund t'ia bëjmë edhe pa të dhe përse është kaq me rëndësi dhe paskemi nevojë për këtë farë KOMRA-n në rajon pikërisht në këtë moment.

Nuk e di nëse do t'ia dalë të përgjigjem me sukses në këto pyetje. Por, shpresoj se do të arrij t'ju inkurajoj që pas kësaj të mos hezitoni t'i shtroni këto pyetje, të cilat deri më tani nuk i keni parashtruar nga kurtuazia.

Gjatë kohës së luftërave mes viteve 1991 dhe 2001... derisa po zhvillohej lufta në Kosovë, Maqedonia nuk ishte e kursyer nga konflikti. E them këtë meqenëse gjatë asaj kohe punoja këtu për OSBE-në dhe u tmerrova derisa po vizitoja Stankovecin dhe qendrat tjera të pranimit ku ishin vendosur refugjatët nga Kosova. Që atëherë si unë ashtu edhe organizata për të cilën punoja ishim plotësisht të vetëdijshëm për aspektin e vërtetë të përndjekjes së njerëzve nga Kosova. Isha i vetëdijshëm se ky ishte krim i gjenocidit. Desha vetëm të them se gjenocidi nuk bëhet vetëm duke vrarë njerëz, por se edhe përndjekja masive e njerëzve është gjithashtu gjenocid dhe bëhej fjalë për

rreth 850.000 njerëz, pjesa më e madhe e të cilëve ishte detyruar të shpërngulet në Shqipëri, kurse një pjesë më e vogël, rreth 350.000, këtu në Maqedoni. Mirë, tash...gjatë asaj kohe Maqedonia kishte siguruar disa kushte themelore për refugjatët, pastaj ndërhyne organizatat ndërkombëtare dhe mund të thuhet se kishte një përpjekje serioze për t'u përkujdesur për këta njerëz dhe u manifestua një nivel befasues dhe krejtësisht impresiv i humanitetit. Por, nga e gjithë kjo shoqëria maqedonase nuk doli e padëmtuar. Kjo është me rëndësi. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për ju, por edhe për gjithë rajonin. Ajo baraspeshë e brishtë që ekzistonte në Maqedoni para konfliktit për pak sa nuk eksplodoi dhe nuk ndodhi një shpërbërje serioze dhe e dhunshme për shkak të atyre që ishin „për“ dhe atyre që ishin „kundër“ palëve në konflikt. Është fjala për NATO-n dhe Serbinë.

Për fat të mirë, kjo nuk rezultoi me viktima, u thyen shumë dritare, por këto nuk janë asgjë në krahasim me viktimat në njerëz. Megjithatë ajo që është me rëndësi, gjasat që në Maqedoni të shpërthej lufta ishin shumë të mëdha dhe se lufta varej nga ajo se si do të vendoset në ndonjë qytete tjetër dhe për asnjë moment nuk ishte e qartë nëse do të kishte luftë apo jo në Shkup.

Detyra e këtij koalicioni dhe detyra e komisionit të ardhshëm për KOMRA-n nuk ka të bëjë fare me këtë që foli. Ajo nuk do të merret me atë nëse kishte apo nuk kishte rrezik që Maqedonia të përfshihej në luftë dhe as për ndikimet sociale, psikologjike dhe politike të luftës në rajon, e cila e dëmtoi Maqedoninë. Pra, komisioni nuk do të merret me këtë, por unë dua të them diçka që është me interes vital për njerëzit në Maqedoni: të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre kombëtare, fetare apo bindjet politike, duhet të vërtetojnë atë që ka ndodhur në atë rajon dhe ta kenë një pasqyrë, qoftë edhe një pasqyrë të vrazhdë, qoftë edhe disa tipare të atij monstrumi që ka qëndruar para dere për katër-pesë vjet dhe të cilin, me sa i njoh unë njerëzit këtu, nuk e kanë harruar ende.

Se KOMRA është e rëndësishme për viktimat dhe realizimin e të drejtave të tyre këtë tashmë e keni dëgjuar dhe unë nuk mund ta flasë për këtë temë më mirë se Nora, Markoja apo Eugeni. Por kjo është e rëndësishme edhe për njerëzit që në atë kohë ishin fëmijë, njerëzit që tashmë kanë 20 vjet, kurse në kohën e luftërave ishin mes 7 dhe 10 vjet. Pse do të duhej t'u interesonte atyre ky problem? Ne, praktikisht, me këtë iniciativë...ne e kemi vështirë sepse nëse flasim në gjuhën gazetareske kjo është një temë jo e popullarizuar. Këtu ka një paradoks. Ne nuk mund të merreni me konfliktet, viktimat dhe pasojat e tyre derisa situata është e nxehtë dhe derisa njerëzit janë ende shumë të lidhur emocionalisht dhe të interesuar për ngjarjet që ka ndodhur gjatë luftës, ndërsa kur kjo kohë kalon, atëherë tema e konfliktit më nuk i intereson akujt. Ne këtu nuk po imponojmë një temë që nuk i intereson askujt, por po përpiqemi t'i gjejmë ato aspekte të këtyre konflikteve, që kanë të bëjnë me nevojën për t'i identifikuar viktimat dhe kryesit dhe për t'i përshkruar krimet dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur, si kanë ndodhur, sepse kjo u intereson njerëzve që në atë kohë kanë qenë fëmijë. Kjo është interesante dhe e rëndësishme për këta njerëz, ashtu siç është e rëndësishme për çdo polak të dijë se çka ka ndodhur në pyllin e Kaçinit, madje kjo u intereson edhe polakëve të rinj të cilët asokohe nuk kishin lindur.

E dini si, ka disa gjëra që na bashkojnë jo vetëm në kuptimin se ato paraqesin mite, pjesë të historisë, themele mbi të cilat ndërtohet kombi apo shteti, në bazë të së cilës formulohet politika dhe të cilat mësohen në shkollë, me qëllim që të forcohet fryma patriotike e qytetarëve. Kjo është pjesë e jona, e të gjithëve. Nëse njeriu thotë – unë jam polak- atëherë ai ka një marrëdhënie me atë pyllin e Kaçinskit. Nëse thotë unë jam palestinez, atëherë kudo që të jetë ai në botë, nuk është e mundur të mos identifikohet me atë që po ngjet në Palestinë në këtë moment. Mutandis, mutandis, kjo vlen edhe për hebrejtë, vetëm se ata flasin për gjëra që kanë ndodhur shumë më parë. Nëse një njeri thotë se ai është hebre, është e pamundur që të mos dijë se çka ka është Holokausti. Prandaj, mendoj se për të rinjtë kjo është diçka shumë e rëndësishme njësoj e rëndësishme sikurse edhe për ata që kanë marrë pjesë në këto konflikte.

Ka vetëm edhe një gjë, por mbase ajo i përket më shumë problematikës së të drejtave të njeriut dhe është një çështje e përgjithshme e jo diçka që ka të bëjë me interesin e njerëzve këtu. Kjo është e drejta e publikut që ta mësojë të vërtetën. Gjithë korpusi i të drejtave të njeriut është krijuar jo shumë kohë më parë, pak pas Luftës së Dytë Botërore, dhe ai ende po zhvillohet intensivisht dhe këtë status nuk e kanë marrë shumë nga të drejtat e njeriut për të cilat është vërtetuar se janë të qenësishme për të. E drejta e publikut që të dijë të vërtetën është ajo që karakterizon iniciativën të cilën po e zhvillojmë ne. Nga kjo dalin edhe shumë detyrime të rëndësishme për jetën e njeriut siç është ajo se shteti duhet t'ju përgjigjet, se nëse policia e sekrete zhvillon hetime kundër jush, në një moment të caktuar ata duhet t'ua japin ato dokumente juve. Nëse ka ndodhur diçka në historinë e shtetit tuaj, apo cilitdo shtet në botë, gjithkush ka të drejtë ta dijë dhe kjo nuk është me rëndësi vetëm në aspektin shkencor, nuk është me rëndësi vetëm për hulumtimet dhe studimet historike, por është para së gjithash me rëndësi për njerëzit që jetojnë në ato shtete, për njerëzit që jetojnë në botë sepse ata duan që veprimet e tyre t'i bazojnë në njohuri/fakte dhe jo në supozime dhe mitologji të cilat ua ka përcjellë dikush, ndryshuar. Bëhet fjalë për një të drejtë krejtësisht të re, të drejtën më të re në listën e të drejtave të njeriut dhe ende është në procesin e njohjes si e drejtë njerëzore në Kombet e Bashkuara, megjithëse akoma nuk e ka fituar statusin që e kanë të drejtat tjera të njeriut, siç është e drejta për jetë, pronë, punë, e drejta e viktimave për kompensim dhe kështu me radhë. Në emër të kësaj të drejte që po lind, mendoj se edhe në Maqedoni ka interes që publiku të dijë të vërtetën. Tash po përfundoj, nuk dua ta marrë kohën që Eugeni ka në dispozicion për fjalimin e tij, por vetëm desha të di: Çfarë pyetje keni për ne? Hajt, le të themi, pse mendoni që iniciativa për KOMRA-n është me rëndësi për ju?

Për ne që vijmë nga pjesë të ndryshme të rajonit para së gjithash ishte e rëndësishme që iniciativën për vërtetimin e fakteve për viktimat ta hartojmë si iniciativë të përbashkët. Ishte e natyrshme që këtë proces e filluam në mjediset ku konfliktet ishin më të fuqishëm dhe ku numri i viktimave ishte më i madh. Pa një fillim të tillë, as që ia vlen të hyjmë në bisedime më të gjëra. Prandaj, ka dy vjet që po përpiqemi t'i bashkojmë njerëzit nga Kosova, Bosnja, Kroacia, Serbia për t'i identifikuar viktimat dhe krimet që kanë ndodhur gjatë konflikteve në territoret e këtyre shteteve. Procesi nuk ishte i lehtë, por kemi arritur që, për shembull, t'i mbledhim shoqatat e robërve nga shtetet e ndryshme, në mënyrë që të bisedojnë së bashku, pranë të njëjtës tavolinë, në mënyrë që ta kuptojnë dhe ta thonë se interesat e tyre janë të njëjta, pa marrë parasysh se nga cilat shtete vijnë. Sepse ai është rob, ai është viktimë. Kemi arritur ta tejkalojmë problemin që lind nga fakti se unë isha i robëruar dhe mbahesha nga rojet që ishin pjesëtarë të kombit tënd dhe ti ishe rob që mbaheshe nga pjesëtarët e kombit tim. Kjo është një arritje e madhe.

Ne kemi zhvilluar konsultime edhe me intelektualët, me të rinjtë, me familjet e viktimave, me shoqatën e juristëve...kjo ka rëndësi të madhe dhe ne vazhdojmë të kemi konsultime të kohëpaskohshme me shoqatën e juristëve, sepse një numër i madh i problemeve me të cilat merret KOMRA janë të lidhura me analiza dhe vlerësime juridiko-profesionale...thash se kishim konsultime me intelektualët...kurse do të doja ta përmend posaçërisht një konsultim që kishim në Beograd para 10 ditësh. Është fjala për konsultimet me bashkësitë fetare në Serbi ku të gjithë e kanë përkrahur KOMRA-n, apo thënë më mirë, iniciativën për KOMRA-n dhe pres që të gjithë t'i bashkohen koalicionit. Pra, tash, kur kemi arritur të marrim përkrahjen e grupeve të caktuara dhe individëve, ne kemi rastin që të rritemi dhe ta pasurojmë përmbajtjen e asaj që kërkojmë. Kur themi se ne kërkojmë të krijohet regjistri i të gjitha viktimave, ky paraqet një qëllim shumë preciz dhe të qartë, por kjo nuk e tregon gjithë atë që qëndron prapa kësaj, kurse prapa kësaj qëndron kërkesa për përmirësimin e komunikimit dhe identifikimit të interesave të përbashkëta të grupeve shumë të ndryshme me interesa të ndryshme.

Tash do të them diçka që ndoshta nuk do t'ju pëlqej të gjithëve, por është parim i kësaj iniciative. Neve nuk na pengon askush. Ne nuk bëjmë politikë. Nuk është e thënë që të pajtohemi politikisht me njeriun që bëhet pjesë e kësaj iniciative. Nëse ndonjë person apo organizatë apo parti politike, apo kushdo qoftë është i interesuar të dijë më shumë dhe nëse ky institucion apo njeri i pranon rregullat dhe është i mendimit se me të vërtetë ia vlen të bëhet ajo që bëjmë ne, atëherë ai është i mirëseardhur. Këtë nuk e kemi shpikur ne. Politika moderne mund të zhvillohet edhe përmes një aktiviteti shoqëror për ndryshime.

Unë nuk jam antiglobalist, por kam mësuar shumë nga ata. Kur shikoni këtë grumbull njerëzish që në mënyrë efikase i provokon shtetet dhe takimet e shefave të shteteve, kundër të cilëve është e drejtuar revolta e tyre, atëherë vëreni se bëhet fjalë për një spektër të gjerë të njerëzve nga e majta në të djathtë, të të gjitha besimeve dhe kombeve, prej të çmendurve deri të gjenitë, të të gjitha përcaktimeve fetare, politike por edhe seksuale dhe prej grupeve me përcaktime kundër dhunës deri te ato shumë të dhunshme. Aty ku njerëzit e shohin interesin e tyre të përbashkët për të bërë diçka bien të gjitha barrierat dhe ata punojnë se bashku dhe kjo në të vërtetë paraqet një platformë të fuqishme për veprim në shoqëri, e cila mund të tregohet e suksesshme dhe mund të çojë në fitore.

E treta, pra, për çka na duhet iniciativa KOMRA? Ne jemi si ish Austro-Hungaria, si shtetet e Kaukazit, si Azia e Mesme, pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik...ne jemi rajon ku në kokat e njerëzve ka mbetur e ngulitur se dikur kanë jetuar në të njëjtin shtet. Kjo nuk duhet të shihet si përpjekje për t'i inkurajuar idetë apo lidhjet që do të çonin kah bashkime të reja politike. Kjo është çështje e grupit apo njerëzve që janë pjesë e tij dhe që atyre u intereson së tepërmi. Por, në gjithë këtë rajonalitet të trashëguar ekziston një potencial që mund të na ndihmojë të bëjmë diçka në nivel rajonal. Përpos KOMRA-s shpesh u bien të dëgjoni edhe për iniciativat tjera, para së gjithash iniciativat ekonomike. Autostrada prej Vjene deri në Selanik kalon nëpër disa shtete ku të gjitha kanë interes që kjo rrugë të ruhet sepse është burim i të ardhurave të mëdha. Vepra më e rëndësishme dhe më e madhe ekonomike në gjithë rajonin, e cila më nuk quhet Autostrada „Vëllazërim-Bashkim“, por sido që të quhet, ajo është rezultat/fryt i punës sonë të përbashkët. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për KOMRA-n. Në këtë rajon dhe në ish-shtetin tonë ndodhën luftëra që sollën deri të shkatërrimi i shteti që kishim, i cili pati efekte të fuqishme tronditëse në gjithë Evropën, por para së gjithash për neve që jemi nga ky rajon. Për këtë arsye, fotografinë e plotë të kësaj lufte dhe pasojave të kësaj apo këtyre luftërave, nëse keni dëshirë mund ta theksojmë se kishte disa luftëra, mund ta kemi vetëm nëse mbajmë një qasje rajonale në raport me konfliktin.

Ndoshta e keni vënë re se unë vazhdimisht flas për luftën. Ekziston një rrymë, një mendim shkollor që refuzon të flasë për luftën dhe në vend të kësaj flet për konflikte etnike, kurse nganjëherë edhe për konflikte etnike dhe religjioze. Nuk kemi asgjë kundër që edhe këta njerëz t'i bashkohen kësaj iniciative. Meqenëse qëllimi ynë është që ta krijojmë regjistrin e viktimave dhe t'i emërtojmë forcat që kanë shtënë dhe grupet që kanë pësuar, ne e kemi lirinë që këto ngjarje t'i quajmë luftëra. Por, po e theksoj, nuk është e domosdoshme që ata që na bashkon ta quajnë luftë.

Dhe se fundi dua të them se ne jemi iniciativë qytetare dhe kemi për qëllim t'i mbledhim një milion nënshkrime dhe kjo iniciativë ka buruar nga disa prej organizatave qeveritare më të respektuara dhe më mirë të organizuara në rajon, kurse tani po zgjerohet ngadalë dhe është shndërruar në koalicion që tashmë bashkon 600 subjekte dhe 500-600 individë të anëtarësuar, por ne nuk jemi kurrfarë shteti... vet fjala jo-qeveritare tregon se ne nuk jemi as organizatë ndër-qeveritare e as qeveritare...kjo është një iniciativë që zhvillohet brenda shoqërisë civile dhe udhëhiqet nga organizatat jo-qeveritare. Do të ishte mirë sikur atë që po përpiqet ta bëjë koalicionin, pra hulumtimin e krimeve, përgatitjen e listave me emrat e viktimave dhe përshtetimin e krimeve, ta bënte shteti, sepse komisioni nuk do ta kishte autoritetin e duhur. Nuk ekziston asnjë mënyrë, nuk mund të paramendohet që ta zëmë, për shembull, Nora, Eugeni, Marko dhe unë të ndërmarrim diçka e pastaj

të shkojmë në një shtet tjetër dhe të themi: – hej, a e dini çka, ne duam t’i numërojmë.... çka bëni ju këtu, kjo nuk bëhet në këtë mënyrë, prandaj prapa një nisme të këtillë duhet të qëndrojnë autoriteti i shtetit dhe ajo që i vështirëson punët në këtë aspekt është fakti se kjo është një iniciativë që zhvillohet në nivel rajonal, prandaj nevojitet bashkëpunimi i të gjitha shteteve të rajonit. Ky është qëllimi ynë, por këtu unë nuk do të doja fare ta hapim këtë temë, ne jemi plotësisht se kjo hap disa çështje politike-ndërkombëtare dhe juridike-ndërkombëtare të cilat duhet t’i zgjidhim dhe aktualisht ne po jemi duke zhvilluar bisedime në lidhje me to. Por, këtë po e përmend për faktin se ne nuk presim të kemi probleme të kësaj natyre në Slloveni apo në Maqedoni dhe për këtë arsye ju nuk ishit të parët të cilëve u jemi drejtuar dhe marrëveshja që shpresoj ta arrijmë shumë shpejtë dhe lehtë me Qeverinë e Maqedonisë dhe Qeverinë e Sllovenisë, kurse me Qeverinë e Malit të Zi ajo tashmë është duke ndodhur, llogarisim se do të jetë një mjet i fuqishëm i presionit ndaj qeverive tjera në rajon. Para tre-katër ditësh zhvilluam konsultime në Kuvendin e Malit të Zi me përfaqësuesit e tyre politik. Tash besoj se e kuptoni që shtetet të cilat nuk i përmenda, të cilat paraqesin problem shumë më të madh, mund të reagojnë ndaj këtij presioni për të cilin po flasim.

Duke qenë se jemi iniciativë qytetare ne i kemi vënë vetes si detyrë të mbledhim një milion nënshkrime, përmes të cilit do të ushtrojmë presion në qeveritë që ta nënshkruajnë atë. E tash, që të mos mendoni se unë jam naiv apo budalla, që ndoshta edhe jam, por shpresoj se jo sa i përket kësaj nisme, t’ju them se një milion nënshkrime përbëjnë 5 për qind të popullsisë së rajonit, në të vërtetë rreth 4 për qind. Pra, nëse ne dalim para qeverisë vetëm me këto nënshkrime dhe nuk kemi mjete tjera të presionit, ata, meqenëse janë njerëz të civilizuar dhe të këndshëm do të thonë: Po, ju faleminderit, ju jeni një grup i madh i njerëzve, ne do ta marrim dokumentin tuaj, do të na duhet pak kohë të mendojmë për këtë dhe sapo të kemi marrë ndonjë vendim do t’ju lajmërojmë dhe përgjigja e tyre sipas të gjitha gjasave do të vijë në gjeneratën e ardhshme. Ne duhet t’i bëjmë për vete forcat e vërteta shoqërore, forcat të cilat qeveritë nuk mund t’i anashkalojnë, të cilat kanë ndikim te qeveritë dhe ndaj të cilave qeveritë janë të ndjeshme. Ne kemi nevojë për këto që thash në mënyrë që t’ia arrijmë qëllimit, e ky është që qeveritë ta nënshkruajnë formimin e komisionit të së vërtetës, për të cilin po flasim. Kush janë këto forca? Ne kemi filluar me bashkësitë fetare. Aktualisht jemi zgjeruar dhe po përpiqemi të fitojmë mbështetjen e shoqatave të ndryshme profesionale sportive, institucioneve arsimore, mediave- për arsye se mendojmë se bashkëngjitja e tyre një koalicioni të këtillë është e natyrshme – sepse kjo përputhet edhe me programin e tyre dhe me atë me çka ato merren dhe bëjnë. Gjithashtu, këtu bëjnë pjesë edhe shoqatat e mjekëve, dhomës së avokatëve, disa universitete, e di se sot këtu kemi shumë përfaqësues të universiteteve, fakultetit për siguri...pra, këto gjëra janë të ndërlidhura. Nëse njerëzit e përkrahin këtë që bëjmë ne, ata e identifikojnë veten si përkrahës të iniciativës, e nëse janë anëtarë të koalicionit ata identifikohen edhe si bartës të programit që paraqet punën e tyre në njëfarë mënyre.

Dhe në fund, me këtë edhe po e përfundoj, kjo nuk është diçka që po ndodh vetëm në këtë rajon dhe ne nuk do të kemi vetëm përkrahje nga rajoni. Kjo është një çështje me karakter botëror. Kur përmendni Bosnjën apo Kosovën, gjithë bota ka dëgjuar për to. Ne duam t’ua përkujtojmë se Ballkani është vendi ku janë zhvilluar këto ngjarje. Këtë fushatë ne do ta zbatojmë përmes mjeteve bashkëkohore që janë zhvilluar në mënyrë të fuqishme këto njëzet vitet e fundit dhe që krijojnë efektet më të mëdha propaganduese, pra përmes internetit, haptas dhe në gjithë botën. Ju mbase mund të mendoni se kjo nuk ndikon aspak në qeveritë në rajon. Por, a ju kujtohet efekti që kishin petitionet e disidentëve të publikuara në mediat e huaja dhe për pasojë qeveritë e huaja ndodhshin në presion të qytetarëve të vet sepse opinioni publik pyeste se çka po ndodh në Jugosllavi. Si rezultat ato qeveri kanë ushtruar presion më të madh në Qeverinë e Jugosllavisë dhe për befasinë tonë Qeveria ka reaguar në këto presione.

Kjo ishte e gjitha që doja t'ju them, pra duhet që përmes një strategjie serioze të rritet kjo forcë shoqërore që do të ushtrojë presion tek qeveritë dhe në këtë kuptim edhe nëse kjo është një luftë siç e quajnë ushtarët – luftë në kushte të pafavorshme - unë jam optimist dhe mendoj se do ta fitojmë, para së gjithash me ndihmën tuaj dhe me ndihmën e shumë të tjerëve që do të na bashkëngjiten. Ne erdhëm te ju tash kur e kemi lansuar një fushatë të gjerë në publik dhe kur ndihemi të gatshëm të rritemi dhe të organizohemi më mirë. Gjatë kohës kur po organizonim konsultime të vogla, rreth një apo dy vite më parë, na u duket se është e parakohshme. Ja pra, çka do që të pyesni unë do të përpiqem t'ju përgjigjem. Ju faleminderit!

EUGEN JAKOVČIQ: Unë ju përshëndes edhe një herë dhe para së gjithash do të përpiqem të jem i shkurtër, për aq sa kjo është e mundur. Unë do të drejtoj fjalimin tim para se gjithash rreth asaj që e përmenda në fillim të sesionit të parë dhe kjo është: Pse iniciativa KOMRA në Maqedoni dhe në këtë aspekt me të vërtetë do t'i lusja kolegët dhe koleget, para së gjithash ata nga Maqedonia, që të na ndihmojnë në këtë drejtim dhe t'i dëgjojmë mendimet e tyre për gjithë këtë që u tha deri më tani si dhe për këto informacione kyçe të cilat dua t'i theksoj në fjalimin tim.

Mua më vjen jashtëzakonisht mirë që jemi në Maqedoni. Këto janë me të vërtetë konsultimet e para, por ky nuk është kontakti dhe takimi i parë që ka ky koalicion me Maqedoninë. Që vitin e kaluar, ish koordinatorja në Bosnjë dhe Hercegovinë, Aleksandra Letiq dhe unë, sikurse edhe kolegu Veton nga Peja, u mbledhëm së bashku dhe formuam një grup të vogël i cila i koordinoi proceset në Maqedoni. Unë gjithashtu kam marrë pjesë dhe kam folur për iniciativën e KOMRA-s në takimin e madh që organizoi SOROS në Maqedoni – Demitizimi i vitit 2001, pra demitizimi i këtij viti vendimtar dhe të rëndësishëm për Maqedoninë, në kontekstin për të cilin flasim. Përpos kësaj, në Forumin tonë kanë marrë pjesë edhe disa organizata nga Maqedonia, si për shembull Iniciativa për paqe nga Prilepi sikurse edhe disa shoqata tjera. Forumi është vendi ku ne takohemi në numër të madh ku marrin pjesë grupe të ndryshme dhe diskutojnë për komisionet, si një nga mekanizmat e rëndësishme të drejtësisë tranzicionale. Pra, është e qartë se me Maqedoninë është punuar dhe e kemi pasur në mendje sikurse që e kemi përfshirë në të gjitha dokumentet ku figurojnë Maqedonia dhe Sllovenia, gjë që është shumë me rëndësi...sot na duhet pikërisht përgjigja në pyetjen: Pse koalicioni për KOMRA-n në Maqedoni?

Mbrëmë, sikurse edhe gjatë javëve dhe muajve të shkuar, u përpoqa që t'i shikoj dokumentet që ekzistojnë...dhe në bisedim me disa njerëz në këtë konferencë, mendoj se konfliktet në Slloveni dhe Maqedoni, të cilat janë përfshirë në këtë proces, ishin të një dinamike dhe intensiteti shumë më të ulët dhe ndryshojnë rrënjësisht nga konfliktet e mëdha siç mund t'i quajmë ngjarjet që kanë ndodhur në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci dhe në Kosovë, prandaj përfshirja e Maqedonisë dhe Sllovenisë në iniciativën KOMRA është edhe një nga sfidat e mëdha, një sfidë e madhe që qëndron para këtij koalicioni.

Para se të theksoj rëndësinë që ka kjo qasje rajonale dhe çka e ka iniciuar atë, unë vetëm do të doja të qartësoj disa gjëra. Kur bëhet fjalë për komisionet për të vërtetën dua t'ju sqaroj se kemi dy lloje të drejtësisë, drejtësia që ndëshkon, e cila zhvillohet në gjykatë. Pra, kemi gjykatat të cilat vënë në vend dhe ripërtërijnë drejtësinë retributive/ndëshkuese...Ndërsa këtu flasim për një formë tjetër të drejtësisë, që arrihet përmes një procesi të lodhshëm dhe të gjatë. Megjithatë ne mendojmë se ekzistojnë mekanizmat që mund të japin një prospekt shumë më të gjerë në këtë problematikë dhe ky është një nga ata mekanizma.

Pse është e rëndësishme KOMRA? Unë do ta përmend këtu atë që e konsideroj një nga momentet më të rëndësishme të iniciativës tonë dhe kjo është se KOMRA bazohet në supozimin se suksesi për ballafaqim me të kaluarën nënkupton para së gjithash qasjen rajonale, sepse pikërisht qasja rajonale e bën të kuptueshëm dhe njeh kontekstin historik dhe politik në të cilin janë kryer krimet e luftës. Me fjalë tjera, vetë krimet e luftës kuptohen në kontekst rajonal dhe shpresa për pajtim, pra për pajtim të

vërtetë, kthehet në shpresë për pajtim rajonal. Kjo është shumë e qartë dhe këtë e kanë kuptuar organizatorët e iniciativës në vitin 2005, sepse e kanë parë se ajo që po ndodhte në gjykata nuk ishte e mjaftueshme dhe ekzistonte nevoja për t'u bërë diçka më tepër. Dështimi i gjyqësorit nuk është vetëm për shkak të problemeve që ka ai, si në Maqedoni ashtu edhe në shtetet tjera të ish Jugosllavisë, por thjesht për arsye se numri i krimeve të kryera gjatë luftës është aq i madh sa që është e pamundur që të gjitha ato lëndë të procedohen, që të gjithë kryesit dhe përgjegjësit për këto krime të nxirren para drejtësisë. Për këtë arsye, është e nevojshme, ashtu siç e përmendi dikush nga parafolësit apo parafolëset këtu, që sikurse edhe në disa pjesë tjera të botës edhe këtu të ekzistojnë mekanizmat shtesë që do ta shtynin më tej gjithë këtë iniciativë dhe kjo është shumë, shumë me rëndësi.

Unë do të thosha se kjo iniciativë është një kritikë, një kritikë shumë e madhe për atë që nuk kanë bërë qeveritë dhe institucionet gjatë viteve të shkuara në lidhje me ballafaqimin me të kaluarën. Unë do ta theksoj atë që e përmendën edhe disa kolegë apo kolege, në Kroaci me të vërtetë nuk ka ndonjë institucion që do të merrej me të ashtuquajturat komunikimin e këtyre fakteve. Nga ana tjetër, në Bosnjë dhe Hercegovinë ekziston ideja për një komision nacional. Dhe ajo që është shumë me rëndësi, në Serbi ekzistonte një ide e turpshme, më duhet ta quaj ashtu, ku Kryetari Koshtunica u përpoq që përmes një të ashtuquajturi Komision për të vërtetë dhe pajtim të përcaktonte të vërteta apo atë që nënkupton emërtimi i këtij komisioni. Pra, ka pasur qasje të ndryshme për krijimin e këtij mekanizmi shtesë, por kjo është iniciativa më serioze deri më tani. Në këtë moment ne kemi mbledhur një numër të madh të organizatave joqeveritare dhe po e theksoj edhe një herë e gjithë kjo nismë ka filluar në vitin 2005, pikërisht me diskutimin për mekanizmat e nevojshëm për vërtetimin dhe prezantimin e fakteve mbi krimet e luftës. Ne kemi lëvizur gradualisht, dhe unë do të thosha se jemi pjekur së bashku me këtë iniciativë, respektivisht ajo është pjekur së bashku me reagimet e pjesëmarrëseve dhe pjesëmarrësve në këto takime. Kjo është ajo që vlen.

Kjo iniciativë nuk ka rrjedhur nga Brukseli, e as nga ndonjë prej qeverive të rajonit. Ajo ka rrjedhur nga shoqëria civile, kurse shoqëria civile, siç e dini, reagon para së gjithash nga nevojat. Këto para së gjithash ishin disa prej organizatave më të mëdha dhe më të rëndësishme të cilat janë marrë me monitorimin e gjykimeve për krime të luftës, ku edhe kanë vënë re se gjykimet nuk janë të mjaftueshme.

Pas kësaj e kemi zhvilluar debatin edhe më tej dhe kështu arritëm në një prej datave më të rëndësishme për iniciativën tonë, e ky është viti 2008, përkatësisht fundi i këtij viti, kur edhe zyrtarisht e kemi themeluar këtë koalicion në Prishtinë, Kosovë. Ajo që unë dua të theksoj është fakti se Koalicioni për KOMRA-n në të vërtetë është një rrjet i organizatave joqeveritare, shoqatave dhe individëve të cilët e përfaqësojnë dhe afirmojnë këtë iniciativë. Iniciativa për KOMRA-n synon ta formojë Komisionin rajonal dhe të pavarur me mandat që t'i vërtetojë dhe t'i paraqes publikisht faktet për krimet e luftës. Do të thotë, Koalicioni për KOMRA-n tashmë e kemi, por KOMRA-n nuk e kemi ende. Ashtu siç dëgjua nga koleget dhe kolegët tanë, ne kërkojmë që Komisionin rajonal para së gjithash ta themelojnë qeveritë dhe parlamente, sepse ajo që është shumë me rëndësi dhe që ndoshta kolegët nuk e kanë përmendur, unë do të flas diçka vetëm taksativisht...shpresoj se e keni të qartë gjithë këtë që po e them. Ky mekanizëm dhe ky komision do të kishte katër veçori kryesore: Komisioni do të ishte organ hulumtues, do të ishte organ ekstra-gjyqësor, do të ishte organ zyrtar dhe do të ishte rajonal. Unë kam folur për disa nga këto, megjithatë është me rëndësi shumë të madhe të përmendet se komisioni nuk do ta përcaktojë përgjegjësinë penale sepse si mekanizëm i drejtësisë tranzicionale ai nuk merret me përcaktimin e përgjegjësinë penale; ai para së gjithash fokusohet në zërin e viktimës, më tej fokusohet në njerëzit që kanë vuajtur krimet dhe për këtë mekanizëm është shumë me rëndësi të shikohet nga këndvështrimi i viktimave për të kuptuar se si ka ndodhur krimi. Prandaj për këtë Komision, respektivisht për këtë mekanizëm të drejtësisë tranzicionale shpeshherë

thuhet se paraqet platformë për zërin e viktimave, që në të vërtetë edhe është, por duke mos e ulur aspak rëndësinë e gjithë asaj që zhvillohet para trupave gjykuese, me fjalë tjera, asaj që zhvillohet në proceset para gjykatave në rajon.

Natyrisht se ju do të shtroni pyetjen: Mirë, por pse kemi nevojë për këtë, edhe Lazari provoi ta sqarojë pse kemi nevojë për KOMRA-n. Përgjigjen në këtë pyetje e japin numrat. Gjykata e Hagës ka arritur të ngrisë 93 aktakuza, kundër vetëm 161 personave. Nga ana tjetër, mendohet se...unë nuk e di me siguri, për këtë mund të më ndihmojnë kolegët nga Bosnja dhe Hercegovina, supozohet se vetëm në Bosnjë dhe Hercegovinë kishte rreth 10.000 kryes të krimeve të luftës. E tash kur i vendosni në përpjesëtim këto shifra, atëherë e shihni se sa e pamundur është që proceset gjyqësore ta kenë fjalën kryesore.

Pse është e rëndësishme që ky organ të jetë zyrtar? Pse nuk është e mjaftueshme që ne si organizata joqeveritare të vazhdojmë sipas parimit të deritanishëm, t'i shkruajmë raportet tona, siç është ai se: Organizata ime punon në Kroaci... është e rëndësishme që konstatimet e Komisionit të jenë zyrtare, në mënyrë që të mos ndodhë ajo që zakonisht ndodh: vështrimi i krimeve varësisht nga përkatësia kombëtare ku nuk ka mirëkuptim dhe nuk ka shprehje të keqardhjes për viktimën dhe vuajtjet e të tjerëve. Prandaj, është e rëndësishme që ky komision rajonal përmes vërtetimit të fakteve për ato që kanë ndodhur në rajon të ketë rolin e një mekanizmi zyrtar që do t'iu kundërvihet mohimit të krimeve dhe, më besoni, kjo për viktimat është shumë e rëndësishme. Për viktimat është me rëndësi që të pranohen nga shtetet e tyre, por edhe më e rëndësishme është që të mos mohohet ajo që u ka atyre ndodhur nga shtetet tjera. Dhe kjo është shumë e rëndësishme dhe këtë e kemi përjetuar në debatet e shumta që kemi pasur deri më tani. Ne si organizatë e cila monitoron gjykimet për krimet e luftës, sikurse edhe Fondi për të Drejtën Humanitare, na ka rënë në sy se për njerëzit është me rëndësi që vuajtjet e tyre të njihen edhe në vendet tjera, sidomos në vendet nga ku ka buruar krimi, respektivisht nga ku kanë ardhur kryesit.

Një arsye tjetër e rëndësishme për qasje rajonale, pse është e rëndësishme qasja rajonale, unë mendoj se të gjithë ne kemi një shtet, dhe kjo është një fakt. Shtetet kanë kufijtë e tyre dhe ashtu siç kam thënë, në shumë raste konfliktet kishin karakter rajonal, për këtë arsye kryesit janë në një shtet, faktet janë në një shtet tjetër, kurse gjitha tjerat në një shtet të tretë dhe për këtë arsye për viktimat është shumë me rëndësi. Ka pasur shumë raste kur viktimat kanë ardhur në proceset gjyqësore plotësisht të papërgatitura, sikurse rasti llogorit Morinj, ku viktimat nga Kroacia vijnë në gjykimin që mbahet në Podgoricë, institucionet nuk i përgatisin fare. Në këtë gjykim ka munguar bashkëpunimi i prokurorisë, respektivisht qasja rajonale për vërtetimin e fakteve. Ky bashkëpunim ekziston vetëm në një nivel dhe aktualisht prokuroritë, respektivisht ministritë e drejtësisë të shteteve të rajonit po nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi. Ç'është e vërteta këto marrëveshje kanë të bëjnë vetëm me korrupsion dhe kriminalitet, por ne shpresojmë se këtë do të arrijmë ta zgjerojmë, respektivisht KOMRA-a do të jetë pikërisht ajo ndërlidhja që do të mundësojë përfshirjen e krimeve të luftës në këtë marrëveshje.

Do të flasë për një nga argumentet e fundit, që është njëherazi edhe një nga argumentet më të rëndësishme pse na duhet KOMRA...? Në rajon për momentin ka 16.000 persona të zhdukur. Ky proces ka stagnuar. Ai po ecën, por është duke ecur shumë ngadalë dhe mendoj se ky është një nga argumentet më të fuqishëm. Mendoj se ky është një nga argumentet më të rëndësishme si përgjigje në pyetjen: Pse na duhet KOMRA.

Konsultimet që nga fillimi kishin për synim të krijojnë platformën për punën e KOMRA-s në të ardhmen, ku viktimat do të flasin për ato që kanë përjetuar dhe për këtë po vazhdojmë të punojmë në konsultimet që po i mbajmë. Gjithashtu, në gjithë këtë nismë kemi mbledhur edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, të cilët japin mendimet e tyre në raport me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe gjithë padrejtësitë e kryera në të kaluarën.

Qëllimi i këtyre konsultimeve është që ne të fitojmë përkrahjen për të cilën foli Lazari. Deri më tani është zhvilluar fushata, ajo tani ka përfunduar, është fjala për një fushatë mediale që e ka anashkaluar Maqedoninë, por unë shpresoj se në një nga fazat e ardhshme ajo do të jetë këtu dhe pikërisht komunikimi me publikun më të gjerë është qëllimi ynë, jo vetëm me organizatat dhe shoqatat e viktimat dhe organizatat e shoqërisë civile, por në realitet me të gjithë, sepse mendojmë se kjo është me rëndësi për çdo anëtar dhe anëtare, për secilin individ dhe individë në vendet tona. Ajo që ne po bëjmë dhe që është më e rëndësishme në këtë moment në punën e Koalicionit është hartimi i modelit të komisionit të ardhshëm rajonal. Aktualisht ne kemi një ekip të njerëzve, i quajmë Grupi punues dhe secili nga shtetet që merr pjesë në këtë proces i ka përfaqësuesit e vet, me përjashtim të Maqedonisë dhe Sllovenisë, por shpresojmë se kjo do të ndryshohet dhe do të jetë diskutohet veç tjerash edhe në këto konsultime dhe ata për momentin janë duke punuar në hartimin e modelit për të cilin më tepër do t'ju informojë kolegja nga Bosnja dhe Hercegovina.

Ecuria e deritanishme e procesit të konsultimeve ka treguar se shumica dërmuese e pjesëmarrësve e përkrahin qasjen rajonale dhe në njëfarë mënyre po hetojmë se jo vetëm që kemi shënuar përparim gjatë këtyre konsultimeve, por kemi arritur edhe ta ndryshojmë ambientin aktual që nesër do të jetë shumë i rëndësishëm për pranimin e kësaj iniciative në parlamentet e shteteve të rajonit.

Siç e përmendi edhe Lazari, në muajin shkurt të këtij viti në Dubrovnik u takuan robërit e luftës – pjesëtarë të ushtrive që kanë luftuar në hapësirat e ish Jugosllavisë Ata erdhën të gjithë së bashku në Dubrovnik dhe takimi ishte shumë korrekt. Disa robër nga Trebinja, që janë mbajtur në qendrën ushtarake-hetuese në Lora të Splitit, vinin në Kroaci për herë të parë. Kjo me të vërtetë ishte fascionuese dhe sidomos ishte e rëndësishme për ato pjesë të Malit të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Dubrovnikut të përfshira në luftë, ku është luajtur me fatin e njerëzve. Viktimat e para nga Srebrenica janë vlarë në vitin 1992 gjatë deportimit nga Herceg Novi. Po bëjmë luftë për paqe, kështu e kanë quajtur malazezët, respektivisht strukturat e shtetit atë që po ndodhte në Dubrovnik...tash i kemi robërit nga Lora, që janë torturuar atje, që shëtisin në qendër të Splitit.

Tash kur përmenda Lorën, sikurse edhe pas gjithë atyre gjërave që thash dhe gjithë atyre shembujve që u dhanë, është e rëndësishme të kuptohet se KOMRA nuk do të nxjerrë në skenë dhe në dritë kurrfarë fakte të reja spektakulare që nuk kanë qenë të ditura deri më tani. Pra bëhet fjalë pikërisht për atë, dhe është një prej arsyeve kryesore pse është iniciuar kjo nismë, dhe kjo për faktin që KOMRA, respektivisht ky mekanizëm ka për qëllim të ngreh një perde kundërvënje apo mohimimi në bazë të fakteve të njohura gjerësisht por të pathëna apo të pavërteta. Shumë gjëra dihen, kjo më kujtoi ngjarjen që lidhet me Splitin, ku qytetarët me vite e dinë se këtu është bërë ajo që është bërë, pra janë kryer krime shumë mizore, por heshtja është ajo më e keqja, prandaj ky mekanizëm ka për qëllim, që përpos tjerash, të flasë edhe për këtë storie.

Mendoj se kjo që thash është e mjaftueshme. Shpresoj se fjalimi im kishte ndikim dhe do të nxisë reagimet tuaja në lidhje me atë se pse një iniciativë e tillë është e rëndësishme edhe për Maqedoninë, çka ka ndodhur në vitin 2001...të jem i sigurtë, duke parë këtë debatin në Shkup në shkurt të këtij viti për demitizimin e vitit 2001 vura re se pikërisht kjo iniciativë dhe KOMRA mund të jenë model i mirë për diskutim mbi të kaluarën, sepse debati në momente të caktuara ishte shumë i tensionuar dhe gjatë gjithë kohës kishte dy anë: ajo maqedonase dhe shqiptare dhe e konsideronin palën tjetër fajtorë. Arsyeja pse i përmendëm disa shembuj, siç ishte ai i Dubrovnikut dhe të tjera, ishte që të tregojmë se diskutimet dhe debatet e këtyra, përpos interesit tonë përfundimtar dhe përmbushjes së qëllimit për themelimin e komisionit, mund të ndihmojnë edhe zgjidhjen e kontesteve dhe problemeve që ekzistojnë, përmes të vërtetave të pathëna. Ishte fascionuese të dëgjosh qytetarët e Maqedonisë të kombësisë shqiptare se kanë qenë plotësisht të injoruar gjatë kohës së komunizmit dhe kështu me radhë. Nga ana tjetër, këtu është zonja që humbi burrin në këtë konflikt, prandaj ajo vërejtja ime se në Maqedoni bëhet fjalë për një konflikt të vogël në këtë rast nuk është i saktë, për atë

ky ishte konflikti më i madhe në botë, më i madh se çfarëdo konflikti tjetër. Prandaj në këtë kontekst unë fillove të përgjigjem në pyetjen: A ka nevojë Maqedonia për KOMRA-n dhe pse?

JASMINA NAJDOVSKA: Falënderoj mysafirët për fjalimet tyre, mendoj se ajo që thanë do të jetë bazë e mirë për përgjigjen në pyetjen tuaj. Ju lus për diskutime. Urdhëroni zotëri Grkov! Ju lutem që të...të..prezantoheni!

NIKOLA GRKOV: Unë jam Nikola Grkov, kryetar i Shoqatës së veteranëve të ushtrisë nga Kavadarci...

JASMINA NAJDOVSKA: A ka mundësi pak më fortë?

NIKOLA GRKOV: përndryshe pjesëmarrës aktiv në luftën e vitit 2001, e cila për fat të keq shpeshherë u përmend si konflikt i armatosur dhe diçka e afërt me luftën por jo luftë.

Së pari përshëndes iniciativën për këtë takim, pas kësaj, pas fjalimeve të zotërinjve Marko Veliçkoviç, Lazar Stojanoviç dhe në fund zotëri Eugenit, do t'i paraqes disa nga këndvështrimet e mia, të cilat praktikisht ka kohë që jam përpjekur t'i shpreh, prej përfundimit të vitit 2001, që t'ua imponojmë qeverive të tanishme dhe të kaluara si probleme ekzistuese.

Duke u nisur nga e dhëna se Republika e Kroacisë respektivisht mbrojtësit e Republikës së Kroacisë gjatë luftës atdhetare kanë formuar një asociacion të gjerë dhe në njëfarë mënyre ia dolën t'i zgjidhin problemet e tyre përkundër fakti se edhe atje mbrojtësit e atdheut janë akoma të pakënaqur...Neve na është imponuar një problem tjetër, e para mospranimi i pjesëmarrësve të luftës si luftëtarë për të vetmen arsye sepse nuk ishte shpallur luftë!!! Por të jeni më shumë se të sigurt se ishte luftë dhe mund ta përkrahë deklarin e zotit Eugen se ajo ishte lufta më e keqe në rajon.

Zotëri Veliçkoviç diskutoi për viktimat, të zhdukurit, pothuajse pjesën më të madhe të kohës ia kushtoi të zhdukurve dhe familjeve të tyre, shtroi pyetjen se a do të gjenden të zhdukurit, a do të përgjigjet apo jo fajtori nëse gjendet. Megjithatë, ekziston këtu një problem tjetër që rastësisht apo qëllimisht nuk është përmendur, e këto janë viktimat e gjalla. Personalisht flas për të gjithë pjesëmarrësit në luftë, në të gjitha luftërat në rajon, duke filluar nga luftërat e zhvilluara në Kroaci, Kosovë, Serbi dhe lufta te ne. Viktima janë të gjithë ata që marrin pjesë aktivisht në luftë, por edhe familjet tona janë viktima, një kategori e viktimave të padukshme sepse të gjithë janë të traumatizuar. Është e kuptueshme se familjarët e secilit pjesëmarrës në luftë janë të traumatizuar. Lufta do të bëjë të vetën.

Megjithatë, familjet e luftëtarit tonë i kanë përjetuar traumat edhe gjatë kohës së luftës, e vazhdojnë t'i përjetojnë edhe sot e kësaj dite. Personalisht kam shkruar për stresin post-traumatik apo siç njihet sindromën e Vietnamit, që në vitin 2006, kur për fat të keq autoritetet e asaj kohe më tërhoqën vërejtjen që të kem kujdes se çka shkruaj. A ndalove së foluri për këtë temë apo jo? Do t'ua them thjeshtë, edhe sot e kësaj dite, siç tha dikush – ajo mbetet tema ime e preferuar- megjithatë është edhe një pikë e dhembshme për të cilën duhet të përpiqemi sepse vet sindroma dhe fleshbekët (kujtimet)... sjellin shumë, shumë viktima. Nuk do të doja të manipulojë me shifra por besoj se më shumë se 200 pjesëmarrës deri më sot ia kanë marrë vetes jetën për shkak të atyre fleshbek-ëve apo për shkak të sindromës së Vietnamit...për fat të keq, përkund faktit se ne kemi ekspertë që ta trajtojnë këtë problematikë ata nuk po e bëjnë këtë...në bazë të asaj që kam lexuar nga literatura, por edhe me sa kam parë në praktikë kjo manifestohet në atë mënyrë që pjesëmarrësi në luftë ose ia merr jetën vetes apo së pari silltet në mënyrë agresive ndaj dikujt, e privon atë nga jeta e pastaj ia merr vetes jetën.

Dhe e gjithë kjo po ndodh këtu te ne, në Maqedoni...kjo ka zgjatur deri para disa muajsh deri sa nuk ndodhi një ngjarje në Kumanovë...Fatmirësisht apo fatkeqësisht, një pjesëtar i Ministrisë së Punëve të Brendshme vrau së pari vëllanë e tij, përndryshe pjesëmarrës në luftë, kurse më pas i mori jetën edhe vetes. E pas kësaj, zonja dhe zotërinj, politikanët tanë në Maqedoni zbuluan „ujin e nxehtë“. Zbuluan se kjo ishte pasojë e sindromës vietnameze, respektivisht pasojë e stresit post-traumatik.

Është mirë që kjo iniciativë është planifikuar të zhvillohet në bazë të komisionit që do të propozohet dhe do të zgjidhet. Unë insistoј që të krijohet edhe komisioni që do t'i caktojë shifrat, shifrat e sakta të njerëzve të traumatizuar, shifrat e sakta të të vrarëve respektivisht atyre që kanë kryer vetëvrasje si pasojë e traumatizimit dhe atyre që janë vrarë nga personat e traumatizuar në rajonin tonë.

Unë do të doja dhe besoj se kjo do të zbatohet, për faktin se në raport, mos të na i marrin për të madhe të tjerët, na relacionin Maqedoni-Kroaci ekzistojnë dy profesorë të shquar që i kanë hulumtuar shumë mirë çrregullimet e stresit post-traumatik dhe kanë hedhur dritë mbi këtë problematikë, se sa mund të flitet për dritë këtu është shumë diskutabile, krejt është e zezë...të përmend edhe faktin se ekziston një studim i mirë, një libër i mirë i shkruar pas hulumtimeve 25 apo 30 vjeçare të profesorit nga Maqedonia, tashmë të pensionuar, i angazhuar në Qendrën për diagnostikë, profesor doktor Georgi Çavlovski sikurse edhe në Zagreb, profesor Hutujac, të cilët e kanë përgatitur dhe dëshmuar këtë së bashku. Për fat të keq, përkundër gjithë këtij dokumentacioni, përkundër gjithë këtyre fakteve, autoritetet të paktën këtu te ne, por besoj se edhe gjithkund në rajon, mbesin të shurdhët. Nuk kam tjetër çka të shtoj, vetëm do të bëja një apel që me të vërtetë të formohet ky komision dhe t'u bëhet apel edhe qeverive në të gjitha shtetet e rajonit që t'i shikojnë me respekt pjesëmarrësit në luftë, respektivisht luftëtarët në Maqedoni, mbrojtësit në Kroaci, luftëtarët në Serbi, Kosovë dhe kështu me radhë. Ju faleminderit!

JASMINA NAJDOVSKA: Ju faleminderit edhe juve. Zonja Frustrina, nëse mundet.

FRUSRINA REMENSKI: Ju faleminderit! Ja pra, unë u ngrita që të shihemi të gjithë! Pra, unë jam docente e Fakultetit për siguri, interes shkencor, konflikte, parandalim, spravuvanje. Në mënyrë të pashmangshme po vijmë deri te tema dhe problematika që e diskutuam atë gjatë, megjithatë mendoj se nuk arritëm të gjejmë zgjidhje dhe përgjigje për atë se cila është baza e asaj që kërkon Koalicioni KOMRA, kurse kjo është pyetja se a ka nevojë Republika e Maqedonisë për KOMRA-n.

Dhe unë prisja që ju do të ofroni diçka më shumë prej konkluzioneve që i keni arritur për demitologjizimin në vitin 2001 dhe mendoj se i keni ato, megjithatë i kërkon sërish si të tilla sepse mendoj se demitologjizimi i vitit 2001 është diçka që do të pasonte në fazën në të cilën ne në shkencë, pa qenë të thirrur ose nga paanshmëria shkencore, objektiviteti, do të bëjmë përkufizime pa pasur presion, të cilin e kishim gjatë vitit 200. Në kuptimin e përkufizimit ligjor, i cili do të mundësojë më tej edhe interpretimin e të gjitha veprimeve të mëtejshme si të Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë në Hagë, por edhe të institucioneve dhe qeverive kombëtare në vendin në të cilin presim çfarëdo lloj trajtimi të pjesëmarrësve por edhe të viktimave të konfliktit. Dhe mendoj se të gjitha diskutimet, të cilat organizohen si forume, në të cilat ftohen shoqata, punëtorë shkencorë, gazetarë, analistë, njerëz me praktikë të pasur, njerëz pjesëmarrës në ngjarje për tematikën e të cilave organizohen forumet, marrim miliona rrëfime, të cilat shumë shpesh ... çojnë në një rruga qorre dhe nuk mund të vendosim se çfarë duhet bërë më tej.

Ajo për të cilën dua të flas sot, mendoj se do të japë njëfarë përgjigje edhe për diskutimin e mëparshëm, por megjithatë edhe për atë që ju e prisnit si përgjigje është se si e shohim në vitin 2001. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit, në 13 gusht të vitit 2001, si marrëveshje paqësore pas konfliktit ne e përkufizojmë ligjërisht kornizën përmes së cilës ne do të afrohem ato dispozita u bënë pjesë e kushtetutës dhe shumë shpesh flasim për një marrëveshje që duket të jetë jashtë kushtetutës por meqë është zbatuar si dispozita të kushtetutës, se shumë shpesh flasim për të treguar se ky është respektim i dispozitave të kushtetutës ose mosrespektim, ose mosrespektim i tyre.

Në shkencë shumë shpesh ndeshemi me përkufizimin e konfliktit në mënyrë që të dimë të themi nëse lufta, ai përkufizimi klasik i luftës është ai që e kemi si gjendje e cila duhet të shpallet gjatë kohës së konfliktit me një intensitet të caktuar dhe dinamikë të shtuar, në një përkufizim të tillë për luftën e vitit 2001, mund ta japim shumë rrallë sepse shumë shpesh e përkufizojmë si konflikt i armatosur i brendshëm, luftë qytetare, por pas akuzave që i ngritit Gjykata ndërkombëtare në Hagë dhe pas

padive që po i procedon gjyqësori ynë, të cilat u kthyen si raste nga Haga arrijmë në përfundimin se dikush nga jashtë ka përkufizuar diçka që ne e kemi pasur por nuk kemi guxim të themi se çfarë na ka ndodhur. Edhe këtu kemi kontestime, a kemi krime lufte, kur kanë ndodhur ngjarje të tilla, a vlen e drejta e luftës vetëm në rastin e gjendjes së luftës të shpallur zyrtarisht apo sërish rregullat e luftimit vlejné në cilindo konflikt dhe mbyllemi në kornizat etnike pa parë paraprakisht të shohim pak anash dhe t'i dëgjojmë edhe të tjerët. Maqedonasit e kanë të vërtetën e tyre, shqiptarët e kanë të vërtetën e tyre, të ngarkuar me paragjykime dhe stereotipe, shumë rrallë flasin për këtë temë. Të gjitha diskutimet e llojit se çfarë ndodhi në vitin 200, si të tejkalohen pasojat dhe si të jetë trajtimi i viktimave i lëmë në dorë të vullnetit politik respektivisht në dorë të qeverisë dhe partnerët e koalicionit të merren vesh se si do të vendosin për ligjin për “mbrojtësit” (“brانيتellat”) dhe a do të ketë ligj për pjesëtarët pjesëmarrësit në UÇK. dhe këtu mbaron muhabeti.

Do të thotë se ne në Maqedoni flasim për viktimë, megjithatë flasim për viktimë pjesëmarrëse në konfliktin e vitit 2001. Shumë pak flasim për viktimat e tipit të popullatës ose familjeve për të cilat mendoj se e keni fjalën edhe ju.

Dhe çfarë ndodh? Do të thotë viktimë, Zoti. Grkov përmendi se në Republikën e Maqedonisë është e nevojshme të bëhen hulumtime për stresin post-traumatik ose sindromën e Vietnamit, të dukshëm veçanërisht në shoqëritë pas konflikteve, që ndikon në pjesëmarrësit në konflikt.

Unë mund të them dhe kjo është ndoshta edhe një argument më shumë për atë që të filloj nga fillimi të diskutojmë për një punë të caktuar, se Fakulteti për siguri tashmë që nga viti i kaluar punon në një projekt afatgjatë kërkimoro-shkencor dhe aplikativ, i cili se do t'i zgjidh, mendoj do të japë përgjigje për shumë çështje të cilat janë hapur sot.

Do të thotë se në mendimin ligjor të projektit kërkimoro-shkencor, i cili do të jetë edhe baza për të vërtetuar nevojën e kujdesit për viktimat nga ana e shtetit por edhe për prezantimin publik të fakteve është se në vitin 2001 zbatuam një fazë të projektit dhe kjo është me shembuj përfaqësues nga pjesëmarrësit direkt të forcave të sigurisë të Republikës së Maqedonisë në konfliktin e armatosur të vitit 2001, kryem një punë kërkimoro-shkencore e titulluar si gjendja psikologjike dhe sociale e pjesëtarëve të forcave të sigurisë të Republikës së Maqedonisë, pjesëmarrës direkt në konfliktin e vitit 2001. nuk hyjmë në vlerësimet për atë se çfarë do të humbet nga të dhënat, do të harroj ... mendimin, si profesor, apo jo.

Megjithatë, dua të them se një nga fazat e ardhshme për të cilën po punojmë është hulumtimi që do ta bëjmë edhe me shoqatat e veteranëve të UÇK-së, t'i dëgjojmë edhe këndvështrimet e tyre, ta konstatojmë nivelin e tyre të gjendjes psikologjike dhe sociale që është valide për trajtimin e gjendjes së tyre juridike, sociale dhe psikologjike. Faza e tretë, e cila mund të vijë pak më vonë, por mund të jetë faza më e gjatë meqenëse planifikojmë të bëjmë hulumtime në terren, në rajonet e prekura nga konfliktet e armatosura, ku si grup të caktuar kemi popullsinë e këtyre vendbanimet, meqenëse jemi të mendimit se ato mund të jenë viktimë jo të drejtpërdrejta por indirekte gjatë periudhave të caktuara. Në momentin kur do ta përgatisim një studim kompleks, i cili do t'i përfshijë të gjitha këto nevoja dhe pikëpamje për ngjarjet në fjalë, të cilat duhet t'i kemi parasysh gjatë shqyrtimit të nevojës për Koalicionin KOMRA në Republikën e Maqedonisë, mendoj se do të kemi një kornizë të përgjithshme që do të na mundësojë të japim përgjigje në disa nga pyetjet që u shtruan këtu.

Për Republikën e Maqedonisë është karakteristike se jo të gjitha viktimat janë definuar në mënyrën që ju e mendoni, siç është rasti me popullsinë që i është ekspozuar konfliktit... Viktimat prezantohen përmes shoqatave dhe të gjitha kërkojnë trajtim nga shteti, prandaj nuk është e rastësishme që secila iniciativë përfundon me një marrëveshje politike sepse pritet që shteti t'i kompensojë apo t'i plotësojë nevojat e viktimave, kurse këto më së shpeshti janë dy palët e përmendura në konflikt, të cilat kanë këndvështrime të kundërta për të gjitha ngjarjet por edhe për nevojat e tyre.

Nuk vihet në dyshim nevoja që në Republikën e Maqedonisë të ketë një iniciativë të këtillë. Edhe pse numri i viktimave të krimeve të luftës nuk është në përmasat e viktimave dhe ngjarjeve që ju i përmendët se kanë ndodhur në hapësirat tjera të ish Jugosllavisë, mendoj se na duhet një iniciativë që do të gjejë përgjigje edhe për çështjet më të nxehta në Maqedoni dhe do të ndihmojë në tejkalimin e paragjytimeve dhe barrierave etnike dhe që do të paraqes hapje të komuniteteve ndaj njëri-tjetrit. Faleminderit!

JASMINA NAJDOVSKA: Faleminderit, Frusina. Është paraqitur për diskutim Boro Kitanovski nga Aksioni për paqe - Prilep.

EUGEN JAKOVÇIQ: A ka mundësi diçka shumë shkurt?

JASMINA NAJDOVSKA: Mundet, mundet!

EUGEN JAKOVÇIQ: Boro, kërkoj falje, vetëm një fjali. Fjalimi juaj në këtë Forum më kujtoi kohën kur kemi diskutuar se në çfarë konteksti t'iu qasemi Maqedonisë dhe Sllovenisë dhe kur flasim në përgjithësi për qasjen rajonale ajo nuk determinohet nga ngjarjet në Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci dhe Serbi. Në të vërtetë, çdo shtet e ka tregimin e vet brenda kësaj iniciative.

Sigurisht që kur flasim për pajtim në Kroaci nuk e kemi fjalën për pajtimin mes kroatëve dhe shqiptarëve, por mes kroatëve dhe serbëve. Në Kosovë është një storie tjetër, sikurse edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Prandaj, kur kolegët tanë nga Sllovenia, nga Instituti për paqe, folën për kontekstin e KOMRA-s në Slloveni, përmendën një grup të madh të të ashtuquajturve „njerëz të fshirë“ të cilët nuk e kanë marrë shtetësinë e Sllovenisë dhe në këtë mënyrë, e kjo ishte si pasojë e gjithë këtyre ngjarjeve që ndodhën në territorin e ish Jugosllavisë, pasojë e gjithë këtyre luftërave dhe konflikteve rajonale. Kjo përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut që ka pasur pasoja të rënda për ata njerëz...pra ka pas mes tyre njerëz që janë sëmure, kanë vdekur dhe kështu me radhë. Dua të them se çdo shtet brenda kësaj iniciative, brenda KOMRA-s, ka një tregim të vetin dhe kjo është shumë e rëndësishme dhe për këtë arsye KOMRA i ka zyrat e veta në të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë dhe përmes qasjes rajonale përpiqet t'iu përgjigjet përpos tjerash edhe nevojave të secilës shoqëri.

Ne jemi të mendimit se janë bërë padrejtësi të mëdha, janë kryer krime dhe këto duhet bërë të ditura në të gjitha vendet, por secili shtet ka storien e vet dhe, unë do të thosha në mënyrë të vrazhdë, përpiqet që ta shfrytëzojë KOMRA-n dhe këtë iniciativë që vetes dhe shoqërisë së vet t'ia lehtësojë ardhmërinë dhe që drejtësia për të cilën flasim të realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Boro, urdhëroni!

BORO KITANOSKI: Unë e shoh këtë proces me optimizëm të madh. Disa herë më ka rënë të takohem me KOMRA-n dhe për mua është e rëndësishme.

Tash, më lejoni t'iu përmbledh vetëm disa çështje, sepse për mua si qytetar i Maqedonisë, si maqedonas që kam mbetur të jetoj në Prilep dhe që kam vendosur të qëndroj këtu është shumë me rëndësi të punoj në të mirë të paqes, por në të njëjtën kohë edhe në zhvillimin e demokracisë dhe shoqërinë civile.

Çështja e parë që për mua është shumë me rëndësi, është qasja rajonale që ofrohet këtu, nuk është se ne në Maqedoni nuk kemi forca që të ballafaqohemi me atë që na ka ndodhur, por disi kjo po shkon, po shkon shumë ngadalë, ndodh shpeshherë...kemi disa çështje të pazgjidhura, po diskutojmë vetëm për tre-katër raste që janë kthyer nga Gjykata e Hagës dhe kohë pas kohe partitë ndryshme politike po lansojnë në publik pastaj tërhiqen...dhe shumë tragjedi mbesin diku në margjina. Gjithë ky proces në tërësi kontrollohet nga disa faktorë kyç, faktorë politik, të cilët dominojnë skenën politike...deri sa nuk merren vesh...kjo zgjat, e pastaj ato bëhen ad-akta, në fund del se viktimat janë shfrytëzuar edhe një herë për qëllimet elektorale të dikujt, për interesat e dikujt, e pastaj janë lënë anash. Këtu vijmë te elementi i dytë. Qasja rajonale mund të na ndihmojë shumë, nëse kemi një iniciativë të këtillë e që merret me konfliktet e tipit të luftës së Bosnjës, Kroacisë, Kosovës, luftëra të këtyre përmasave, ajo

mund të zgjidhë një pjesë të madhe të rasteve të cilat po mundohen ti fshehin publikisht, prandaj në këtë drejtim mund të ndihmojë shumë.

Një çështje tjetër që e konsideroj shumë të rëndësishme është se procesi orientohet kah viktimat, para së gjithash u dedikohet viktimave, primatin e kanë viktimat, ata duhet të dëgjohen. T'i dëgjojmë viktimat tona, nga ana jonë (thënë kushtimisht), por t'i dëgjojmë edhe viktimat në anën tjetër. Duhet dëgjuar nënat tona dhe duhet dëgjuar nënat e të tjerëve. Nëse e dëgjoj tregimin e viktimës së palës tjetër, kjo nuk do të thotë se mua më dhemb më pak ajo që ka përjetuar ai. Po ne mund ta dëgjojmë njëri-tjetrin. Kjo është ajo që vlen në këtë proces.

Çështja e tretë është mandati. Mendoj se mandati do të jetë problem, por shoh se shumë njerëz nuk janë të shqetësuar për këtë. Mendoj se në Maqedoni kanë ndodhur shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe është legjitime që Maqedonia të hyjë në mandat të KOMRA-s. Ne nuk duhet të kemi, mund të jemi pjesëmarrës në këtë hap duke qenë të përcjellur apo asistuar nga Bosnja, Kroacia dhe në Kosova, megjithatë ne duhet të koncentrohemi në pyetjen se çka do të thotë shkelje në masën e të drejtave të njeriut në kontekstin maqedonas. Cka do të thotë kjo për ne? Eugeni e përmendi për Slloveninë, e cila ne Novi-Sad ishte sugjeruar të jetë në kuadër të Mandatit të KOMRA-s.

Shpeshherë dëgjojmë të shtrohet pyetja, dhe të them të drejtën kjo edhe më nervozon, kur njerëzit thonë nuk e dimë se çka ndodhi në vitin 2001, prandaj le ta konstatojmë atë që ka ndodhur. Super! Hajt ta konstatojmë! Por, kjo nuk mund të bëhet në atë mënyrë që një komision do të na thotë: Ja, kjo ju ka ndodhur. Hajt të fillojmë me dëshmitë individuale të asaj që ka ndodhur, le të dëshmojnë të gjithë atë që u ka ndodhur... kur, në çfarë rrethanash, kur, dhe të fillojmë me grumbullimin e këtyre dëshmimeve, dëgjimin e këtyre dëshmimeve, t'i dëgjojmë në mënyrë që në të ardhmen dikush me ambicie shkencore apo çfarëdo ambicie të mund të nxjerrë ndonjë konkludim dhe t'i përmbledhë ato. Kjo ishte. Faleminderit!

JASMINA NAJDOVSKA: Faleminderit, Boro! Zotëria në

TOMAS KOHLS: Unë jam Tomasi, gjithashtu nga Aksioni për paqe nga Prilepi. Tash dëgjuam shumë arsytetime pse është i rëndësishëm komisioni rajonal dhe unë pajtohem se ka shumë arsye që të kemi një komision që do të punojë në gjithë territorin e ish RSFJ-së.

Nga ana tjetër, kam frikë se ky komision do të marrë përgjegjësitë të cilat do të duhej t'i takonin shtetit, respektivisht komisionit shtetëror. Si do të mund ta formonim KOMRA-n, për të cilën kemi nevojë, pa qeveritë e rajonit, të cilat në atë mënyrë tërhiqen nga përgjegjësia e tyre.

JASMINA NAJDOVSKA: Ju faleminderit!...

MARKO VELIÇKOVIQ: Ne gjithë kohën flasim se kemi për qëllim të formojmë një komision që do të ketë katër karakteristika, njëra nga të cilat është që koalicioni të jetë zyrtarë. Ne kemi nevojë për këtë iniciativë në mënyrë që të arrihet një përkrahje e gjerë, për t'i identifikuar nevojat e shoqërisë dhe që opinioni i gjerë dhe qeveritë ta pranojnë iniciativën dhe ta themelojnë përmes akteve ligjore. Por ne nuk e kemi përmendur nëse aktin e themelimit të Komisionit do ta bëjnë qeveritë, parlamentet, kryetarët e shteteve të rajonit, të cilët pastaj do ta obligonin komisionin për atë se cili duhet të jetë rezultati i punës së tyre. Është fjala për rekomandimet që do t'i japë komisioni. Pra, në fund të punës së vet, komisioni rajonal do ta përgatis raportin përfundimtar i cili do t'i përmbajë të gjitha faktet e vërtetuara sikurse edhe rekomandimet që do t'iu dërgohen qeverive, me fjalë tjera themeluesve të tij, së bashku me hapat të cilat duhet ndërmarrë në kuptim të zhdëmtimit, ngritjes së përkujtimeve dhe ky raport do të bëhet burimi më i besueshëm i informatave edhe për sistemet arsimore, mund të bëjë rekomandime për përfshirjen e konkluzioneve të komisionit në tekstet shkollore, që nënkupton miratimin e politikave të reja arsimore, në mënyrë që gjeneratat e reja të informohen objektivisht për atë që ka ndodhur gjatë luftërave. Por, natyrisht se qeveritë do të kenë për obligim t'i dëgjojnë dhe të veprojnë në bazë të këtyre rekomandimeve dhe ato duhet të qëndrojnë parapa kësaj pune nga fillimi. Me fjalë tjera, komisioni i pavarur, nëse ky komision do të

ishite i pavarur, nuk do të kishte, apo thënë më mirë, nuk do të mund të kërkonte përgjegjësi dhe t'i detyronte autoritetet që t'i zbatojnë këto rekomandime.

JASMINA NAJDOVSKA: Ju faleminderit! Fjalën e kërkon Stojanovski!

ACO STOJANOVSKI: Faleminderit! Si përfaqësues i Shoqatës së mbrojtësve të Maqedonisë sot të diskutoj shkurt meqenëse diskutantët e mëhershëm thanë pothuajse gjysmën e fjalimit që kisha përgatitur unë me këtë rast, prandaj nuk do të doja që t'i përsëris.

Pra ne jemi prezent në këtë iniciativë që nga viti 2006 në Mal të Zi, si përfaqësues të viktimave të konflikteve të armatosura në ish Jugosllavi, duke përfaqësuar një Union të mbrojtësve dhe anëtarëve të familjeve të viktimave si dhe një pjesë të personave të zhvendosur nga Shoqata „Zora“, kurse ishim gjithashtu prezent edhe në vitin 2008, në Prishtinë, kur edhe u bëmë nënshkrues të organizatës rajonale. Megjithatë unë do të shtoja diçka, meqenëse në njëfarë mënyre edhe isha i thirrur që të reagoj si pjesëmarrës...do të shtoja edhe për zhvillimet ku rreth 4.000 anëtarë të shoqatës së Unionit të mbrojtësve kalojnë në një shoqatë të fuqishme, kurse kryetari i tyre, për fat të keq, nuk po e shoh të jetë prezent këtu, por me siguri se do t'i përcillet gjithë ajo që ka ndodhur.

Ne si organizatë qytetare e mbrojtësve deri më tani jemi marrë vetëm me vetveten. Edhe nëntë vjet pas lufte, nëntë vjet që po ekzistojmë si shoqatë, nëntë vjet pas konfliktit ne nuk i kemi tejkaluar problemet që kanë të bëjnë me statusin tonë, në njërin anë statusin e mbrojtësve dhe pjesëmarrësve në konflikt dhe nga ana tjetër të plagosurve dhe familjeve të të vrarëve. Kemi raste kur në të njëjtin aksion, në të njëjtën ditë, në të njëjtën orë, në të njëjtën minutë janë vrarë dy apo tre mbrojtës, një nga ata është kompensuar përmes gjykatës, me marrëveshje në vitin 2002, kurse dy të tjerët po ndjekin procedurën gjyqësore nga nëntë vjet...e kam fjalën për anëtarët tjerë të familjes së viktimës. Gjithashtu, e kemi rastin e të plagosurve në të njëjtën aksion, ku njëri është kompensuar, kurse tjetri po lufton nga nëntë vjet me institucionet e sistemit që t'i realizojë ato të drejta që kolegu i tij i ka fituar në përputhje me ligjin.

Nuk po përmend nevojën për rehabilitim psikologjik, për fat të keq numri i tyre është i madh dhe të gjithë i dërgojmë për rehabilitim... vetëvrasjet e pjesëmarrësve tanë në konflikt janë rritur...deri në vitin 2007 ne kemi realizuar një formë të rehabilitimit psikologjik të luftëtarëve përmes Fondacionit SOROS, respektivisht Institutit për shoqëri të hapur dhe Qendrës kulturore maqedonase për bashkëpunim, e cila falë donacioneve nga Ambasada e Holandës implementon programin e rehabilitimit psikologjik për ish pjesëmarrësit në konflikt, përmes kurseve të caktuara, trajnime për punë dhe kështu me radhë. Megjithatë, problem ishte fakti se dy palët duhej t'i vijonin trajnimet respektivisht programin rehabilitues ndaras, sepse nuk u gjet gjuhë e përbashkët për këtë çështje në mes dy palëve.

Kohëve të fundit po ndërhyjnë edhe politika. Ne kemi mbajtur 46 tribuna publike nëpër gjithë Maqedoninë me qëllim që t'i bashkojmë mbrojtësit në një Union të vetëm. Në të gjitha këto tribuna ekzistonte konstatimi dhe bindja e përgjithshme se nëse nuk merremi me politikë, politika do të merret me ne. Për fat të keq kjo u tregua e vërtetë. Sot autoritetet ushtrojnë një presion të madh ndaj nesh si organizatë qytetare e mbrojtësve që të na përçajjnë, kurse arsyeja është se institucionet e sistemit e pengojnë sistemin institucional për dëshmëpërblimin e mbrojtësve...ekziston mundësia që, përmes një programi siç është KOMRA, mbrojtësit të arrijnë atë shkallë të përsosshmërisë që të mund të thonë se kanë marrë pjesë në këtë apo atë aksion dhe kanë kryer këtë apo atë vepër apo se kolegu im apo eprori im ka kryer këtë akt, krim, vrasje apo se aty apo këtu janë të zhdukurit.

Ne besojmë se për ngjarjet e vitit 2001 duhet të diskutohet së bashku me pjesëmarrësit nga pala tjetër dhe pikërisht për çështjen e kompensimit për të gjithë pjesëmarrësit në konfliktin e vitit 2001, kuptohet në përputhje me ligjin.

E dyta, ne si mbrojtës kërkojmë ndihmën e palës tjetër në ndriçimin e vrasjeve mizore të kryera në Veice, Karpalak, do të thotë të dihet kush janë këta persona, ku janë ata sot dhe çka i ka shtyrë që

pasi i kanë vrarë t'i gjymtojnë dhe masakrojnë mbrojtësit në atë mënyrë. Gjithashtu, mendojmë se pala tjetër do të na ndihmojë shumë që t'i identifikojmë se cilët janë ata politikanë që edhe sot e kësaj dite janë në pushtet apo janë ende aktiv në skenën politike, e të cilët kanë i kanë hedhur benzinë konfliktit të vitit 2001, respektivisht ishin tradhtarë apo kanë bërë montime ose e kanë furnizuar palën tjetër me armë dhe informata.

Gjithashtu jemi shumë të indinjuar me faktorin ndërkombëtar që edhe sot e kësaj dite ushtron presion, në vend se të ndihmojë në zbutjen e marrëdhënieve të tensionuara ndëretnike mes maqedonasve dhe shqiptarëve, ata thonë: është i mundshëm një konflikt i ri, është e mundshme kjo apo ajo. Në vend se të punojnë në drejtim të zbutjes së pasojave të konfliktit, ato po bëjnë luftë speciale

Përndryshe, faktorët që ndikuan në shpërthimin e luftës së vitit 2001 edhe sot e kësaj dite janë në pushtet, njëra erdhi në pushtet si krahu politik i UÇK-së, do të thotë në kuadër të BDI-së dhe ende janë në pushtet, kurse në anën e maqedonasve Buçkovski, Boshko, Ljubo Boshkovski dhe kështu me radhë.

Ne besojmë në mundësinë e pajtimit mes maqedonasve dhe shqiptarëve dhe mendoj se me një aktivitet si ky mund të tejkalohen ndarjet dhe të nxirren konkluzione për atë se çka ndodhi në vitin 2001 në mënyrë që nga ajo të mësojnë gjeneratat e ardhshme.

Përndryshe edhe rastet e Hagës, siç tha edhe kolegja, ato i shfrytëzon politika për qëllimet e veta. Që t'i përfundojmë këto raste duhet të dënohen të gjithë ata që nuk i kap amnistia, kurse të tjerët të amnistohen dhe të vazhdojmë më tej. Por mendoj se kjo nuk do t'ju konvenojë faktorëve të caktuar për arsye se ata vetë janë të përfshirë thellësisht në këto ngjarje. Faleminderit!

JASMINA NAJDOVSKA: Ju faleminderit zotëri Stojanovski! Besim Hoda, nëse mundet...!

BESIM HODA: Përshëndetje! Edhe një herë, Besim Hoda. Përfaqësoj këtu Lëvizjen qytetare Ec. Njëherit jam përfaqësues i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

Do të flas në dy nivele. Vetëm duke tentuar që ta ndihmoj këtë iniciativë se si ta kuptojmë më mirë problemet që janë këtu dhe jo t'i qajmë hallet, siç po ndodh, dhe besoj se tendenca e kësaj iniciative KOMRA është e tillë që ajo t'i zbardhë rastet, do të thotë të ngre një iniciativë të gjykimit moral, do të thotë një shtëpi ku njerëzit e dëmtuar apo njerëzit të cilëve u janë bërë padrejtësi dhe vazhdohet t'u bëhet padrejtësi të ngrenë zërin e tyre dhe të gjejnë një mbështetje morale, mbështetje e cila në qoftë se kjo iniciativë, kjo shtëpi do të forcohet dhe do të ketë mbështetje të fuqishme, ashtu siç po deklaroni ju, atëherë kjo iniciativë dhe ky zë individual të bashkohet drejt kësaj KOMRE dhe të drejtohet drejt organeve legjitime shtetërore, po edhe atyre ndërkombëtare që të zbardhet e drejta dhe padrejtësitë dhe krimet që janë bërë gjatë kohës së kaluar, po edhe që vazhdojnë të bëhen në emër të asaj kohe të kaluar ku sot dëgjojmë patriotë dhe tradhtarë, fatkeqësisht dhe që gjithë këtë lojë të gjithë e bëjnë njerëzit të cilët kanë gisht në punën që kanë bërë deri tani.

Nuk jam dakord shumë, në fillim, duke dashur të ju jap sugjerime, meqë e njohim shumë më mirë këtë mentalitet se sa ju që vini nga jashtë. Do të kisha dashur të jap dy-tre sugjerime se si t'i ndihmohet KOMRA-s në të ardhmen që të zhytet realisht për t'u pasur dhe përzgjidhur problemet ose të marrë informacione ose të përhapet më fuqishëm në këtë regjion.

Dhe nuk do të them, nuk do të qaj hallet e luftëtarëve, edhe pse përfaqësoj luftëtarë dhe për shkak se e di që vetë ju, përfaqësues që jeni tani, as nuk keni mandat për të na treguar se çka të bëjmë, as diçka tjetër, dhe më vjen keq sigurisht se njerëzit i nxjerrin ato mllfet e veta se nuk kanë ku i nxjerrin, mirëpo unë e shoh forumin dhe se forumi ka qëllim tjetër dhe shumë të mirë.

Do të thotë iniciativa e KOMRA-s është një rrëfim i shkëlqyer për ta dëgjuar mirëpo shumë i rëndë për ta realizuar, sigurisht.

Këtu paraprakisht ju them se do të keni mbështetjen tonë në të gjitha sferat, në qoftë se vazhdohet në këtë drejtim dhe unë do të mundohem, thash edhe më parë, se në dy-tre mënyra për fillim të ju orientoj se si mund të depërtohet më mirë për të parë problemin.

Në fillim kisha dashur që KOMRA në të ardhmen mos ta ketë vetëm angazhimin në zgjidhjen e problemeve dhe gjetjen e fajtorëve apo viktimave të cilët kanë pësuar dhe janë eliminuar ashtu siç përmendet disa herë se janë edhe 16.000 kufoma njerëzish të zhdukur, që është një iniciativë shumë e mirë dhe që do të ndihmonte shumë në aspektin moral njerëzit të cilët kanë vuajtur, por thjeshtë për interesin e saj më të madh të fokusohet edhe në viktimat që vazhdojnë të vijnë nga ai konflikt, për shkak se ne e dimë që në hapësirat ish-jugosllave mbi 50% të njerëzve të cilët ishin shkaktarë të konfliktit vazhdojnë të jenë sot në pushtet dhe këta sigurisht punojnë që të fshehet e vërteta, që të mos zbardhet krimi realisht dhe ata sigurisht edhe e kanë mashën për të bërë atë dhe KOMRA tani për momentin nëse nuk forcohet nuk do të ketë mekanizëm ose armë të tillë që ta luftojë këtë. Dhe, sigurisht, arma e vetme është përfshirja sa më e madhe e popullatës në mbështetjen e kësaj iniciative. Nuk do isha dakord me formulimin që e keni bërë që Maqedonia duhet të jetë e ngjashme me Slloveninë. Është shumë dakord që të jetë me Slloveninë për shkak se viktimat janë shumë më të pakta në krahasim me shtetet tjera, mirëpo do kisha dashur të shihet në aspektin politik diçka tjetër: që Maqedonia duhet të vihet më shumë e ngjashme me Bosnjën për shkak se nga gjithë luftërat që janë bërë në Jugosllavi, nga ku janë formuar shtete të reja, vetëm Bosnja dhe Maqedonia patën konflikt brendapërbrenda dhe mbeten të njëjtat shtete. Do të thotë këtu është mjeshtëria në të cilën po të njëjtit njerëz vazhdojnë të jenë dhe të fshihen brendapërbrenda institucioneve të të njëjtit shtet dhe këtu sigurisht se KOMRA në të ardhmen do ta ketë shumë më rënd dhe shumë më vështirë për t'i zbuluar këta njerëz brendapërbrenda, të cilët gjithmonë duke pasur instrumentin e pushtetit në duar arrijnë që viktimat t'i bëjnë fajtorë, ndërsa fajtorët t'i kthejnë në viktime.

Kjo do të ishte njëra nga qasjet. Që këtu kisha dashur që përkthimi të jetë më i saktë, në qoftë se vazhdon të jetë, se në konferenca të tilla kemi pasur problem me përkthimet dhe shpeshherë ka ndodhur që atë që e themi - kur e lexojmë në gjuhë tjetër - nuk arrijmë ta kuptojmë se vetë çka kemi thënë.

Në anën tjetër, atë që do kisha dashur të qas, do kisha dashur që KOMRA në të ardhmen mos të jetë vetëm si një pus ku njerëzit do ta nxjerrin mllëfin apo do të thonë diçka, mirëpo ta ngre një iniciativë e cila në qoftë se nuk do të ecë në gjyqet shtetërore që të prezantohet si e tillë, të marrë iniciativë dhe këto problematika të përcillen edhe në Gjykatën Ndërkombëtare, që të bëhet ajo më e fuqishme sigurisht, gjithmonë për të ngritur fjalën e së vërtetës.

Do të thotë këto janë, një – dy iniciativa, të cilat besoj se do të ju kishin ndihmuar shumë më shumë juve dhe veçanërisht unë tash do të prek dy segmente në Maqedoni, që t'i keni si shembull për të ardhmen.

Për shembull, është rasti i Gjykatës Ndërkombëtare për krime lufte në Jugosllavi, në Hagë dhe konkretisht do të merrem me çështjen e Maqedonisë. Thotë, është dënuar i vetmi person i dënuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës për Krime Lufte, është Johan Tarçullovski, përfaqësues i forcave të sigurisë së Maqedonisë dhe nuk ka asnjë tjetër. Absurditeti ndodh në këtë drejtim, e flas në politikën reale. Thotë, shpallja fajtor nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës i një personi që sigurisht mund të ketë mbështetje ose ka gjet mbështetje në dokumentacione, mbrohet fuqishëm nga shteti dhe nga deputetët e strukturave shtetërore. Nëse realisht ndodh edhe tjetra palë që janë hapur disa procese në Gjykatën Ndërkombëtare që nuk kanë gjet bazë argumenti në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës janë hapur në Maqedoni të njëjtat probleme dhe sigurisht se pala shqiptare këtu nuk është dakord, edhe ajo që është në pushtet dhe ajo që është në pushtet, ndërsa pala maqedone duke dashur të gjejë ngushëllim nga ajo se është dënuar dikush tjetër, thotë: po mundohet që të gjejë argumente tjera. Dhe këta janë dy kanalizime në të cilët sigurisht në të ardhmen do t'i kishin ndihmuar

KOMRA-s pa dashur të hyjë se kush është fajtor dhe kush është viktimë, do t'i kishin ndihmuar KOMRA-s në të ardhmen që të fokusohet për të kuptuar mentalitetin real të popullatës në Maqedoni. Faleminderit!

EUGEN JAKOVČIQ: Para së gjithash do të doja t'ju sqaroj diçka që është thënë në procesin e deritanishëm të konsultimeve dhe një nga parakushtet më të rëndësishme është definimi i termit „Viktimë“ dhe për këtë aktualisht po punohet në KOMRA. Shumë përfaqësues, të mos i përmendim tash, përfaqësues të unioneve dhe shoqatave janë të mendimit se viktimë nuk mund të jetë në asnjë mënyrë personi që mban armë. Nga ana tjetër, ne kemi mendimet e juristëve të cilët thirren në standardet e së Drejtës ndërkombëtare – Konventa e Gjenevës – e cila thotë se viktimë mund të jetë edhe personi i pambrojtur ndaj të cilit kryhet krim i luftës apo shkelje tjera të rëndës të të drejtave të njeriut duke përfshirë edhe krimin e luftës kundër të robërve të luftës.

Po e theksoj edhe një herë, ky mekanizëm në radhë të parë përqendrohet te viktimë. Natyrisht, se kjo është edhe në interes të veteranëve të luftës.

Nga konteksti dhe përvoja e Kroacisë dhe procesit konsultativ atje, mund t'ju them se ne kemi formuar një grup të vogël që po punon, këtu është kolegu nga Qendra për studime të paqes, disa nga ata ishin nismëtarë të këtyre studimeve të paqes...pra ne kemi formuar një grup të vogël të njerëzve që punojnë me mbrojtësit, sepse mbrojtësit kanë disa karakteristika të veçanta. Atyre natyrisht se do t'ju interesojë gjithë narrativi (tregimi) i krimeve, të shohin nëse edhe ata gjenden aty, gjithashtu edhe dëshmitë e viktimave janë shumë interesante për ata, a janë ato të vërteta. Gjithashtu u intereson të dinë se cili do të jetë raporti i KOMRA-s si komision i ardhshëm, si mekanizëm jashtë-gjyqësor në raport me gjithë atë që do të vërtetohet para këtij komisioni dhe procedimet (penale) eventuale. Do të thotë ekzistojnë shumë çështje për të cilat janë të interesuar veteranët apo mbrojtësit, siç quhen në Kroaci. Ata në këtë proces janë më tepër vëzhgues, të paktën kur flitet për atë si po zhvillohen ngjarjet tani, pra më tepër këto pyetje u interesojnë nga pozita e vëzhguesit, kurse nga ana tjetër, po e theksoj edhe një herë, ne kemi punuar me veteranët në kontekstin e njerëzve të robëruar, torturuar, pra flasim për robërit në kampet e përqendrimit. Bëhet fjalë për viktimë dhe ata me plotë të drejtë janë përfshirë në këtë proces, prandaj edhe me ata i kemi mbajtur ato konsultimet e mëdha dhe në debatin e mbajtur në Dubrovnik u shfaqën mendime të ngjashme. Megjithatë, po ju them, ata më shumë janë koncentruar në çështjet për të cilat fola më lartë, kurse të drejtat dhe problemet tjera me të cilat ballafaqohen secili në shtetin e vet në hapësirat e ish Jugosllavisë, është diçka që gjithsecili e zgjedh në mënyrë individuale dhe në varshmëri të asaj se si shteti në fjalë i trajton ata, si janë zgjidhur të drejtat e tyre pensionale, dhe kështu me radhë. Por ky mekanizëm para së gjithash është i drejtuar, këtë po e përsëris dhe mendoj se është shumë e rëndësishme, kah nevojat e viktimave...për këtë qëllim i kemi edhe Konventat dhe kjo është thënë shumë qartë edhe gjatë procesit konsultues.

ILIJA NIKOLOVSKI: Unë isha pjesëmarrës edhe në tribunën për demitologjizimin e vitit 2001, respektivisht për demitologjizimin e Tetovës, Haraçinës dhe kështu me radhë dhe jam pjesëmarrës aktiv i këtyre diskutimeve.

Që në fillim dua ta përsëris iniciativën dhe për t'i rënë shkurt mendoj se kjo iniciativë duhet të pranohet edhe në Republikën e Maqedonisë dhe unë jam një nga përkrahësit e saj. Bëj pjesë në njerëzit që përpiqen të jenë maksimalisht të sqarë të cili nuk i ndan viktimat dhe nënat sipas përkatësisë kombëtare. Çdo nënë, qoftë ajo shqiptare apo maqedonase, ndihet njësoj kur humb djalin e vet.

Megjithatë, u takoj atyre që kërkojnë një sqarë të madh, prandaj mendoj se kemi bërë hapin e parë në këtë drejtim me debatin për demitologjizimin e vitit 2001. Një thënie kineze thotë: Të gjitha marshet e mëdha fillojnë me hapin e parë. Prandaj duhet të punojmë shumë për ta sqaruar vitin 2001.

Nga njëra anë kishte përpjekje për sinqeritet. Kurse nga ana tjetër nuk kemi absolutisht kurrfarë sinqeriteti. Kam lexuar 21 libra në lidhje me vitin 2001 dhe nëse i lexoni edhe ju do të shihni se disa njerëz i shohin gjerat varësisht se ku janë shkolluar. Unë nuk do ta zgjas, vetëm po them se e përkrah këtë nismë sepse duhet të përgatiten dosjet e të gjitha viktimave, por duhet të jem i sinqertë dhe të them se unë jam një nga iniciatorët që të ulen së pari komandantët nga ana maqedonase dhe komandantët e UCK-së, të ulemi dhe të bisedojmë...unë për çdo ditë shoqërohem me shqiptarë dhe nënkryetari në shoqatën time është shqiptar, përiqemi që të tërheqim sa më shumë njerëz dhe të jemi shoqatë multietnike dhe për çdo ditë bisedojmë shumë hapur për këto probleme.

Edhe këtu, sikurse edhe gjatë jetës së përditshme kemi zmadhimin e fakteve. Për shembull, kolegu Grkov do të ishte mirë të na tregoj se ku ka dëgjuar për 200 vetëvrasje, nuk ishte aspak i qartë në lidhje me ato që tha, ose për shembull kur flasim për sinqeritet, një muaj më parë Hajruni u paraqiti në ALSAT duke pohuar se janë vrarë 541 maqedonas, në fakt jo maqedonas, tha se janë vrarë 541 shqiptarë nga ana e autoriteteve maqedonase. Tash do ta pyesja gjeneralin Tushi, pse nuk ka reaguar asnjëherë kur është përmendur numri prej 541 të vrarësh, ju mund ta kritikoni shtetin se nuk është efikase në zbulimin e rasteve, por tash së fundi ndodhi vetëvrasja respektivisht vrasja në Haraçinë, kurse më vonë ndodhi vrasja në Viti, tash unë po pyes mos janë autoritetet maqedonase përgjegjëse për këtë që ngjau? Prandaj autoritetet mund të jenë përgjegjëse për jo efikasitet, kurse jo për zbulimin e gjërave. Pse e përkrah këtë iniciativë? Konflikti apo lufta që u zhvillua te ne, nuk është me rëndësi si e quajmë, ishte e intensitetit më të ulët në krahasim me ato në rajon. Kjo nuk mund të krahasohet me konfliktet në vendet tjera, por, pavarësisht kësaj, edhe ne kemi viktimë, kemi njerëz të zhdukur për të cilët akoma nuk e dimë se ku ndodhen. Prandaj presim sinqeritet nga pala tjetër që njëherë e përgjithmonë të sqarohet se ku janë këta njerëz... kanë ndodhur vrasje, e tash a do të gjykohen apo jo...për mua nëse nuk bëhet fjalë për terrorizëm...megjithatë, mënyra se si janë kryer, caqet që janë zgjedhur – ato janë terrorizëm, mënyra e kryerjes...për shembull në Mjekësinë ligjore kemi atë që quhet vrasje, vrasje e zgjatur apo vrasje në një kohë tjetër. E kemi rastin Veice, ata bartin armë, u është ngritur kurthi, ju lutem, por të kënaqesh duke e masakruar atë që është plagosur apo vrarë, unë çuditë se çfarë mostrumash janë atë që bëjnë kësi gjërash në shekullin XXI e deri më tani askush nuk është paraqitur të thotë se kush janë ata, kurse kjo dihet. Për këtë arsye pres sinqeritet nga të dy anët, si nga pala maqedonase ashtu edhe nga ajo shqiptare, të ulemi dhe të bisedojmë për sa kohë që zgjat ky proces, do të jetë shumë i mundimshëm, megjithatë këtë duhet ta bëjmë nëse e duam të ardhmen sepse fati ka dashur që të jetojmë në këto hapësira së bashku. Petrit Mena ka botuar një libër „UÇK-ja mesazhi dhe shpresa“. U ula me të për të pirë nja kafe së bashku dhe pas kësaj i thash: E di si Petrit, e di cili është mesazhi për mua? Mesazhi për mua është se ne duhet të kuptojmë se në këto hapësira duhet të jetojmë së bashku, ky do të ishte mesazhi për mua. Megjithatë, shpresoj se nuk do të ketë më njerëz që mendojnë si ti, kur ke shkruar në libër që njëherë e përgjithmonë t'i qërojmë hesapet me sllavo-maqedonasit dhe kështu me radhë.

Që të mos e zgjas më shumë, unë pra e përkrah këtë iniciativë. Që nga pjesëmarrja ime e parë, shoh këtu kolegë që kanë marrë pjesë edhe më parë...unë kam shumë materiale që do t'i paraqes në shoqatë dhe do t'i diskutojmë, kurse ju do ta merrni edhe zyrtarisht përkrahjen nga shoqata ime. Po e përfundoj, edhe një herë ju faleminderit.

JASMINA NAJDOVSKA: Faleminderit, zotëri Nikolovski. Zotëria, në anën time nëse ka mundësi.

ARMEND MAZREKU: Po ngritem edhe unë në këmbë! Armend Mazreku, prej Lëvizjes Fol. Unë dua këtu të shpreh një shqetësim që ndoshta do të ishte i rëndësishëm për KOMRA-n. E tëra çfarë nuk do të duhej të reduktohej në punën e KOMRA-s është që të reduktohet thjeshtë në departament i statistikave ku zakonisht identifikohet vetëm numri i viktimave dhe jo me ndonjë qëllim në vetëvete. Ne kemi pas shumë, ta zëmë në Luftën e Dytë Botërore shpeshherë studimet e ndryshme përmendin u mbytën 50 milionë njerëz, pastaj komunizmi i mbyti 100 milionë njerëzë, pastaj çifutë u mbytën 6

milione, dhe në njëfarë mënyre thua që njëërzit nuk kanë kurrfarë rëndësie dhe nuk bëhet me një qëllim të caktuar. Prandaj, mendoj se rreziku është këtu që ne të bijmë në grackën e nxjerrjes së disa statistikave që: po në Kosovë janë kaq viktima, në Serbi janë kaq viktima, në Bosnje janë kaq viktima, e kështu me radhë. Ndoshta qëllimi në vetvete do të ishte ai çka edhe ... kur e analizon Aushvicin thotë Never e gen Aushvic, domethënë në njëfarë mënyre mesazhi i punë së KOMRA-s të jetë që në të ardhmen në njëfarë mënyre ideja e luftërave ndërmjet kombeve të ndryshme të eliminohet nga terreni i tyre politik.

Nën dy. Është përmendur këtu që një nga përparësitë është që kjo iniciativë është në njëfarë mënyre burimore, është autentike, nuk ka ndonjë shtysë nga jashtë, siç është Bashkimi Evropian apo ndonjë mekanizëm ndërkombëtar. Megjithatë, unë prapë se prapë mendoj që Bashkimi Evropian do të mund të luante një rol jashtëzakonisht të madh në shtyrjen e proceseve të tilla të cilat në njëfarë mënyre përherë e përgjithmonë do të jepnin fund plagëve të cilat ende mbretërojnë në territorin e shteteve të ish-Jugosllavisë, sepse siç u tha këtu, janë 16.000 të zhdukur, 16.000 të zhdukur nuk janë ata që me vullnetin e tyre thjeshtë janë zhdukur. Pra, nuk janë që janë zhdukur në njëfarë mënyre vetvetiu, por ka qenë dikush që në njëfarë mënyre e ka bërë që një projekt i tillë çnjerëzor dhe do të thoja shtazarak të ndodhë dhe ngjante, atëherë do të duhej një shtysë e Bashkimit Evropian, veçmas që t'i detyronte autoritetet e secilit shtet që t'i zbulonte këta të zhdukur që për mendimin tim nuk janë të zhdukur, sepse i zhdukur do të thotë që ti kur me vetëvullnet, në njëfarë mënyre fshihesh e kështu me radhë, por t'i detyronte autoritetet shtetërore të secilit shtet që të zbardhet njëherë e përfundimisht çështja e këtyre personave të cilët janë të zhdukur nga dikush.

Prandaj, unë i shoh këto dy elemente që janë ndoshta esenciale në eficientë dhe punën e KOMRA-s. Kaq kisha!

JASMINA NAJDOVSKA: Ju faleminderit! Zotëri Goce Arizankovski, nëse mundet!

GOCE ARIZANKOVSKI: Së pari i përshëndes të gjithë pjesëmarrësit. Unë jam Goce Arizankovski, Kryetar i Forumit për siguri.

Do të doja të përgjigjem në pyetjen e zotëri Eugen JAKOVÇIQ, a ka nevojë shoqëria maqedonase për KOMRA-n. Përgjigja është po! Shoqëria maqedonase ka nevojë për një iniciativë të këtillë, apo për KOMRA-n, por që kjo të jetë e suksesshme dhe që faktikisht ta dëshmojë këtë duhet të përmbushen disa kushte.

Sot dëgjoj terminologji të ndryshme, dëgjoj se përmenden luftëtarët e UÇK-së, lufta, komandantët, do të thotë flitet për kuazi-kategori dhe shtrohet pyetja për përcaktimin e terminologjisë zyrtare, pra të bëhet kategorizimi objektiv që do të mundësojë një diskurs objektiv dhe të besueshëm të vitit 2001. Kjo problematikë e terminologjisë dikujt mund t'i duket banale, por e gjithë kjo ka kuptim, sepse mund të ndihmojë që të zhvillohet një proces pozitiv. Pra ky aparat kategorizues do të kishte të bëjë me së paku tre dimensione. Dimensioni i parë është dimensionin fenomenologjik, pra është fjala për fenomenologjinë e ngjarjeve të vitit 2001, përgjithësisht e ditur, e dukshme dhe e qartë. Pra ndodhi një formë e posaçme e terrorizmit masiv etno-nacionalist ku bartësi, të paktën zyrtarisht, UÇK-ja terroriste, nuk është palë në konflikt.

Dimensioni i dytë ka të bëjë me etiologjinë. Kjo është më pak e paqartë, por do të duhej të vërtetohet, të paktën ato elementet bazike në mënyrë që të mund t'i identifikojmë orientimet kryesore për vërtetimin e fakteve, për të cilat tani angazhohet iniciativa për formimin e KOMRA-s. Dimensioni i tretë, jo më pak i rëndësishëm nga ai paraprak, dimensionin viktomologjik, do të thotë përcaktimi objektiv i viktimave të vërteta të vitit 2001. Raporti i posaçëm, do të thotë raporti hajt të themi kushtimisht, e paqartë... nuk mundet gjithkush të jetë viktimë, pra ai raport i drejtë dhe protektiv i shtetit në raport me viktimën.

Më tej do të na duhet që kërkim-falje publike e UÇK-së terroriste, pra kërkim-falje nga udhëheqësit e UÇK-së terroriste dhe vetëm atëherë unë mendoj se pala tjetër, të themi kushtimisht, do ta pranojë

atë, por ky është parakusht për zhvillimin e proceseve pozitive në të ardhmen. Do të jetë e nevojshme përcaktimi i fajit. Ligjin për amnisti, thënë kushtimisht, ka të bëjë me lirim kolokfial të personave për të cilët më parë nuk është vërtetuar faji. Ligji për amnisti nuk do të thotë se dikush është shpallur i pafajshëm, por ai ka pasur aspektin social, ndoshta për shkak se në këtë mënyrë do të mundësohet zhvillimi i proceseve pozitive në aspektin multietnik.

Po e përfundoj, është e rëndësishme të zgjidhen katër rastet e Hagës, zyrtarisht thuhet katër rastet e Hagës që kanë të bëjnë me udhëheqësinë e UÇK-së, rasti i punëtorëve të Mavrovës, Diga e Likovës dhe 12 maqedonasit e kidnapuar. Po të ndriçohen të paktën këto dimensione, unë jam i bindur, jo i sigurt, i bindur se ka gjasa që përfundimi i kësaj iniciative të japë rezultate konkrete për shoqërinë e Maqedonisë. Ju faleminderit.

EUGEN JAKOVÇIQ: Unë mendoj se tash mund të kemi listën e pjesëmarrësve dhe gjithashtu në folderët tuaj – në dosje gjenden fletë-anëtarësimet, prandaj mendoj se është e rëndësishme por jo më e rëndësishmja, gjithashtu se është i rëndësishëm angazhimi qoftë i organizatës por edhe i individëve, por gjithsesi mund ta vazhdojmë komunikimin përmes e-mailit ku kolegët e Fondit për të Drejtën Humanitare nga Prishtine, të cilët ishin sot janë organizatorë pranë Koalicioni për KOMRAN, do t'ua dërgojnë konkluzionet dhe transkriptin e këtij takimi dhe projekt modelin, sepse ai vazhdimisht po ndryshon, respektivisht diskutimi në lidhje me të është shumë i gjallë dhe vazhdimisht shtohen detaje të reja. Por, gjithsesi se do të ketë më shumë informacione dhe më shumë komunikime me kolegët nga Maqedonia të cilët janë këtu sot, por dhe me ata që nuk janë apo nuk kanë mundur të vijnë, por që e dimë se janë shumë të interesuar sepse kanë qenë pjesëmarrës në takimet tona të mëhershme.

JASMINA NAJDOVSKA: Faleminderit, Eugen! Vazhdojmë me diskutime. Urdhëroni zotëri! Mikrofonin ju lutem!

OLIVER BARSHANOVIQ: Faleminderit! Lënda që unë e mësoj, e ligjëroj dhe me të cilën merrem është viktimologjia, është lëndë që mësohet në Fakultetin tonë më shumë se dhjetë vite . Mendoj se ky është një vend dhe shkas i mirë për të diskutuar edhe për viktimat, por edhe të diskutohet për gjithë atë që dëgjuam sot.

Së pari falënderoj të gjithë udhëheqësit e takimit për fjalimet e tyre dhe për mirëkuptimin që patën me të gjithë që morën pjesë në diskutime. Kryesuesit dalë ngadalë erdhën tek çështja qendrore për të cilën diskutohet sot, kurse vura re se disa nga diskutantët kishin marrë pjesë në diskutimet e ngjashme dhe tash e kam të qartë atë se çka dëshiron të arrijë kjo iniciativë, po, pajtohem kjo iniciativë fisnike.

Në fillim do të thoja se shumë më lehtë është ta shkaktojmë luftën se sa të merreni me pasojat e luftës dhe besoj se të gjithë do të pajtohen me këtë. Fakti se edhe dhjetë vite apo edhe më shumë nga përfundimi i luftës akoma po bisedojmë për viktimat, akoma po konstatojmë se pritjet e viktimave nuk janë plotësuar, akoma flasim se viktimat presin satisfaksion dhe kështu me radhë, edhe një herë e vërteton këtë që thash më lartë. Është e saktë se edhe në viktimologji dhe në opinionin e përgjithshëm shkencor dhe profesional shpeshherë shtrohet pyetja në lidhje me mënyrën se si para së gjithash t'u jepet rëndësi viktimave dhe si, të them ashtu, t'i mundësohet viktimës ta thotë të vërtetën e saj, ta tregoj tregimin e vet. Prandaj edhe për viktimat është me rëndësi që të kenë mundësi të thotë të vërtetën e vet.

Pajtohem me parafolësin që theksoi se formimi i komisioneve, ideve apo zgjidhjeve të këtilla janë bërë praktikë në fund të shekullit të XX, por mund të themi se ka vazhduar edhe në shekullin e XXI. Dhe me të vërtetë, ajo që për mua është e re në këtë ide është karakteri rajonal i saj. Me aq sa kam njohuri për këto komisione, ato deri më tani kanë mbetur në nivel kombëtar dhe me sa shohim, për fat të keq, ky komision, respektivisht përvoja që doli nga shtetet në hapësirat e ish Jugosllavisë nuk është për mburrje dhe nuk shquhet për ndonjë rezultat të madh. Mbase kjo është mënyra faktike për

tejkalimin e këtij problemi. Sidoqoftë, pyetja kryesore për mua është si do ta përfitoni viktimën që ajo ta thotë tregimin e vet, respektivisht të vërtetën e vet, apo jo?

Tash do të ndërlihem edhe me atë që dëgjova sot për mënyrën e skicimit të komisionit dhe si duhet të funksionojë ajo. Para meje është një nga pyetjet se çka duhet të kemi parasysh dhe si do të përcaktohen kriteret në lidhje me atë se çka nënkuptojmë ne apo çka nënkuptohet me viktimë. Kjo është një nga pyetjet që sipas meje mbetet disi e pasqaruar deri në fund. Prandaj flasim për këto apo ato përvoja, për standarde ndërkombëtare, por mendoj se kjo është një pyetje që nuk ka përgjigje.

Pyetja e dytë është se si dhe sa t'ia dalim ne që ta forcojmë viktimën. Do të thotë se në ç'mënyrë do t'i ofrojmë ndihmë. Pra, ju shihni, ne kërkojmë nga viktima që ajo të tregojë të vërtetën, ajo nuk e tregon, apo nuk e tregon të vërtetën në tërësi, kështu që shtrohet pyetja se a ka pasur dhe cilët janë ato arsye që deri më tani ajo nuk ka pasur mundësi, apo ka qenë e frikësuar dhe çka e ka demotivuar të tregojë të vërtetën? Përndaj, për mua është me rëndësi edhe përgjigja në pyetjen se si do t'i motivojmë viktimat ta tregojnë rrëfimin e vet.

Pyetja tjetër që ndërlihet me këtë, është se si do ta mbrojmë viktimën. Për mua pyetja qenësore është: a është frikësuar viktima të thotë tregimin e vet, qoftë për shkak se nuk do të ketë përkrahje as në mjedisin e vet e as më gjerë ose sepse kjo do t'i merret për të keq. Përvoja me Tribunalin e Hagës tregon se shumë nga viktimat nuk duan të dëshmojnë, madje edhe për gjërat që u kanë ndodhur atyre. Kjo është me të vërtetë një çështje për të cilën nuk kemi përgjigje dhe shtrohet pyetja pse ndodh kjo? Ne vetëm mund të supozoj se cilat janë arsyet. Shumë krime kanë mbetur të pa zbuluara pikërisht për shkak viktima thjeshtë nuk ka dashur të bashkëpunoj. Sigurisht se duhet t'u kërkojmë viktimave të bashkëpunojmë, por atyre duhet siguruar mbrojtje për këtë bashkëpunim. E di se ka pasur programe për mbrojtjen e viktimave dhe Trbunali i Hagës kishte një zgjidhje se si të mbrohet viktima, por unë po flas për disa pengesa objektive dhe subjektive me të cilat do të ndeshet komisioni kur të fillojë me punë

Problemi i tretë apo i katërt, nuk ka rëndësi, janë paqartësitë në lidhje me kriteret sipas të cilëve do të zgjidhen anëtarët e komisionit. Pra, nuk është çështja se nga vijnë anëtarët, mendoj se është e logjikshme që ata të zgjidhen nga anëtarët e shoqatave të ndryshme që i janë bashkangjitur iniciativës, megjithatë për mua kriteret për zgjedhjen e këtyre njerëzve janë po aq me rëndësi dhe dua të di se a mendohet edhe për këtë çështje. Ky është një nga shqetësimet e mia dhe shpresoj se do të marrë përgjigje në pyetjet e parashtruara.

Ta them edhe këtë se kjo hapësirë më demotivon për të diskutuar dhe shpresoj se në të ardhmen organizatorët do të zgjedhin një hapësirë të përshtatshme për t'u zhvilluar bisedimet e këtilla. Unë kam edhe një pyetje për organizatorët. Pyetja ime është kjo: pse jemi ndalur vetëm në diskutimin në lidhje me detyrat e komisionit, me fjalë të tjera për përcaktimin e fakteve për të vërtetën respektivisht për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe pse nuk kalohet në çështjen tjetër, e cila për mua është e një rëndësie thelbësore, kur do të dimë të vërtetën për viktimat. A kemi mbetur mbara në lidhje me këtë? Kjo problematikë këtu është përmendur rrallë, është thënë se do të shkojmë më tej, se ky është qëllimi ynë, qëllimi tjetër është thënë se do të jetë të grumbullojmë një milion nënshkrime, unë e pranoj se kjo është me rëndësi, por unë ju pyes pse komisioni nuk kalon në fazën e dytë, apo ndoshta për faktin se ajo mund të shihet si shumë ambicioze. Dijeni se rrëfime të viktimave nuk do të ketë, apo ato nuk do të jenë të vërteta nëse përmes tyre nuk dërgohet një mesazh apo nëse nga ato nuk nxirret ndonjë përfundim. Prandaj, kjo faza e dytë, apo ajo që paraqet qëllimin përfundimtar kallëzimin e të vërtetës, për mua është duke u vonuar. Nuk e kam qëllimin këtu që t'ju mbaj ligjërata si profesor, megjithatë dua të them diçka shkurt, këto dilema që po më mendojnë...më duhet të them...sot erdha i papërgatitur për këtë ngjarje, për mua kjo ishte një ide relativisht e re, u informova nga asistentja ime dhe kështu me radhë, mendoj se megjithatë organizatorët duhet të mbajnë shënime se cilat çështje i interesojnë shtetit të caktuar, kujt çka i intereson, kush shkruan për

këtë problematikë. Ne nuk jemi shumë në Maqedoni, numri i njerëzve që merren apo shkruajnë për këtë problematikë mund të numërohet me gishtat e dorës, kështu që këto të merren parasysht. Mua më vjen shumë mirë që sot kam njohur shumë njerëz këtu dhe them se ky është një fillim i mirë që me të vërtetë të thuhet shumë gjëra për Maqedoninë, por them se ne me të vërtetë në mënyrë të barabartë... për fat të keq nuk duhet shumë të mburremi me barazinë për arsye se edhe ne kemi përvojat tona të luftës, por ky është fakt, ky është realitet, pra të shohim se në ç'masë Maqedoni mund t'ju ndihmojë në gjithë këtë. Unë gjithmonë kam punuar nga aspekti viktimologjik dhe këtë e shoh nga ky aspekt. Faleminderit!

JASMINA NAJDOVSKA: Ju faleminderit, profesor! Profesori bëri shumë pyetje interesante, pra le t'i dëgjojmë përgjigjet.

EGUEN JAKOVČIQ: Shumë shkurt. Ju keni prekur disa çështje shumë të rëndësishme, të cilat mbase i kemi shmangur në fillim të debatit sepse kishim aq shumë gjëra për të thënë dhe unë ndoshta e kam lënë atë pjesë kur kam folur për rëndësinë e aspektit rajonal. Nëse ju kujtohet, unë kam thënë diku se kjo pozitë e viktimës e ka përcaktuar karakterin rajonal të iniciativës dhe komisionit të ardhshëm. Krejt në fillim, organizatat që e kanë nisur gjithë këtë iniciativë dhe të cilat më vonë me energjinë e tyre të madhe e iniciuan edhe KOMRA-n, duke monitoruar gjykimet për krime të luftës kanë vënë re se faktet për krimet e kryera dhe kryesit e krimeve janë në një shtet tjetër, kanë nxitur dhe kanë mundësuar në njëfarë mënyre fillimin e bashkëpunimit të prokurorive nga Serbia, Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina. Megjithatë, unë këtë mekanizëm të komisionit rajonal e shoh shumë të rëndësishëm pikërisht në çështjen e besimit.

Shtrohet pyetja se çka ka ndodhur me ato viktimat e nacionalitetit tjetër, të cilat të gjithë ne i kemi nëpër mjediset tona, ato viktimat për të cilat nuk interesohet askush. Me të vërtetë shtrohet pyetja, a mundet ajo viktimë të ketë besim në një organ një-nacional, respektivisht në organin të cilin do ta themelonin institucionet që pjesërisht kanë sjellë deri të shkeljet e të drejtave të njeriut, respektivisht i kanë rrezikuar jetët e më të afërmeve të tyre, kur bëhet fjalë për shoqatat e viktimave. Për këtë arsye, koncepti i besimit në rastin tonë është shumë i rëndësishëm.

Unë me të vërtetë mendoj se viktimat nga radhët e nacionaliteteve tjera do të kishin shumë më tepër besim në një organ të këtillë siç është komisioni sesa në organin e themeluar nga shteti në fjalë. Sepse me të vërtetë mendoj se serbët e Kosovës do t'i besonin shumë më tepër një komisioni rajonal sesa komisionit që do të vepronte vetëm në Kosovë, respektivisht një komisioni nacional. Gjithashtu jam i mendimit se serbët e Kroacisë do të kishin shumë më tepër besim në një organ të këtillë siç është komisioni sesa në një organ një-nacional, që do të ishte vetëm për Kroaci. Për këtë arsye mendoj se karakteri rajonal i iniciativës tonë është me rëndësi dhe jep përgjigje në pyetjen tuaj sepse vendos besimin e viktimës dhe në këtë moment ne po bëjmë fushatë për të treguar rëndësinë që ka vërtetimi i fakteve për të gjitha viktimat. Milena mund të thotë më shumë për pjesët tjera juridike, kurse unë do të doja të ndërlihem shumë shkurt dhe të them se aktualisht ne kemi politikanë që flasin për të gjitha viktimat, pra kjo nuk është më storie e pasuksesshme apo storie që krijon konflikte. Në këtë moment ka zhvillime të mira politike në rajon dhe ka të bëjë me agjendën ku u kushtohet vëmendje të gjitha viktimave. Që të jem i qartë flas për Kryetarin e Kroacisë, zotin Josipović, i cili gjatë muajve të parë të mandatit u ka kushtuar rëndësi të madhe viktimave, kjo definitivisht është agjenda e tij të cilën ai do ta ndjek gjatë gjithë mandatit, por në muajt e parë ai e ka treguar atë mendimin e vet për ngjarjet në Kroaci, edhe për ato në Bosnjë dhe Hercegovinë sikurse edhe për ngjarjet që lidhen me Luftën e Dytë Botërore. Prandaj, dëshiroj vetëm të them se kur bëhet fjalë për viktimat, për të gjitha viktimat, kjo nuk është më ekskluzivisht tema jonë. Është interesante vizita e Kryetarit Josipović në Bosnjë dhe Hercegovinë, ku ai u përul para viktimave kroate, serbe dhe boshnjake, ngjarje kjo që u kontestua pastaj për shkak të disa deklaratave të tij

politike, por vet fakti se ai u përul para të gjitha viktimave nuk ishte aspak kontestuese për askënd. Përkundrazi, të gjithë e theksuan këtë si diçka shumë të vlefshme dhe të rëndësishme.

MILENA SAVIQ: Dua të them diçka para se Salihu të marrë fjalën, shpresoj se ai nuk do të zemërohet që do them disa fjali. Me rëndësi është se komisioni rajonal do të futet të them ashtu në kontekst juridik, bazuar në të Drejtën ndërkombëtare vendore/publike. Kjo është shumë e rëndësishme sepse në këtë mënyrë do të përkufizohet mënyra e implementimit të kësaj marrëveshje ndërshtetërore që do t'i definojë të drejtat dhe detyrimet, sikurse edhe qëllimet dhe detyrat e KOMRA-s si organ rajonal.

Ajo që më shtyri të lajmërohem në këtë bisedë ishte pyetja se çka do të bëjmë me atë materialin e grumbulluar përplot fakte, prova materiale dhe kështu me radhë. Si të veprojmë që ajo të bëhet e shfrytëzueshme, me qëllim që ato të shkojnë në dobi dhe për mbrojtjen dhe motivimin shtesë të viktimave...të motivohen duke u ofruar mbrojtje, duke i siguruar se ato që prezantojnë viktimat dhe ajo që do të vërtetohet do të jetë e përdorshme, me fjalë tjerë të ketë një beneficion për shoqërinë. Sipas mendimit tim, si juriste dhe si person që merret me të drejtën ndërkombëtare publike, këtë duhet shikuar në kuptimin që gjatë periudhës së implementimit e ndoshta edhe më herët do të ndryshohen dhe të plotësohen ligjet e caktuara që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale, do të thotë legjislacionin penal, që nënkupton se duhet të punohet në ndryshimet dhe plotësimet e këtij legjislacioni, i cili do ta rregullojë mundësinë e shfrytëzimit të këtyre materialeve, këtë opus të fakteve dhe provave dhe të ngjashme. Pra, nëse vërtetohet se dikush ka kryer ndonjë vepër penale, vjen deri te individualizimi i përgjegjësisë së tij dhe pyetja shtrohet se si, në ç'mënyrë këto fakte t'iu delegohen institucioneve të drejtësisë, prokurorive, policisë etj.

Në fillim të këtij diskutimi u tha se ky nuk është trup gjyqësor, nuk e ka të ndërtuar mekanizmin e shfrytëzimit të këtij materiali, këtyre fakteve dhe kështu me radhë. Pra, kjo është përsëri çështje që duhet diskutuar dhe të marrim sugjerimet, mendimet, propozimet nga këto konsultime. Pyetja tash shtrohet se në ç'mënyrë t'i gjejmë ato mekanizma për ta shfrytëzuar atë opus të materialeve që do të grumbullohet dhe që do të vërtetohen nga dëshmitë dhe dokumentacioni tjetër.

EUGEN JAKOVČIQ: Apo ai që tashmë është vërtetuar dhe grumbulluar!

MILENA SAVIQ: Ashtu është!

JASMINA NAJDOVSKA: Faleminderit! Për diskutim është lajmëruar zotëria, atje në anën e djathtë.

SALIH RASAVAC: Unë jam Salihu, jam nga Sarajeva, punoj në shoqatën joqeveritare Koridor, misioni i së cilës është të ofrojë përkrahje psiko-fizike për viktimat e luftës.

Unë do të largohem nga ky sesion i pakënaqur. Paksa jam konfuz! Gjithë vëmendjen sot e kemi përqendruar në nevojën, arsyeshmërinë dhe përshtatshmërinë e Këshillit rajonal, formimin dhe ristrukturimin e Këshillit rajonal. Unë do t'ju tregoj një situatë në Bosnjë dhe Hercegovinë e cila është ende aktuale. Tash është duke u zhvilluar Kampionati Botëror i Futbollit...kur u eliminua reprezentacioni i Serbisë e gjithë rinia e Banja Lukës, praktikisht e gjitha u drejtua për ta shkatërruar Xhaminë e Fehradinit, e cila është në procesin e rindërtimit dhe rinovimit. Pyetja shtrohet: pse këta të rinj shkojnë të shkatërrojnë një objekt të besimit mysliman – islam. A u nisën drejt kësaj për shkak të vizionit të deformuar, të vërtetës së deformuar, për shkak të formësimit të vetëdijes në rrethimin një-nacional ku mbretëron intoleranca absolute ndaj gjithë të tjerëve. Në kohën kur është lajmëruar ideja për KOMRA-n unë isha përkrahësi më i madh i kësaj iniciative, i nisur nga mendimi se nëse veprojmë ne do t'i ushqejmë gjeneratat të cilat do ta përmirësojnë padrejtësinë në Bosnjë dhe Hercegovinë të cilën njëri korpus nacional ia ka shkaktuar atij tjetrit dhe anasjelltas. Kam menduar se do të bisedojmë në këtë mënyrë, megjithatë ajo që po ndodh tani është se po e shndërrojmë KOMRA-n në institucion për t'i ndërtuar e jo për t'i shkëmbyer përvojat, njohuritë dhe nevojat tona. Qeshni ju kolegë sa të doni! Jeni shumë të pasjellshëm, më duhet t'ua them. Ju! Kur flas unë, unë

jam njeri i vjetër, serioz, punoj në shoqatën më të vjetër të sektorit joqeveritare në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe nuk bëra gjë tjetër por artikulovala mendimin tim ndaj ngjarjeve në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe për herë të parë artikulovala nevojën që të ulemi së bashku me kolegët nga Republika Serbe për të biseduar për problemin e përbashkët. Çështja e të vërtetës është çështje jonë e përbashkët, ne i shmangemi kësaj. Kështu pres që në një nga mbledhjet e ardhshme të ndajmë kohë edhe për të diskutuar si t'i shmangemi të vërtetës, sepse nëse në nivel lokal, nëse ideja e pajtimit dhe tregimit të vërtetës nuk gjallëron në nivel lokal atëherë nuk ka kuptim që këtë ta ndërtojmë në nivel rajonal. Së pari këtë duhet ta bëjmë në nivel lokal e pastaj në atë rajonal. Ju faleminderit!

JASMINA NAJDOVSKA: Ju faleminderit! Nëse mund t'ia jepni mikrofonin!

IVAN NOVOSEZ: Desha të ndërlihem me Milenën dhe me pyetjen e profesorit...më duket se pyetja e tij mbeti pa përgjigje konkrete dhe nëse mund të ndërhyj pak. Pra, sa i përket praktikës së grumbullimit të fakteve, është fjala për faktet dhe deklaratat që do të grumbullohen në dëgjimet e organizuara nga KOMRA, për këtë ekziston një praktikë shumë e mirë, për shembull, modeli i përdorur në Republikën Jug-afrikane, ku është dhënë menjëherë amnistia, kurse disa prova materiale janë përcjellë për gjykim publik. Unë mendoj se një praktikë e mirë për ne, që duhet ta shqyrtojmë me kujdes, është procesi përmes së cilës Prokuroria e Hagës respektivisht gjykata ua dorëzon provat materiale apo aktakuzat gjyqësisë vendase...unë këtu do të përqendrohem në provat materiale.

Shembull shumë i mirë, edhe pse asnjëherë nuk është proceduar, ç'është e vërteta ka tre vite që merren me këtë, është rastin e Merçepit në Kroaci, ku janë dorëzuar nuk e di se sa mijëra prova materiale dhe pas kësaj është shtruar pyetja se çka duhet të bëjë prokuroria vendase me këtë, pra personi kundër të cilit po, respektivisht nëse prokuroria duhet të ngrisë aktakuzë dhe në çfarë mënyre duhet ta bëjë këtë...pra nuk është një proces ku një organi i huaj ndërhy në Ligjin e procedurës penale, por thjesht shkohet në rishikimin e validitetit. Pra, provat materiale pranohen, vetëm se i përshtaten procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë penale, prandaj kjo nuk është e pamundur që të bëhet. Sepse komisioni si i tillë nuk ka mundësi të sjellë kualifikime juridike, është fjala për kualifikimet në kontestin e të drejtës për të dënuar dikë, sepse për këtë është kompetente gjykata.

E dyta, më duket se dikush pyeti se si do të zgjidhen anëtarët e komisionit, me fjalë tjera komisarët. Për këtë ende po zhvillohen diskutime në kuadër të grupit punues. Desha t'i përgjigjem edhe zotërisë që pyeti më parë se si po shkojnë punët në përgatitjen e mandatit. Pra mandati është duke u përgatitur në bazë të rekomandimeve të bëra dhe përvojave të të tjerëve, me fjalë tjera rekomandimet e bëra këto dy vitet e fundit gjatë procesit të konsultimeve i janë kthyer, respektivisht i janë dërguar Grupit për hartimin e mandatit, i cili në bazë të tyre e ka përgatitur statutin dhe mandatin dhe pasi i kanë dhënë një formë, duke marrë parasysh edhe përvojat e të tjerëve, janë pajtuar se kanë përgatitur diçka të mirë dhe e kanë kthyer përsëri në procesin konsultativ ku është duke u biseduar për këtë. Gjithashtu, sipas të njëjtës procedurë, janë duke u zhvilluar diskutimet për dy modele të mundshme në bazë të të cilit do të mund të zgjidheshin anëtarët e komisionit. Problemi i parë që duhet zgjidhur është përbërja numerike e komisionit dhe mënyra e përfaqësimit të shteteve. Pra, po diskutohet nëse çdo shtet do të ketë numër të njëjtë të anëtarëve, apo kjo do të varet nga numri i viktimave në secilin shtet apo në bazë të kriterëve tjera. Por mendoj se pyetja juaj më tepër ka të bëjë me parimin e transparencës dhe legjitimitetit të këtyre personave. Pra, grupi i punës... Dhe kompetencës, po, natyrisht! Sipas meje, Grupi i punës ka përgatitur një model shumë të mirë, pra të shkohet me modelin e emërimeve të zyrtarëve publik, procedurë kjo që praktikohet në shumicën e sistemeve tona parlamentare. Para së gjithash mendoj se ky model është shumë i ngjashëm me emërimin e gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese...mendoj se kjo ekziston edhe në shumicën e shteteve tjera, pra të shkohet përmes një diskutimi publik ku do të shqyrtohet nëse ata janë kompetent, pra fjala kompetente këtu para së gjithash e ka kuptimin të themi ashtu në „aspektin moral“. Me fjalë tjera, që

ky person të mos ketë qenë i përfshirë në shkeljet e të drejtave të njeriut, pra në aktivitete të ngjashme. Më kuptoni për çka e kam fjalën? Akoma ekzistojnë shumë dilema të cilat duhet të mënjahen dhe nevojiten njohuri të reja që të zhvillohet një model shumë i mirë.

Dhe e fundit që desha të them, ka të bëjë me komentimet tuaja në lidhje me çështjen e besimit. Unë mendoj se rezultatet e komisionit shkojnë në dy drejtime. Drejtimi i parë është përpjekja jo për ta zgjidhur por për ta zbutur deri diku gjendjen ekzistuese, kurse drejtimi i dytë është “pro futuro”, pra në gjeneratat e ardhshme. Çka mendoj kur them të veprohet drejt zbutjes së situatës ekzistuese? Unë mendoj se besimi, respektivisht çështja nëse unë dhe ti apo dikush tjetër do të pajtohemi është çështje ekskluzivisht individuale. Këtu nuk mund të ndikojë asnjë shtet, as aparati më represiv nuk mund të ndikojë në bindjet tona. Por, mund të krijohen kushtet institucionale, respektivisht të eliminohen ato kushte institucionale që ua pamundësojnë njerëzve t’i kthehen njëfarë jete të përbashkët, të krijohen kushtet për bashkëjetesë.

Pjesa e dytë, veprimtaria „pro future“, është e drejtuar kah gjeneratat e ardhshme dhe komisioni i ardhshëm, nëse themelohet, para së gjithash ka një përgjegjësi të madhe që me kualitetin e vet dhe rekomandimet e përgatitura mirë të veprojnë para së gjithash në drejtim të ndryshimit të sistemit arsimor. Pra, atë pjesë të sistemit zyrtar arsimor në bazë të të cilit punojnë dhe shkollohen gjeneratat e reja. Mendoj se dëgjimet e parapara publike janë shumë të rëndësishme, paraqesin një element brilant dhe krijojnë ndjenjën e dhembshurisë kolektive dhe këtë e vërteton përvoja nga 27 komisionet e mëhershme që kanë ekzistuar. Pra aty ku njerëzit dëgjojnë, shohin viktimën... OK aty bëhet fjalë për person, pra emrin dhe mbiemrin pa të dhëna tjera.

Mendoj se pikërisht përmes aktiviteteve të këtilla që kanë për qëllim debrutalizimin e shoqërisë mund të dilet nga gjendja e tanishme dhe të ndihmohet shkollimin e gjeneratave të ardhshme. Pikërisht kultura, toleranca, arsimimi për të drejtat e njeriut dhe paqe është më se e nevojshme. Kjo ishte e gjitha!

EUGEN JAKOVČIQ: Nëse ju kam kuptuar mirë, me këto teori dhe supozime që lidhen me përvojat e të tjerëve, ju kërkuat përgjigje në pyetjen se a humb ajo pjesa esenciale e iniciativës e që është puna në nivel lokal, si rezultat i këtij modeli dhe mënyrës së punës? Ndoshta nuk kam qenë sa duhet i qartë, unë edhe një herë po e theksoj rezultati i procesit konsultativ është shumë-shumë i rëndësishëm sikurse edhe i suksesshëm dhe frytdhënës. Ne kemi pasur një numër të madh të konsultimeve të karakterit lokal në Vukovar, Pakrac kur flasim për Kroaci, në Tuzëll, Priedor, Bërçko, Srebrenicë, Zvornik kur është në pyetje Bosnja dhe Hercegovina, gjithashtu edhe në Serbi janë mbajtur shumë konsultime në nivel lokal dhe tashmë kemi arritur ta ndryshojmë situatën aktuale. Në Vukovar kanë biseduar kroatët dhe serbët, por edhe viktimat e njëjës dhe të themi ashtu palës tjetër, e njëjta ka qenë edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Unë isha në konsultimet që u mbajtën në Travnik ku për herë të parë pas lufte, pikërisht në konsultimet tona, janë takuar dhe kanë biseduar boshnjakët dhe kroatët. Pra, duke iu falënderuar fuqisë që ka procesi konsultues KOMRA i ka shënuar këto rezultate edhe në procesin e pajtimit. Ne nuk largohemi nga procesi i pajtimit. Në fund të fundit, procesi i pajtimit është edhe esenca e mekanizmit të drejtësisë tranzicionale e shikuar nga aspekti teorik, por këtë nuk e kemi potencuar në titull, kemi zgjedhur të jemi pak më të mençur, sepse me sistemin e pajtimit dhe vendosjes së besimit është manipuluar shumë. Për këtë arsye ishim të mendimit se do të jetë shumë më e efektshme që deri te rivendosja e besimit të vijë përmes vërtetimit të fakteve, sepse vërtetimi i fakteve është shumë i rëndësishëm për ne. Ajo për të cilën foli Ivani është një sugjerim i shëndosh për gjeneratat e ardhshme dhe pajtim, por dua të them se procesi ynë konsultativ pavarësisht nëse do të krijohet komisioni apo jo po jep rezultate edhe në këtë plan. Prandaj, nuk duhet të brengoseni për këtë arsye.

JASMINA NAJDOVSKA: Faleminderit Eugen! Kemi edhe një diskutues, i cili do të jetë i fundit, sepse me të vërtetë duhet ta përfundojmë, e më pas Nora do të përgjigjet edhe në disa pyetje që janë

parashtruar. U tregua se me të vërtetë janë hapur shumë dilema, shumë çështje dhe se vetëm një konsultim do të jetë i pamjaftueshëm që të përgjigjemi në gjithë këto pyetje. Urdhëroni!

JORDANÇE TODOSIJEV: Unë quhem Jordance Todosijev, nga Forumi për siguri. Unë e përshëndes iniciativën për formimin e komisionit për KOMRA-n, do të jem shumë i shkurtër për hir të kohës...kam vetëm disa pyetje dhe do të jem i drejtpërdrejt. E para, si do të financohet komisioni. E dyta, pyetja e dytë do të ishte sa anëtarë do të kishte koalicioni dhe ku do të ishte selia, kur do të takoheshin ata dhe për fund, pyetja e fundit, deri kur është afati për t'iu bashkëngjitur koalicionit, sepse jemi shoqata demokratike... dua të them jemi shoqatë me anëtarësi dhe për të marrim një qëndrim të mirë ne duhet t'ia paraqesin propozimin anëtarësisë. Faleminderit!

JASMINA NAJDOVSKA: Ju faleminderit edhe juve!

MILENA SAVIQ: Ja pra...parashtruat një pyetje që lidhet me një çështje të hapur, do të thotë çështjen e financimit të komisionit të ardhshëm rajonal. Kjo është akoma, në njëfarë mënyre, nuk kemi kurrfarë qëndrime fillestare në draftin ekzistues, pra kjo është një e panjohur. Nëse financimi do të rregullohet përmes marrëveshjeve ndërshtetërore dhe nëse marrëveshja do të ratifikohet, shpresoj se shtetet nënshkruese të kësaj marrëveshje ndërkombëtare do të gjejnë buxhet edhe për komisionin. Pra mbetet çështje e hapur për të cilën duhet diskutuar, respektivisht duhet menduar, por edhe çështjet tjera për të cilat biseduam sot nuk janë të definuara plotësisht. Sa është numri i anëtarëve? Në fillim, pasi e definova se çka do të thotë t'i përcaktojmë qëllimet dhe detyrat e KOMRA-s, përmenda se ekziston dilemë sa i përket numrit të anëtarëve të komisionit. Ekziston një propozim sipas të cilit kërkohet që numri i anëtarëve të zgjidhte sipas një rregulli uniform, përkatësisht që secili shtet palë të ketë numër të njëjtë të anëtarëve në komisionin rajonal. Pra, propozimi është që çdo shtet të ketë nga 3 anëtarë, do të thotë 7 herë 3 që është 21 anëtarë. Në konsultimet që kemi pasur deri më tani disa pjesëmarrës kanë propozuar që Bosnja dhe Hercegovina të ketë pesë anëtarë, shtetet tjera të kenë nga tre anëtarë, kurse disa shtete dy anëtarë. Pra numri i anëtarëve do të përcaktohet nga disa kritere para së gjithash atyre kohore, sa ka zgjatur konflikti, sa ishin përmasat e shkeljeve të të drejtave të njeriut, faktet që kemi për vërtetimin e këtyre shkeljeve dhe kështu me radhë, por megjithatë ende nuk kemi kritere të definuara qartë për numrin e anëtarëve të komisionit.

Selia e komisionit, e keni edhe në draft, do të jetë në Sarajevë, dhe është parashikuar të krijohet një aparat në formë të sekretariatit, pra një organ që do të ishte në shërbim të komisionit rajonal, që duhet të kryejë një numër të madh të punëve.

Mënyra e punësimit të personelit, do të thotë personelit në Zyrat lokale, koordinimi me nën-zyrat në shtetet tjera dhe të ngjashme, sikurse edhe propozimi për delegim, respektivisht emërim të anëtarëve, janë çështje për të cilat nuk është vendosur akoma, sepse ashtu siç e thash, kjo është një çështje që pritet të definohet përmes Marrëveshjes ndërshtetërore, do të thotë nëpërmes akteve ligjore dhe nënligjore...vetëm t'i kthehem diskutimit të Ivanit i cili, në njëfarë mënyre, e preku pak këtë temë duke thënë se do të ketë një alternativë përmes së cilës do të rregullohet delegimi duke u bazuar në... zgjedhje në bazë të propozimeve dhe kështu me radhë...të propozuarit në lidhje me këtë temë është paraparë që të jenë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe organizatave të shoqërisë civile, të cilët do të japin një numër të caktuar të përfaqësuesve të tyre si dhe nga radhët e përfaqësuesve të institucioneve të sistemit, ashtu siç është përcaktuar në propozim-mandatin e komisionit. Kohëzgjatja e mandatit të komisionit është kufizuar në dy vite, me mundësi zgjatjeje për një kohë të caktuar. Nuk është qartësuar se cili është organi që do të propozojë zgjatjen e mandatit të komisionit, pastaj nuk është përcaktuar qartë se si do të përcillet dhe vlerësohet puna e këtij organi. Dikush pyeti për kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të KOMRA-s. Për të pasur të drejtë zgjedhjeje në KOMRA është me rëndësi që kandidati të mos ketë ushtruar detyrë publike dhe të mos ketë pasur funksion politik gjatë kohës së luftërave dhe konflikteve të armatosura në hapësirat e ish Jugosllavisë.

Gjatë konsultimeve në Banja Llukë, kur është diskutuar për komisionin rajonal, mua më ka rënë në sy dhe kam bërë vërejtje se pse për anëtarët e organit të paraparë që t'i propozojë anëtarët e komisionit rajonal nuk vlejnë kriteret sikurse edhe për organin të cilin ai e zgjedh, gjë që është pak e palogjikshme. Pra me fjalë tjera... le të themi se unë e zgjedh Eugenin në komision, pra, në këtë rast, për mua nuk vlejnë kriteret që të mos kem qenë në poste politike apo funksione tjera gjatë viteve të nëntëdhjeta, kurse për Eugenin ky kusht vlen. Do të thotë, unë e zgjedh Eugenin por tash shtrohet pyetja se sa jam unë e paanshme apo e njëanshme. Pra këto janë disa çështje për diskutimet e ardhshme në konsultimet e ardhshme.

JASMINA NAJDOVSKA: Faleminderit, Milena!

JORDANÇE TODOSIJEV: Në lidhje me pyetjen e fundit që u ngrit këtu, nuk u dha përgjigje: Cili është afati i fundit për ne që ta plotësojmë deklaratën për anëtarësim në KOMRA, për bashkëngjitje KOMRA-s. Pra, ne si shoqatë, deri kur kemi afat që ta plotësojmë deklaratën?

MILENA SAVIQ: Unë kërkoj falje që nuk e kuptova kontekstin e pyetjes tuaj. Nuk ekziston ndonjë afat i veçantë për hyrje në Koalicion. Me fjalë tjera, këtë mund ta bëni tani apo në ndonjë kohë tjetër.

EUGEN JAKOVÇIQ: Këtë mund ta bëni tash. Organizatorë të këtyre konsultimeve janë kolegët nga Fondi për të Drejtë Humanitare zyra në Prishtinë, ata do t'i marrin të dhënat tuaja, do të evidencoheni dhe kjo është e gjitha... nuk ka kurrfarë procedure.

JASMINA NAJDOVSKA: Mund ta plotësoni formularin sot dhe t'ua jepni pastaj kolegëve...

EUGEN JAKOVÇIQ: Natyrisht, për këto duhet të vendosni në organizatat tuaja, kjo është e logjikshme. Atëherë, ju i keni materialet me të dhënat e sakta të organizatave që bëjnë koordinimin e këtij procesi në gjithë rajonin. Ne kemi...në të vërtetë grumbullohen për secilin vend veç e veç, tash edhe për Maqedoninë...ky mund të jetë Fondi në Prishtinë dhe kjo mund të jetë adresa. Pra Zyra e Koalicionit për KOMRA në Prishtinë...pra kjo është e gjitha.

NORA AHMETAJ: Mundeni përmes web-faqes.

EUGEN JAKOVÇIQ: Mund të merreni vesh me kolegët në Maqedoni dhe të caktojme një organizatë e cila në të ardhmen do të bëjë koordinimin e aktiviteteve. Mendoj se kjo është mënyra më e mirë.

Disa pjesëmarrës pyetën për bashkëngjitjen në koalicion. Ivan, a ke diçka për të thënë? Do të thotë ne deri më tani... këto janë konsultimet e para që mbahen në Maqedoni. Mendoj se koalicioni funksionon dhe përkundër faktit se ka shumë anëtarë, në secilin shtet ekziston të paktën një organizatë dhe një zyrë që i grumbullohen anëtarët e koalicionit. Aktivitetet e tilla në Maqedoni nuk ishin të intensitetit të tillë si në vendet tjera, por meqenëse numri i tyre pritet të rritet në të ardhmen dhe kjo shihet nga pjesëmarrja e njerëzve nga Maqedonia në aktivitetet tona rajonale deri në fund të procesit konsultativ, kështu që është shumë e rëndësishme dhe mendoj se për këtë do të merremi vesh në një nga mbledhjet e ardhshme.

JASMINA NAJDOVSKA: Meqenëse unë punoj me shumë nga ata dhe kontaktojme nga afër, mund të më drejtoheni mua dhe të më informoni pastaj unë ua përcjell informatat organizatorëve.

EUGEN JAKOVÇIQ: Përkundrazi! Përkundrazi! Ja tash mund ta nënshkruani, aty është kolegja Jasmina nga Organizata për shoqëri të hapur në Maqedoni. Me të vërtetë koalicioni jonë....

JASMINA NAJDOVSKA: Mirë, unë ju lus për vëmendjen tuaj edhe pak. Ju lutem edhe pak për vëmendje, nëse mundet. Do të thotë se ne kemi nevojë për më shumë konsultime të këtilla, edhe një konsultim nacional është paraparë dhe u tregua se kemi shumë pyetje ... Ngjarjet e vitit 2001 lanë shumë dilema, shumë raste të pazgjidhura, kështu që jam e mendimit se konsultimet e këtilla në të ardhmen, qofshin ato rajonale apo lokale, do të kontribuojnë në sqarimin e asaj se çka paraqet KOMRA, çka punon, si duhet të punojë, çfarë modeli duhet të përcaktojme këtu, si duhet të punohet në territorin e Maqedonisë. Edhe një herë ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj. Pra nëse keni çfarëdo pyetje mund të më drejtoheni lirisht mua, ju tashmë e keni e-mailin tim, meqenëse unë u kam

dërguar email për pjesëmarrjen, prandaj nëse nuk mund të kontaktoni organizatorët mund të më drejtoheni mua pa asnjë problem dhe unë do të përgjigjem në të gjitha pyetjet dhe dilemat tuaja.

Web-sajti juaj?

NORA AHMETAJ: E keni atje, Për KOMRA-n!

EUGEN JAKOVÇIQ: Mirë...a ka mundësi të themi të gjithë nga një fjali. Unë ju falënderoj që ishit të durueshëm. Me të vërtetë kjo ka zgjatuar mjaft këtu në Shkup, në Maqedoni. Ne jemi të lumtur që ky proces... Ju lutem për pak vëmendje nëse ka mundësi. Pra, ju faleminderit dhe të gjitha informatat do të arrijnë te ju. Grupet e organizatave nga Maqedonia që bëhen anëtare të Koalicionit janë gjithnjë e më të mëdha, por ato kanë ekzistuar edhe më parë, një bërthamë e vogël e organizatave. Por mendoj se tash do të kemi një numër gjithnjë e më të madh dhe për të gjitha do të njoftoheni me kohë, sikurse edhe me rastin kur jeni ftuar në këtë takim. Unë ju falënderoj! Falënderoj kolegët nga Kosova, kolegen Rona Nishliu, e cila ka punuar shumë gjatë javëve të shkuara për t'i përgatitur këto konsultime, falënderoj kolegët nga Fondi për të Drejtën Humanitare zyra në Prishtinë. Ju falënderoj të gjithë juve, falënderoj kolegen Jasmina Navdojskoj, nga Shoqëria e hapur e Maqedonisë dhe të gjithë koleget dhe kolegët me të cilët kemi bashkëpunuar deri më tani dhe natyrisht edhe kolegët që kanë ardhur nga shtetet tjera me qëllim që t'i nxisin këto diskutime. Pra për fund, unë me të vërtetë ju falënderoj dhe shpresoj se do të shihemi shumë shpejt.

MILENA SAVIQ: Para se të niseni, ju lutem të qëndroni nëpër karriget tuaja edhe për pak sekonda. Më lejoni që t'ju përshëndes edhe një herë dhe t'ju falënderoj dhe të shpreh dëshirën time që kjo ide të ketë sukses në Maqedoni. Është e qartë se ekziston nevoja të takohemi edhe shumë herë tjera dhe t'ju them se ky proces do të jetë shumë domethënës sikurse që ishte te ne në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe do të ketë ndikim në disa ndryshime në shoqëri. Te ne aktualisht është duke u zhvilluar një proces i konsultimeve me shoqërinë civile me qëllim të miratimit të strategjisë shtetërore për drejtësi tranzicionale. Pra, diçka e tillë mund të ndodhë edhe këtu apo edhe në ndonjë shtet tjetër, kështu që ky proces të ketë efekte dhe ndikime të caktuara.

VETON MUJAJ: Unë vetëm desha t'ju falënderoj për pjesëmarrje! Faleminderit për pjesëmarrje. Asgjë tjetër.

NORA AHMETAJ: Si anëtare e Këshillit koordinues unë jam më se e kënaqur me këto konsultime. Keni bërë propozime, komente dhe pyetje fenomenale. Ashtu siç tha, më duket Eugeni, ne do të përpiqemi që në Këshillin koordinues të kërkojmë ose të propozojmë që këtu të mbahet edhe një konsultim apo të dy konsultimet e mbetura dhe të bisedojmë për ngjarjet e vitit 2001, sepse e shoh se për këtë ka shumë nevojë, edhe pse konflikti këtu ishte i një intensitetit të ulët. Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj.

JASMINA NAJDOVSKA: Unë ju falënderoj edhe një herë! Mbetem me shpresë se organizatorët do ta kenë parasysh këtë që u tha dhe së shpejti do të organizojnë më shumë konsultime këtu, në mënyrë që t'i zgjidhim të gjitha dilemat dhe të gjitha problemet. Kemi edhe shumë për të thënë. Unë shpresoj se atë që nuk kemi mundur ta themi sot do të kemi mundësi ta themi në raste tjera. Ju faleminderit!